RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI PËRPUTHSHMËRINË NË AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR DHE DREJTORITË RAJONALE

DHJETOR 2022

Përmbajtja **faqe**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit 3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve 3
3. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit 8
II. HYRJA 11
1. Objekti i auditimit 11
2. Qëllimi i auditimit 11
3. Identifikimi i çështjes: 12
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: 12
5. Përgjegjësitë e Audituesve: 12
6. Kriteret e vlerësimit 13
7. Standardet e auditimit 13
8. Metodat e auditimit 14
9. Dokumentimi i auditimit 14
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT 15
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM 15
2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT 15
2.1 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH – së 15
2.2 Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen, zbatimin dhe ndjekjen e kontratave për mirëmbajtjen e rrugëve: 17
- *Vlerësimi i kërkesave dhe nevojave për punë, mallra dhe shërbime;* 17
- *Argumentimi dhe përllogaritja e fondit limit sipas nevojave konkrete për punë, mallra e shërbime;* 17
- *Analizimi dhe vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit nga momenti i nxjerrjes së urdhrit të prokurimit deri në lidhjen e kontratës;* 17
- *Auditimi i lidhjes dhe zbatimit të kontratës deri në marrjen në dorëzim të mallrave ndërtimeve dhe shërbimeve.* 27
2.3 Mbi auditimin e pasqyrave financiare në Drejtoritë Rajonale Veri (Shkodër), Qendër (Tiranë) dhe Jug (Gjirokastër) 37
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET 39
V. ANEKSE 47

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

KLSH në periudhën nga data 09.05.2022 deri më datë 15.11.2022 kreu auditimin mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Drejtorive Rajonale në lidhje me kontratat e mirëmbajtjes për periudhën nga data 01.10.2020 deri në 31.12.2021, duke u përqendruar në auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, ligjshmërinë e prokurimeve për kontratat e mirëmbajtjes si dhe zbatimin e kontratave.

Grupi i Auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të Auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, me zgjedhje, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë të KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kritereve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të kryer në Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARRSH) dhe Drejtorive Rajonale për periudhën 01.10.2020 – 31.12.2021, grupi i auditimit me një siguri të arsyeshme ka dhënë ***opinion të kundërt mbi përputhshmërinë*** e veprimtarisë ekonomike dhe financiare.

Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 15 akte, të cilat tyre janë dorëzuar në protokollin e subjektit të audituar brenda afateve.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Nga auditimi i zbatimit të afatit 20 ditor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH konstatohet se nga ARRSH nuk është respektuar afati 20 ditor i kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimit. Gjithashtu, rezulton se sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 599/12 prot., datë 09.01.2020, janë rekomanduar gjithsej masat sipas tabelës në kapitullin vijues. Nga auditimi i masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, ka rezultuar se nga ana e subjektit ARRSH, janë pranuar në masën 81 % rekomandimet e lëna por nuk janë zbatuar në po këtë masë. Konkretisht, situata e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna paraqitet sipas tabelës në kapitullin vijues.	15 – 16	E lartë	1. Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Rrugor Shqiptar të merren masa të menjëhershme për rishikimin dhe zbatimin e të gjitha masave të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH. Gjithashtu, të rishikohen rekomandimet të cilat janë zbatuar pjesërisht si dhe të vijojnë procedurat përkatëse për përfundimin e rekomandimeve të konsideruara në proces. 2. Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Rrugor Shqiptar të merren masat e nevojshme për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, mbi programet për zbatimin e rekomandimeve të bëra.
2	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se	17 – 27	E lartë	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm

	DT kanë përcaktuar llojin e procedurës së prokurimit <u>E kufizuar</u> me dy faza kryesore dhe si kriter për përzgjedhjen e fituesit është përcaktuar oferta ekonomikisht më e favorshme bazë të vlerësimit me pikë, konkretisht: - Çmimi më i ulët 0-60 pikë - Përvoja në punë e kompanisë 0-20 pikë - Cilësia 0-20 pikë Në fakt, vlerësimi me pikë i ofertave për sa i takon çmimit, përvojës dhe cilësisë së shërbimit të ofruar nga operatorët ekonomikë nuk është në përputhje më parashikimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar neni 1, pika 2 pasi kjo metodologji nuk ka rritur eficiencën dhe efikasitetin e procedurave, nuk ka arritur të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale, nuk ka nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë si dhe nuk ka nxitur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë. Përzgjedhja e mënyrë së vlerësimit me pikë gjithashtu është në kundërshtim edhe me parashikimet e nenit 2 ***Parimet e përzgjedhjes***. Nga një analizë rezulton se efektiviteti i procedurave për të tre Rajonet ka qenë në masën 5.2 %. Njëkohësisht, për 27 nga 37 procedura prokurimi (vlera e prokuruar për 27 kontrata = 4,368,923,723 lekë pa TVSH), ose për gati 73 % të totalit në numër dhe 70 % në vlerë, efektiviteti mesatar i procedurave ka qenë në masën 1.5 %. Gjithashtu, për 13 procedura (vlera e prokuruar për 13 kontrata = 2,126,844,238 lekë pa TVSH) ose 35 % e totalit në numër dhe 34 % në vlerë, efektiviteti i secilës procedurë ka qenë nën 1 %. Këta tregues janë tregues i një rendimenti shumë të ulët krahasuar edhe me historikun e efektivitetit të procedurave të prokurimit të zhvilluara nga ana e ARRSH ndër vite. Konkretisht nga ana e NJP është cituar si më poshtë: *"Është përcaktuar 20 pikë për përvojën e kompanisë pasi për autoritetin është shumë e rëndësishme që krahas çmimit të përzgjedhë edhe kompani me përvojë në këtë fushë dhe pikërisht në përvojën e kompanive në mirëmbajtjen me performancë"*. Në fakt të gjithë elementët e nevojshëm për të dëshmuar përvojën e OE në drejtim të kontratave në mirëmbajtjen me performancë janë parashikuar në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar (Aneksi nr. 3)[1]. <u>Në lidhje me cilësinë:</u> *Cilësia është përcaktuar me 20 pikë duke i lënë operatorëve të fusin metodologji të reja në këtë fushë, të rrisin performancën e mirëmbajtjes si në kapacitetet teknike ashtu edhe në staf dhe teknologji. Duke vendosur këtë kriter vlerësimi OE do të japin oferta të përgjegjshme dhe të argumentuara se si do ta zbatojnë këtë kontratë.* Gjithashtu, edhe përshkrimi i mësipërm është i tillë që lë vend për subjektivitet gjatë fazës së vlerësimit të ofertave duke mos siguruar kështu mirë përdorim të fondeve dhe transparencë në procedurat e prokurimit. Konstatohet se në procesverbalet e mbajtur mes anëtarëve të NJP dhe në DT nuk është sqaruar qartë se si do të shprehet në shifra vlerësimi i përvojës dhe i cilësisë për çdo nën element të mundshëm që do të konsiderohet si përvojë apo cilësi duke bërë kështu që kjo metodologji vlerësimi me pikë për këto dy drejtime të mos sigurojë objektivitet dhe shmangie të diskriminimit. Pra nga ana e NJP është sqaruar vetëm diapazoni i pikëve nga 0 deri në 20 pikë për përvojën e OE dhe nga 0 deri në 20 pikë për cilësinë e shërbimit të ofruar nga ana e OE duke mos e përkthyer këtë diapazon shifrash në terma teknikë dhe ekonomikë. Përveç kësaj, referuar nenit 31 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, përcaktohet se: *<u>1. Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta ose standarde teknike të mirënjohura, kriter vlerësimi do të jetë oferta me çmimin më të ulët</u>*. *2. Kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme <u>do të përdoret në kontrata komplekse dhe të një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i</u>*			të ARRSH të merren masa të menjëhershme për rishikimin në procedurat e prokurimeve të zhvilluara nga ana e ARRSH, përfshirë ato në proces, të kriterit të vlerësimit të ofertës fituese me pikë si më sipër pasi kjo metodë, përmes gjykimeve subjektive të lëna si pasojë e mos saktësimit të elementëve të nevojshëm për tu vlerësuar në drejtim të cilësisë dhe përvojës, nuk rrit eficiencën dhe efikasitetin e procedurave, nuk arrin të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale, nuk nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, nuk nxit konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe si e tillë krijon kushte për përdorim pa EEE të fondeve publike.

[1] *Janë marrë si model kërkesat për lotin 1 të Rajonit të Veriut pasi njësojë është vepruar edhe për lotet dhe Rajonet e tjera me ndryshime jo thelbësore për çështjen.*

	kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit." Referuar specifikimeve teknike të kontratës, është kërkuar që shërbimet sipas do të duhet ti referohen Standardit Shqiptar, S SH EN, Standardit Rrugor Kombëtare Shqiptare, Standardit Shqiptar të Ndërtimit të Rrugëve, Standardeve Evropiane të Shqiptarizuara, etj. Pra në këtë rast jemi në kushtet kur *punët/mallrat/shërbimet kanë specifikime të thjeshta ose standarde teknike të mirënjohura* dhe për këtë arsye *kriter vlerësimi do të duhet të ishte vendosur oferta me çmimin më të ulët*. Gjithashtu, konstatohet se kontrata nuk mund të konsiderohet komplekse dhe as e një natyre të veçantë, kjo pasi në përbërje të preventivit janë parashikuar punime ndërtimi dhe mirëmbajtjeje për të cilat janë kërkuar dëshmitë dhe licencat përkatëse për zbatim punimesh. Kjo do të thotë se sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion plotësohen më së miri kushtet e pikës 1 dhe nuk plotësohen ato të pikës 2. Në kushte të tilla procedura është përzgjedhur në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar, neni 55 *Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*, pika 1 ku përcaktohet se: *1. Oferta fituese duhet të jetë:* *a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët; ose* *b) oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistenca teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kritere të jenë objektive dhe jodiskriminuese.* si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, neni 31 pika nr. 1 dhe pika nr. 2 të cituara si më sipër. Me përjashtim të vlerësimit me pikë për çmimin, vlerësimi me pikë i përvojës dhe cilësisë, ka bërë që praktikisht Autoriteti Kontraktor, edhe pse jo në kushtet e një domosdoshmërie për të ndjekur një metodologji të tillë vlerësimi, të vendos një kriter ku 20 % e peshës së vlerësimit të ndikohet nga eksperienca e gjatë në punë. Në fakt vendosja e një kriteri të tillë është në kundërshtim me nenin 20 të ligjit të prokurimit publik ku përcaktohet se Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre. Për kontratat e shërbimeve siç edhe është rasti në fjalë AK do të duhet të vendoste vetëm ato që kritere të nevojshme për të kryer punën, **pra kritere që mjaftojnë për realizimin punimeve dhe jo vlerësim me pikë maksimale të OE të cilët kanë eksperiencë më të gjatë**. Kjo do të thotë se OE të cilët kanë fituar kontrata në këtë 4 vjeçar do të jenë më të favorizuar në raport me OE e tjerë dhe kështu gjithnjë e më tepër konkurrenca do të kufizohet për efekt të këtyre kritereve.			
3	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara për Rajonin e Veriut, Rajonin Qendror dhe Rajonin Jugor rezulton se janë vendosur kritere diskriminuese e të paargumentuara teknikisht dhe ligjërisht. Konkretisht: *"Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate*	17 – 27	E lartë	Nga ana e ARRSH të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomicitet.

	tre viteve të fundit 2017, 2018 dhe 2019, duhet të mos jetë më e vogël se 30 % e fondit limit të lotit përkatës. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit." Në fakt nga ana e NJP xhiroja mesatare vjetore do të duhet të ishte kërkuar në bazë të vlerës vjetore të kontratës të parashikuar në marrëveshjen kuadër pasi punimet rutinë janë të vlerësuara dhe fikse kurse volumet e mirëmbajtjes janë volume pune të llogaritura për një afati prej 48 muaj, kjo pasi sipas DT nga ana e NJP janë kërkuar që OE të dëshmojnë një xhiro vjetore 4 herë më të lartë së sa ajo që parashikon VKM për të realizuar kontratën.			
4	Sipas dokumentacionit përkatës në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara për Rajonin e Veriut, Rajonin Qendror dhe Rajonin Jugor rezulton se në dy raste nga ana e OE stafi teknik, ai mbështetës dhe mjetet janë deklaruar si të gatshme dhe në dispozicion për lote dhe Rajone të ndryshme por edhe për lote të ndryshme brenda të njëjtit Rajon.	17 – 27	E lartë	Nga ana e Drejtorëve të Drejtorive Rajonale, në bashkëpunim me mbikëqyrësit e kontratave të shërbimeve të merren masat e nevojshme e të mjaftueshme për të kryer një analizë më të thelluar në lidhje me situatën e mjeteve dhe stafit teknik e atij mbështetës të angazhuar gjatë zbatimit të kontratave të lidhura për marrëveshjet kuadër respektive, me qëllim identifikimin e pasojave reale të ndodhura për periudhën nga lidhja e kontratës deri aktualisht.
5	Nga auditimi i dokumentacionit teknik të administruar në Drejtoritë Rajonale Veri, Qendër e Jug, raportet mujore të mbikëqyrësve të kontratës si dhe nga verifikimet në terren të kryera për kontrata dhe akse të përzgjedhura rezultuan në mënyrë të përgjithshme për të tre Rajonet mangësitë si më poshtë: 1. Personeli kyç i Kontraktorëve jo në të gjitha rastet është angazhuar sipas deklarimeve të bëra nga ana e tyre gjatë fazës së procedurës së prokurimit me të dhënat, kualifikimet dhe propozimet teknike të kërkuara; 2. Në disa raste, nuk rezultuan të vendosura tabelat emërtuese të kontratave me të dhënat e kërkuara; 3. Nga kontraktorët nuk janë marrë masa për disponimin e pajisjeve të nevojshme për të kryer matje të rregullta të ashpërsisë së rrugës me qëllim ndërgjegjësimin e kontraktorit për mbajtjen e ashpërsisë së rrugës nën vlerat e pragut të vlerave të matura; 4. Në asnjë prej dosjeve të vëna në dispozicion nuk dokumentohet prezenca kryerja e testit të matjes së ashpërsisë dhe kalibrimin e pajisjes përkatëse në prezencë të mbikëqyrësit të kontratës; 5. Nga ana e Kontraktorëve nuk janë marrë masat e duhura për sigurimin e të gjithë sinjalistikës horizontale dhe vertikale, parmakëve të sigurisë në pajtueshmëri të plotë me Standardet Rrugore; 6. Sinjalistika rezultoi në disa raste jo e plotë, e papastër (me bojë të shpërbërë, e ndryshkur, me vizatime, me adezivë reklamash, jo në formë të drejtë lineare, etj.) e paqartë për shkak të dëmtimeve dhe me strukturë jo të mirë. E njëjta situatë rezultoi edhe për sinjalet e njoftimit dhe sinjalet e drejtimit të trafikut. Për të tre këto elementë si më sipër nuk rezulton të jetë kryer asnjë test për verifikimin e reflektueshmërisë; 7. Për sa i takon sinjalistikës horizontale, në disa raste ky element rezultoi jo prezent, jo i qartë dhe në shumë raste i ndërprerë; 8. Mbrojtëset metalike rezultuan në disa raste me deformime të dukshme si rezultat i aksidenteve të ndodhura dhe këto elementë të rëndësishëm të rrugës nuk janë rifreskuar apo riparuar, sipas rastit. Sipas specifikimeve teknike rezulton se verifikimi/hetimi për sinjalistikën është parashikuar me inspektim vizual dhe/ose testim të reflektueshmërisë dhe masat për riparimet e nevojshme janë parashikuar nga 7 deri në 30 ditë; 9. Në dosje nuk disponohen dokumentacioni në format foto dhe video; 10. Në disa raste drenazhet dhe kanalet e kullimit me dhe pa linjëzim rezultuan jo të pastra dhe me dëmtime të	27 – 36	E lartë	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH si dhe Drejtorëve të Drejtorive Rajonale, në bashkëpunim me mbikëqyrësit e kontratave të shërbimeve si dhe inspektorët e kontratave, të merren masat e nevojshme e të mjaftueshme për të realizuar të gjitha parashikimet e kontratës dhe si dhe mbajtjen e penaliteteve në rastet e mos arritjes së niveleve të kërkuara të shërbimit me qëllim rritjen e cilësisë së mirëmbajtjes së aseteve rrugorë sipas standardeve më të mira bashkëkohore për të garantuar jetëgjatësinë dhe shfrytëzimin e rrugës, efikasitetin e shpenzimeve të fondeve publike për këtë qëllim si dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së investimeve.

	linjëzimit (për rastet me linjëzim) dhe me pengesa (gurë/vegjetacion/shkurre/aluvione/ etj.); 11. Nga verifikimi në terren i shërbimeve të kryera rezulton se në disa kontrata nuk është respektuar kushti i specifikimeve teknike në lidhje me zonën e lirë nga vegjetacioni (Vegetation free zone) sipas të cilit është kërkuar që e gjithë kjo zonë duhet të jetë e lirë nga e gjithë bimësia deri në 0.5 ml nga përvijuesit anësor; 12. Nga verifikimi në terren rezultoi se në disa raste nuk janë kryer shërbimet e nevojshme për mirëmbajtjen rutinë të veprave të artit dhe të urave të përfshira në kontratë. Konkretisht nuk dokumentohet lyerja me bojë e strukturave metalike të cilat rezultuan në disa raste me ndryshk. Gjithashtu, u konstatuan parmakë dhe parapete metalikë ose betoni të dëmtuar, mure betoni me dëmtime të hershme dhe të pariparuara, tuba kullimi muresh mbajtës të pa zhbllokuara. Situata e mësipërme nuk ka siguruar komfortin e përdoruesve të cilët kanë përdorur rrugën me një shpejtësi normale. Në lidhje me mirëmbajtjen e urave, rezulton se nuk dokumentohet mirëmbajtja e fugave të dilatacionit, kontrolli i gërryerjeve të nën strukturës nga rrjedhja e lumenjve, pastrimi i depozitimeve pranë këmbëve të urave, plotësimi me parapete të rregullt metalikë, riparimi i trotuareve ekzistues si dhe nuk është kryer në disa plotësimi me tabelën informuese për gjatësinë dhe aftësinë mbajtëse të urës. Përveç sa më sipër rezulton se në shumë raste për urat, veprat e artit dhe muret mbajtës nuk janë arritur nivelet e kërkuara të shërbimit, kjo pasi mbrojtëset metalike nuk rezultojnë të testuara dhe janë të deformuara, pjesët metalike nuk janë bojatisur dhe nuk rezulton të jetë kryer ndonjë kontroll për korrozionin. Në pak raste rezultoi e ekspozuar ndaj agjentëve atmosferikë edhe armatura e hekurit. Në lidhje me fugat e bashkimit nuk dokumentohet pastrimi dhe mirëmbajtja e tyre. Muret mbajtës nuk rezultojnë në të gjitha rastet të jenë në gjendje të mirë për shkak të amortizimit (muret e vjetër); 13. Në lidhje me bankinat në disa raste rezulton se nga ana e Kontraktorëve nuk është siguruar qëndrueshmëria pa deformime dhe pa erozion e tyre. Konkretisht bankinat në disa raste rezultuan të pangjeshura dhe me gropëzime; 14. Një pjesë e zërave rezultojnë të mos jenë kryer në përputhje me specifikimet teknike e konkretisht: a. Materialet e dala nga gërmimet e kanaleve nuk janë transportuar gjithmonë jashtë rrugës por në disa raste janë hedhur mbi bankinë, ose në krahun tjetër të guardrailave; b. Në disa raste tombinot rezultuan me depozitime ose të pa pastruara nga bimësia; c. Bankinat rezultuan me gropa dhe valëzime dhe me material shtesë të pa përshtatshëm, të pangjeshur. Për rrjedhojë në shumicën e rasteve bankinat nuk kanë përmbushur kriterin e pjerrësisë prej 4-8 % e duke lejuar qëndrimin e ujit në mbushje si dhe duke mos përmbushur as kushtin sipas të cilit është kërkuar që ngjeshja e bankinave dhe materialet e përdorura duhet të jenë të tilla që të mos lejojnë deformimet e përhershme prej presionit të makinave; d. Në disa prej akseve rrugore, u konstatua prezencë gurishtetsh, gurësh, dherash dhe materiale të tjera prej kalimeve nga kafshët; e. Në disa rastet riparimi i gropave është kryer jo në formë të rregullt gjeometrike dhe me kënde të drejta; f. Në lidhje me mbushjen dhe profilimin e nënshtresave në rrugët me asfalt ky zë rezulton se në disa prej rasteve nuk është kryer ose është kryer më një cilësi shumë të ulët nga ajo e kërkuar, pasi ka ulje të përsëritura në po të njëjta vendeve në të cilat është bërë ndërhyrja; Në lidhje me zërin *Mbushje me profilim në rrugët e pashtruara* rezulton se ky zë ka qenë jo efektiv në 100 % të masës në të cilën është përdorur dhe aktualisht në pjesën dërrmuese të akseve rrugore në të cilat është mbuluar me këtë zë/shërbim nuk ka as gjurmë të kryerjes së tij për shkak të përfshirjes në mirëmbajtje të akseve rrugore të degraduara.			
6	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë fazës së auditimit në terren si dhe atyre të sjella me observacion pas kësaj faze konfirmohet fakti se ecuria e kontratave të	27 – 36	E lartë	Nga ana e ARRSH si dhe Drejtorive Rajonale, në bashkëpunim me mbikëqyrësit e kontratave të

	lidhura mes OE dhe AK nuk ka ndjekur parashikimet e bëra në dokumentin *SPECIFIKIMET TEKNIKE, Për Shërbimin e Mirëmbajtjes me Performancë të Rrugëve* si dhe nuk është realizuar në përputhje me *Qëllimin e Investimit*, pasi punimet e rehabilitimit jo në të gjitha rastet janë kryer me fillimin e kontratës të cilat kanë qenë detyrimisht për tu kryer brenda vitit të parë të kontratës, kjo me qëllim sjelljen e rrugëve në kushte të pranueshme e për të vijuar më tej me kryerjen e punimeve/shërbimeve periodike.			shërbimeve si dhe inspektorët e kontratave të merren masat e nevojshme për kryerjen e të gjitha punimeve të rehabilitimit të kontratave pasi kryerja paraprake e tyre besohet të jetë e përshtatshme për të siguruar pajtueshmëri me Nivelet e Shërbimeve të kërkuara nga Kontratat, kjo me qëllim rritjen e cilësisë së mirëmbajtjes së aseteve rrugorë sipas standardeve më të mira bashkëkohore për të garantuar jetëgjatësinë dhe shfrytëzimin e rrugës, efikasitetin e shpenzimeve të fondeve publike për këtë qëllim si dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së investimeve.
7	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave rezultoi se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësve të kontratave të shërbimeve tepër në vlerë si rrjedhojë e likuidimit të punimeve/shërbimeve të pakryera në fakt në shumën totale prej **1,785,568 lekë pa TVSH**, vlerë kjo e cila jepet e detajuar sipas Aneksit nr. 4.	27 – 36	E lartë	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH si dhe Drejtorëve të Drejtorive Rajonale, në bashkëpunim me mbikëqyrësit e kontratave të shërbimeve të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës totale prej **1,785,568 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësve të kontratave për shërbime/punime të pakryera por të likuiduara në kontratat përkatëse të sipërmarrjes në vlerat të cilat jepen të detajuara sipas Aneksit nr. 4.
8	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se janë përfshirë në mirëmbajtje rrugore edhe akse të cilat janë cilësuar si të amortizuara dhe me domosdoshmëri ndërhyrjeje përmes investimeve totale. Në fakt përfshirja e akseve në gjendje të tillë ka sjellë si pasojë përdorimin pa efektivitet eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve prej të paktën shumën prej **21,980,880 lekë pa TVSH** dukë bërë që ndërhyrjet të mos kenë impakt të dukshëm në mirëmbajtjen e rrugëve, konkretisht në zëra si *Riparimi i gropave të asfaltit, Mbushje dhe profilim i nënshtresave në rrugët me asfalt, Riparimi dhe rifreskimi i sinjalistikës horizontale, Riparimi dhe rifreskimi i sinjalistikës vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore (mbrojtëset metalike) dhe ndriçimit* si dhe *Mirëmbajtje rutinë e veprave të artit* etj.	27 – 36	E lartë	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH si dhe Drejtorëve të Drejtorive Rajonale, të merren masa për përfshirjen në preventivat përkatës të marrëveshjeve kuadër në të ardhmen të atyre zërave të cilat kanë impakt të dukshëm dhe që rrisin cilësinë e mirëmbajtjes së aseteve rrugorë sipas standardeve më të mira bashkëkohore për të garantuar jetëgjatësinë dhe shfrytëzimin e rrugës duke siguruar kështu edhe një investim të qëndrueshëm.
9	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë Rajonale Qendrore konstatohet se në zërin *Shërbime nga të Tretët* (klasa 602), *Shërbime bankare* (përmbarimi), nga planifikimi në vlerën 0 lekë është kaluar në një realizim fakti në vlerën 4,391,629 lekë., pra tejkalimi rezulton në vlerën 4,391,629 lekë. Ky tejkalim vjen si pasojë e **likuidimit të ekzekutimit të detyrueshëm** me Urdhër Shpenzimin nr. 183, datë 28.12.2020 nga ana e DQT, ku është shlyer detyrimi në vlerën **4,006,960 lekë**, ndaj V. K., dhe zyrës përmbarimore "J. A. PF" vlerën **384,669 lekë** (tarifë përmbarimore). Me vendimin e Gjykatës të Apelit Administrativ Tiranë, nr. 742, datë 20.07.2020, është lëshuar urdhri i ekzekutimit me nr. 4, date 23.12.2020 për faturat tatimore të shitjes të shoqërisë V. K.. Sa më sipër, tarifa përmbarimore, me vlerë **384,669 lekë** konsiderohet **efekt financiar negativ** për buxhetin e shoqërisë.	37 – 38	E lartë	Nga sektori i Financës, të merren masa për zbatimin e përcaktimeve të kontratave dhe shlyerjen në kohë të detyrimeve ndaj furnitorëve.

3. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

Në vlerësimin tonë, rezultati i auditimit për çështjet e përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Autoritetit Rrugor Shqiptar për periudhën 01.10.2020 deri më 31.12.2021 nuk është në përputhje me aspektet materiale me kriteret e përcaktuara në këtë auditim, që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator. Grupi i auditimit në dhënien e opinionit ka marrë në konsideratë dhe gabime/parregullsi të caktuara të natyrës cilësore, pavarësisht vlerës së tyre.

Në përfundim të auditimit, pas marrjes së dëshmive të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, rezultuan devijime materiale dhe të përhapura nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, situatë e cila justifikon dhënien e një ***opinioni të kundërt mbi përputhshmërinë.***

Baza për opinionin e kundërt të përputhshmërisë.

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese, si dhe për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, pasi normalisht nuk mund të jepet një siguri në shkallën maksimale. Konkluzionet dhe opinioni ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga ARRSH dhe Drejtoritë Rajonale, e cila konsiderohet nga ana jonë përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme. Ne kemi përdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinioni me siguri të arsyeshme. Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Procedurat e auditimit të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 "Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë", ISSAI 1500 (ISA 500)[2] dhe ISSAI 1530 (ISA 530)[3]; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit kanë shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit në këtë auditim përputhshmërie. Ne kemi mbledhur dhe vlerësuar evidencën e auditimit, si dhe kemi konkluduar me gjetje dhe rekomandime në lidhje me fushën/objektin e auditimit, qasjen, kohën dhe burimet, me qëllim për të kryer një punë audituese që redukton në një nivel të ulët të pranueshëm, riskun e një konkluzioni ose opinioni të gabuar rreth objektivit të auditimit.

Si bazë për dhënin e opinionit të kundërt mbi përputhshmërinë kanë shërbyer gjetjet si më poshtë:

- Vendosja e kriterit të vlerësimit jo në përputhje me nevojat e investimit nuk ka rritur eficiencën dhe efikasitetin e procedurave, nuk ka arritur të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale, nuk ka nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë si dhe nuk ka nxitur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë për të gjitha procedurat e prokuruara me vlerë **6,342,033,159 lekë pa TVSH**;
- Në lidhje me zbatimin e kontratave rezultoi se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësve të kontratave të shërbimeve tepër në vlerë si rrjedhojë e likuidimit të punimeve/shërbimeve të pakryera në fakt në shumën totale prej **1,785,568 lekë pa TVSH**;
- Sipas dokumentacionit rezulton se ecuria e kontratave të lidhura mes OE dhe AK nuk ka ndjekur parashikimet e bëra në dokumentin *SPECIFIKIMET TEKNIKE, Për Shërbimin e Mirëmbajtjes me Performancë të Rrugëve* si dhe nuk është realizuar në përputhje me *Qëllimin e Investimit*, pasi punimet e rehabilitimit jo në të gjitha rastet janë kryer me fillimin e kontratës të cilat kanë qenë detyrimisht për tu kryer brenda vitit të parë të kontratës, kjo me qëllim sjelljen e rrugëve në kushte të pranueshme e për të vijuar më tej me kryerjen e punimeve/shërbimeve periodike, veprime këto me pasojë përdorimin pa EEE të fondeve në shumën prej të paktën **21,980,880 lekë pa TVSH;**
- Janë deklaruar angazhim i stafit dhe mjeteve në dispozicion në kontrata paralele brenda të njëjtit Rajon dhe për Rajone të ndryshme; etj.

[2] *Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij.*

[3] *Objektivi i audituesit është të kryeje procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi.*

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të ARRSH:
Strukturat drejtuese të ARRSH dhe Drejtoritë Rajonale, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), përfshirë ato për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në prokurimin e fondeve publike. Strukturat drejtuese të ARRSH dhe Drejtoritë Rajonale janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve. Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësisë publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde në pajtim me kriteret ligjore e rregullatore.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:
Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme[4], nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer të mundësojë identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH, gjithashtu aplikojnë edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.
Auditimi ka identifikuar çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kritereve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
Audituesit e KLSH janë përgjegjës për të siguruar cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit, me synim marrjen e sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzionet dhe opinioni i auditimit janë të përshtatshme.

[4] *ISA 200-ISSAI 1200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra për sa i takon gjetjeve të tij/saj.*

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 385/1, datë 04.05.2022, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 09.05.2022 deri me datë 15.11.2022, në subjektin *"Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Drejtoritë Rajonale"*, për periudhën 01.10.2020 deri më 31.12.2021, u krye *"Auditim mbi Përputhshmërinë"* në lidhje me kontratat e mirëmbajtjeve nga Grupi i Auditimit me përbërje:

J. H. , Përgjegjës Grupi,
S. H., Auditues,
I. B., Audituese.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti i auditimit

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2018 deri më datë 31.21.2021 përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit ligjor dhe rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë nëse në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse. Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivat kryesore të kësaj veprimtarie audituese janë:

1. Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
2. Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe proceseve të drejtimit;
3. Dhënia e një sigurie të arsyeshme nëse;

- Informacionet e rëndësishme financiare, të drejtimit dhe operacioneve janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;
- Burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;
- Asetet janë ruajtur dhe mirë administruar;
- Veprimtaria e Ujësjellës Kanalizime SHA, Gjirokastër është në pajtueshmëri me politikat, procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara për këtë qëllim;
- Kërkesat nga organet ligjvënëse, agjencitë financuese ose organizatat donatore janë respektuar sipas kushteve të marrëveshjeve të financimit.

4. Vlerësim mbi shkallën e zbatimit të kuadrit rregullator përkatëse të prokurimit, si dhe zbatimi i detyrimeve kontraktore;
6. Dhënia e Opinionit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së subjektit të audituar.

2. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuara të shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Nëpërmjet kryerjes së këtij auditimi KLSH synon të promovojë:

- Transparencën, duke ofruar raport të besueshëm për fondet nëse janë administruar sipas një procesi të rregullt dhe është respektuar kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi;
- Përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre;

- Qeverisjen e mirë, duke identifikuar dobësitë dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm, si dhe duke marrë parasysh riskun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë.

3. Identifikimi i çështjes:
Raporti i Auditimit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të ARRSH për periudhën nga 01.10.2020 - 31.12.2021 ka identifikuar sipas kritereve të specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:
- Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese të drejtorisë ARRSH, bazueshmërinë ligjore të vendimeve të marra dhe realizimin e tyre.
- Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
- Mbi planifikimin dhe zbatimin e Buxhetit si dhe shpenzimet administrative.
- Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabël, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të ARRSH.
- Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe zbatimi i kontratave (saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe zbatimin e punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimi i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve).
- Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj.).
- Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit (Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi, Komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm).
- Të tjera që mund të dalin gjatë procesit auditues.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:
Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë. Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

5. Përgjegjësitë e audituesve:
Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti ekonomik dhe financiar përputhet, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje financimi, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen dhe zbatohen etj.;
- njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kritereve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik);

- promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

6. Kriteret e vlerësimit

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) IFAC; Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 "Mbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Manualet e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH, Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve"; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar"; Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet", i ndryshuar; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat"; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar; Ligji nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përdorimit të ujërave të ndotura" i ndryshuar; Ligji nr. 8306, datë 14.03.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë"; Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë"; Ligji nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe ligje të tjera të fushës së ndërtimit; VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar; VKM nr. 642, datë 11.10.2005 "Për funksionimin e Këshillave Mbikëqyrës", i ndryshuar; Udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009 i Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës "Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në Shoqëritë Anonime Shtetërore"; VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 "Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të UK", VKM nr. 236, datë 10.05.1993 "Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjarë dhe jo familjar" i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit nr. 3, datë 28.07.2004 "Për administrimin e ujit të pijshëm"; metodikën mbi vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotur, miratuar me vendim të ERRU nr. 32, datë 21.12.2009; Kontratën e shërbimit të miratuar me vendim të ERRU nr. 8, datë 04.02.2011 "Për miratimin e modelit të kontratës tip"; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik"; Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit""; Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë; etj.

7. Standardet e auditimit

Raporti i Auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, si dhe mbështetur në:

- Kërkesat e Kushtetutës së Shqipërisë (Pjesa XIV, nenet 162 – 165);
- Ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- ISSAI 100 - Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400 - Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 - Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë";

- ISSAI 1500 (ISA 500) - Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- ISSAI 1530 (ISA 530) - Objektivi i audituesit është të kryeje procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë".

8. Metodat e auditimit

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të Audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Verifikimi i transaksioneve* – mbi bazën e informacionit në dokumentet e bankave me të cilët subjekti kryen transaksione;

b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

c. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimet e auditimit;

d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;

h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të Audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

9. Dokumentimi i auditimit

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me nëpunësit e ARRSH kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit, të gjykimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera, arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me akt-konstatimet dhe më pas shqyrtimin e observacioneve të subjektit, takimeve ballafaquese në subjekt, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM

Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) është krijuar me Ligjin Nr. 10164, date 15/10/2009, *"Për autoritetin rrugor shqiptar"*. Qëllimi i Ligjit ishte krijimi i Autoritetit Rrugor Shqiptar me kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrat e tij si dhe shndërrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në Autoritetin Rrugor Shqiptar. Misioni i kësaj drejtorie ishte organizimi, zhvillimi, shfrytëzimi mirëmbajtja, ri-veshja dhe realizimi i programit të investimeve në rrjetin rrugor kombëtar.

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve është krijuar ne vitin 1993 (VKM. Nr. 614, date 29/12/1993 "Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve"). Organika dhe struktura e kësaj drejtorie gjatë viteve ka pësuar transformime. Numri i punonjësve ka pësuar ndryshime në vite duke filluar nga 800 punonjës deri në 169 punonjës.

Institucioni i ARRSH-së, ka pësuar ndryshime në strukturë sipas VKM nr. 276, datë 16.05.2018 *"Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar"*, sipas të cilit marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm, nëpunësve të tjerë dhe punonjësve të Autoritetit në nivel Qendror dhe rajonal rregullohen në bazë të dispozitave të Ligjit 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punësi RSH", i ndryshuar.

Misioni i kësaj strukture është organizimi, zhvillimi, shfrytëzimi mirëmbajtja, ri-veshja dhe realizimi i programit të investimeve në rrjetin rrugor kombëtar. ARRSH, si një institucion i akreditуar për administrimin e fondeve nga Buxheti i Shtetit si dhe nga donatorë të huaj si: Banka Botërore, Banka Evropiane për Zhvillim dhe Ndërtim, Banka Evropiane e Investimeve, Qeveria Italiane, Qeveria Kuvajtiane, Banka Islamike etj., ka realizuar disa objekte të rëndësishme në rrjetin rrugor nacional.

2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

2.1 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.

<table>
<tr><td>1. Titulli i gjetjes:</td><td>Mos respektim i afatit 20 ditor si dhe mos marrje e masave zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.</td></tr>
<tr><td>Situata:</td><td>Nga auditimi i zbatimit të afatit 20 ditor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH konstatohet se nga ARRSH nuk është respektuar afati 20 ditor i kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimit. Gjithashtu, rezulton se sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 599/12 prot., datë 09.01.2020, janë rekomanduar gjithsej masat sipas tabelës së mëposhtme[5]. Nga auditimi i masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, ka rezultuar se nga ana e subjektit ARRSH, janë pranuar në masën 81 % rekomandimet e lëna por nuk janë zbatuar në po këtë masë. Konkretisht, situata e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:
<table>
<tr><th>Rekomandime</th><th>Rekomanduar</th><th>Pranuar</th><th>Realizuar</th><th>Realizuar pjesërisht</th><th>Në proces</th><th>Të pa zbatuara</th></tr>
<tr><td>Masa organizative</td><td>36</td><td>31</td><td>2</td><td>1</td><td>25</td><td>3</td></tr>
<tr><td>Masa shpërblim dëmi</td><td>3</td><td>1</td><td>-</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr>
<tr><td>EEE</td><td>4</td><td>3</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td><td>1</td></tr>
<tr><td>Masa disiplinore</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Totali</td><td>43</td><td>35</td><td>2</td><td>3</td><td>26</td><td>4</td></tr>
<tr><td>Totali në %</td><td></td><td>81 %</td><td>4.6 %</td><td>6.9 %</td><td>60 %</td><td>9 %</td></tr>
</table>
</td></tr>
<tr><td>Kriteri:</td><td>Ligji nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e kontrollit të</td></tr>
</table>

[5] *Më hollësisht auditimi i zbatimit të rekomandimeve është paraqitur në Aneksin nr. 1.*

	lartë të Shtetit" neni 15.
Ndikimi:	Mos zbatimi, zbatimi i pjesshëm si dhe mos ndjekja e mëtejshme e procedurave të nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm ka sjellë mos marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes së ARRSH.
Shkaku	Veprimet dhe mos veprimet e nivelit drejtues të ARRSH.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Rrugor Shqiptar të merren masa të menjëhershme për rishikimin dhe zbatimin e të gjitha masave të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH. Gjithashtu, të rishikohen rekomandimet të cilat janë zbatuar pjesërisht si dhe të vijojnë procedurat përkatëse për përfundimin e rekomandimeve të konsideruara në proces.
1.2 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Rrugor Shqiptar të merren masat e nevojshme për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, mbi programet për zbatimin e rekomandimeve të bëra.

2.2 Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen, zbatimin dhe ndjekjen e kontratave për mirëmbajtjen e rrugëve:

- *Vlerësimi i kërkesave dhe nevojave për punë, mallra dhe shërbime;*
- *Argumentimi dhe përllogaritja e fondit limit sipas nevojave konkrete për punë, mallra e shërbime;*
- *Analizimi dhe vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit nga momenti i nxjerrjes së urdhrit të prokurimit deri në lidhjen e kontratës;*

Nga auditimi rezulton se në total nga ana e ARRSH, për të tre Rajonet janë prokuruar për tu mirëmbajtur 37 akse rrugore me një gjatësi totale prej 2,192.15 km me vlerë të parashikuar **6,342,033,159 lekë pa TVSH** për të cilat janë lidhur marrëveshjet kuadër me OE me vlerë totale të këtyre marrëveshjeve **6,011,961,394 lekë pa TVSH**, ose me një efektivitet të procedurave prej **331,278,626 lekë pa TVSH**, ose **5.2 %**.

Nga një analizë e dokumentacionit rezulton se për 27 procedura prokurimi, ose për gati 70 % të totalit në vlerë, efektiviteti mesatar i procedurave ka qenë në masën 1.5 % dhe për 13 procedura ose 34 % e totalit në vlerë, efektiviteti i secilës procedurë ka qenë nën 1 %, një rendiment ky shumë i ulët krahasuar edhe me efektivitetin e procedurave të zhvilluara nga ana e ARRSH ndër vite për kontratat e mirëmbajtjes.

A. Procedurat e zhvilluara për Rajonin e Veriut

Tabela nr. 1

<table>
<tr><th colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Jugor (e ndarë në 13 lote)”, me nr. REF – REF-65438-07-14-2020)</th></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi Nr. 102 datë 30.06.2020
nr. 4758 prot., datë 30.06.2020</td><td rowspan="2">3. Përllogaritja e Vlerës së Fondit Limit Hartimi i Specifikimeve Teknike

Grupi i Punës Drejtoria Rajonale Shkodër
z. Xh. R.
z. P. P.
z. L. P.

Njësia e Prokurimit
Urdhri nr. 4758 prot., datë 30.06.2020
znj. M. SH.– Sektori i Prokurimeve/Personi Përgjegjës për Prokurimin
z. A. K.– Drejtoria e Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes, Specialist i Fushës
znj. R. L.– Drejtoria e Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes, Specialist i Fushës</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhër Nr. 137
nr. 4758/4, datë 05.08.2020

z. V. H.– Kryetar

znj. A. H.– Anëtare

z. G. A.– Anëtar</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës
“Procedurë e Kufizuar mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje Kuadër”, “Shërbime”, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara format elektronik</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)
2,172,497,807 lekë

Loti I. 143,206,858
Loti II. 195,106,837
Loti III. 223,088,415
Loti IV. 102,009,971
Loti V. 219,866,693
Loti VI. 106,030,133
Loti VII. 155,183,459
Loti VIII. 123,929,419
Loti IX. 146,498,257
Loti X. 194,202,038
Loti XI. 160,963,300
Loti XII. 117,790,800
Loti XIII. 112,667,173
Loti XIV. 171,954,454

Data e hapjes 05.08.2020</td><td>6. Oferta e kualifikuar e para (pa TVSH)
2,073,193,242 lekë

Loti I. 142,000,000 - J.
Loti II. 195,006,838 - M & SH
Loti III. 178,366,217 - N 2014 & RR G
Loti IV. 101,805,951 - I & A K
Loti V. 197,273,824 - AM & D
Loti VI. 103,211,980 - E & S
Loti VII. 154,416,953 - M & A & O
Loti VIII. 123,293,178 - G
Loti IX. 146,443,329 - C
Loti X. 194,052,710 - F
Loti XI. 160,765,746 - G
Loti XII. 114,323,742 - A I G C & A I C
Loti XIII. 109,004,107 - A I G C & A I C
Loti XIV. 153,228,667 - U</td><td>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)

<u>99,304,565 lekë (4.57%)</u>

Loti I. 1,206,858 (0.84%)
Loti II. 99,999 (0.05%)
Loti III. 44,722,198 (20 %)
Loti IV. 204,020 (0.2%)
Loti V. 22,592,869 (10.3%)
Loti VI. 2,818,153 (2.65%)
Loti VII. 766,506 (0.49%)
Loti VIII. 636,241 (0.51%)
Loti IX. 54,928 (0.04%)
Loti X. 149,328 (0.08%)
Loti XI. 197,554 (0.12%)
Loti XII. 3,467,058 2.9%)
Loti XIII. 3,663,066 (3.25%)
Loti XIV. 18,725,787 (10.9%)</td></tr>
</table>

ora10:00 **5.1 Afati** 48 muaj nga Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër		
8. Data e hapjes së tenderit 05.08.2020, ora 14:00	**9. Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë (oferta lekë pa TVSH)** *(Trajtuar rast pas rasti*)
11. Ankimime Po *(Trajtuar rast pas rasti*)	**12. Përgjigje Ankesës** Po	

Sipas shkresës nr. 3404/1 prot., datë 14.05.2020 i është dërguar Drejtorive Rajonale për njohje dhe zbatim Urdhri nr. 68, datë 14.05.2020 i ish – Drejtorit të Përgjithshëm me nr. 3404 prot., datë 14.05.2020 *"Për prokurimin e përqendruar dhe ngarkimin e ARRSH në rolin e organit qendror blerës për kryerjen e prokurimit me marrëveshje kuadër për kontratat e mirëmbajtjes së rrugëve me bazë performancë për drejtoritë e rajoneve"*.
Sipas këtij urdhri është përcaktuar se:
1. Procedurat e prokurimit për kontratat e mirëmbajtjes së rrugëve me bazë performancë për drejtoritë e rajoneve do të realizohen nga ARRSH;
2. Drejtoria Rajonale Qendrore (Tiranë), Drejtoria Rajonale Veriore (Shkodër) dhe Drejtoria Rajonale Jugore (Gjirokastër) të përcaktojnë specifikimet teknike, termat e referencës, sasitë e shërbimeve dhe përllogaritjen e fondit limit përkatës (pa TVSH) për të gjitha kontratat e mirëmbajtjes së rrugëve me bazë performancë që do të prokurohen me marrëveshje kuadër me afat të paktën 4 vjet dhe në çdo rast, fondi i përgjithshëm i marrëveshje kuadër duhet ti referohet Planifikimit Buxhetor Afatmesëm (PBA) të AK dhe t'i dërgojnë ato në formë shkresore dhe elektronike (CD) pranë ARRSH.
Nga auditimi rezulton se për Rajonin Verior janë parashikuar në total për tu mirëmbajtur 14 akse me një gjatësi totale prej 712.45 km me vlerë të parashikuar **2,172,497,806 lekë pa TVSH**.

B. Procedurat e zhvilluara për Rajonin Qendror

Tabela nr. 2

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : *"Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Qendror (e ndarë në 10 lote)", me nr. REF – REF-65715-07-16-2020)*		
1. Urdhër Prokurimi Urdhri nr. 104 prot., datë 01.07.2020 me nr. 4794 prot., datë 01.07.2020	**3. Përllogaritja e Vlerës së Fondit Limit Hartimi i Specifikimeve Teknike** Grupi i Punës Drejtoria Rajonale Tiranë z. Xh. M. z. M. R. z. G. A. z. A. M. z. E. N. z. G. P z. I. R **Njësia e Prokurimit** Urdhri nr. 104, datë 01.07.2020 me nr. 4795 prot., datë 01.07.2020 **znj. M. SH.–** Sektori i Prokurimeve/Personi Përgjegjës për Prokurimin **z. A. K.–** Drejtoria e Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes, Specialist i Fushës **znj. R. L.–** Drejtoria e Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes, Specialist i Fushës	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri nr. 4794/3, datë 07.08.2020 **z. G. G. –** Kryetar **z. F. Z. –** Anëtar **z. A. S. –** Anëtar
2. Lloji i Procedurës *"Procedurë e Kufizuar mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje Kuadër me disa OE ku të gjitha kushtet janë përcaktuara"*, *"Shërbime të tjera"*, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara format elektronik		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 2,160,710,894 lekë Loti 1: 185,737,630 Loti 2: 182,252,677	6**. Oferta e kualifikuar e para** 2,069,270,209 lekë Loti 1: 184,971,390 – F Loti 2: 179,518,885 – K	**7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 140,533,374 lekë (9.6 %)

Loti 3: 255,787,340 Loti 4: 263,424,859 Loti 5: 258,934,359 Loti 6: 302,066,588 Loti 7: 194,768,956 Loti 8: 148,823,123 Loti 9: 169,973,967 Loti 10: 198,941,396 **5.1 Afati** 48 muaj nga Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër	Loti 3: 249,735,000 – XH & A – SH & ME Loti 4: 223,281,127.8 – A I G K & A I K Loti 5: 252,453,481 – ALA Loti 6: 301,101,555 – A I G K & A I K Loti 7: 181,126,549 – A I G K & A I K Loti 8: 148,591,621.6 – CU Loti 9: 151,689,203.42 – R Loti 10: 196,801,396 – I K & A	Loti 1: 766,240 (0.4 %) Loti 2: 2,733,792 (1.5 %) Loti 3: 6,052,340 (2.4 %) Loti 4: 40,143,731 (15.2 %) Loti 5: 6,480,878 (2.5 %) Loti 6: 965,033 (0.3 %) Loti 7: 13,642,407 (7.0 %) Loti 8: 231,601 (0.2 %) Loti 9: 18,284,764 (10.8 %) Loti 10: 2,140,000 (1.1 %)
8. Data e hapjes së tenderit 07.08.2020, ora 14:00	**9. Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë (oferta lekë pa TVSH)** *(Trajtuar rast pas rasti)*
11. Ankimime Po *(Trajtuar rast pas rasti)*	**12. Përgjigje Ankesës** Po	

Nga auditimi rezulton se për Rajonin Qendror janë parashikuar në total për tu mirëmbajtur 10 akse me një gjatësi totale prej 699.1 km me vlerë të parashikuar **2,160,710,894 lekë pa TVSH**.

A. Procedurat e zhvilluara për Rajonin Jugor

Tabela nr. 3

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : *"Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Jugor (e ndarë në 13 lote)", me nr. REF – REF-65438-07-14-2020)*		
1. Urdhër Prokurimi Urdhri nr. 4795 prot., datë 01.07.2020 **2. Lloji i Procedurës** *"Procedurë e Kufizuar mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje Kuadër me disa OE ku të gjitha kushtet janë përcaktuara", "Shërbime të tjera"*, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara format elektronik	**3. Përllogaritja e Vlerës së Fondit Limit Hartimi i Specifikimeve Teknike** Grupi i Punës Drejtoria Rajonale Gjirokastër z. A. V z. O. Z. z. E. Ç. z. A. H. znj. X. S. z. G. P. z. A. N. znj. B. S. z. A. D. z. K. K. **Njësia e Prokurimit** Urdhri nr. 4795 prot., datë 01.07.2020 **znj. M. SH.–** Sektori i Prokurimeve/Personi Përgjegjës për Prokurimin **z. A. K.–** Drejtoria e Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes, Specialist i Fushës **znj. R. L.–** Drejtoria e Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes, Specialist i Fushës	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri nr. 4795/3, datë 05.08.2020 **z. E. K. –** Kryetar **znj. Dh. L.–** Anëtare (zëvendësuar me **znj. M. H.** sipas Urdhrit nr. 4795/6 prot., datë 14.10.2020) **z. N. M.–** Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 2,008,824,459 lekë Loti 1: 192,260,577 Loti 2: 106,306,709 Loti 3: 199,551,855 Loti 4: 114,087,947 Loti 5: 117,703,464 Loti 6: 125,577,584 Loti 7: 169,211,472 Loti 8: 155,028,811 Loti 9: 134,557,069 Loti 10: 168,938,495 Loti 11: 164,331,709 Loti 12: 171,744,991 Loti 13: 189,523,776 **5.1 Afati** 48 muaj nga Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër	6**. Oferta e kualifikuar e para** 1,868,291,085 lekë Loti 1: 189,732,361 – A B Loti 2: 104,180,218 – T D & A K Loti 3: 152,808,168 – N & A Loti 4: 113,595,678 – 2 Loti 5: 114,164,812 – J C Loti 6: 123,053,902 - A Loti 7: 149,759,590 – B K & A Loti 8: 155,002,432 – C Loti 9: 130,495,930 – B Loti 10: 157,377,451 – 2 Loti 11: 160,971,702 – G F & I & 4 Loti 12: 146,175,533 – A I Loti 13: 170,973,307 I. K & A A	**7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 140,533,374 lekë (7 %) Loti 1: 2,528,216 (1.3 %) Loti 2: 2,126,491 (2.0 %) Loti 3: 46,743,687 (23.4 %) Loti 4: 492,296 (0.4 %) Loti 5: 3,538,652 (3.0 %) Loti 6: 2,523,682 (2.0 %) Loti 7: 19,451,882 (11.5 %) Loti 8: 26,379 (0.0 %) Loti 9: 4,061,139 (3.0 %) Loti 10: 11,561,044 (6.8 %) Loti 11: 3,360,007 (2.0%) Loti 12: 25,569,458 (14.9 %) Loti 13: 18,550,469 (9.8%)

8. Data e hapjes së tenderit 05.08.2020, ora 14:00	**9. Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë (oferta lekë pa TVSH)** *(Trajtuar rast pas rasti)*
11. Ankimime Po *(Trajtuar rast pas rasti)*	**12. Përgjigje Ankesës** Po	

Nga auditimi rezulton se për Rajon Jugor janë parashikuar në total për tu mirëmbajtur 13 akse me një gjatësi totale prej 780.6 km me vlerë të parashikuar **2,008,824,459 lekë pa TVSH**.

2. Titulli i gjetjes:	Përzgjedhje e gabuar e kritereve për vlerësimin e ofertës.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se DT kanë përcaktuar llojin e procedurës së prokurimit <u>*E kufizuar*</u> me dy faza kryesore dhe si kriter për përzgjedhjen e fituesit është përcaktuar oferta ekonomikisht më e favorshme bazë të vlerësimit me pikë, konkretisht: - Çmimi më i ulët 0-60 pikë - Përvoja në punë e kompanisë 0-20 pikë - Cilësia 0-20 pikë Në fakt, vlerësimi me pikë i ofertave për sa i takon çmimit, përvojës dhe cilësisë së shërbimit të ofruar nga operatorët ekonomikë nuk është në përputhje më parashikimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar neni 1, pika 2 pasi kjo metodologji nuk ka rritur eficiencën dhe efikasitetin e procedurave, nuk ka arritur të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale, nuk ka nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë si dhe nuk ka nxitur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë. Përzgjedhja e mënyrë së vlerësimit me pikë gjithashtu është në kundërshtim edhe me parashikimet e nenit 2 ***Parimet e përzgjedhjes***. Nga një analizë rezulton se efektiviteti i procedurave për të tre Rajonet ka qenë në masën 5.2 %. Njëkohësisht, për 27 nga 37 procedura prokurimi (vlera e prokuruar për 27 kontrata = 4,368,923,723 lekë pa TVSH), ose për gati 73 % të totalit në numër dhe 70 % në vlerë, efektiviteti mesatar i procedurave ka qenë në masën 1.5 %. Gjithashtu, për 13 procedura (vlera e prokuruar për 13 kontrata = 2,126,844,238 lekë pa TVSH) ose 35 % e totalit në numër dhe 34 % në vlerë, efektiviteti i secilës procedurë ka qenë nën 1 %. Këta tregues janë tregues i një rendimenti shumë të ulët krahasuar edhe me historikun e efektivitetit të procedurave të prokurimit të zhvilluara nga ana e ARRSH ndër vite. Konkretisht nga ana e NJP është cituar si më poshtë: *"Është përcaktuar 20 pikë për përvojën e kompanisë pasi për autoritetin është shumë e rëndësishme që krahas çmimit të përzgjedhë edhe kompani me përvojë në këtë fushë dhe pikërisht në përvojën e kompanive në mirëmbajtjen me performancë"*. Në fakt të gjithë elementët e nevojshëm për të dëshmuar përvojën e OE në drejtim të kontratave në mirëmbajtjen me performancë janë parashikuar në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar (Aneksi nr. 3)[6]. <u>Në lidhje me cilësinë:</u> *Cilësia është përcaktuar me 20 pikë duke i lënë operatorëve të fusin metodologji të reja në këtë fushë, të rrisin performancën e mirëmbajtjes si në kapacitetet teknike ashtu edhe në staf dhe teknologji. Duke vendosur këtë kriter vlerësimi OE do të japin oferta të përgjegjshme dhe të*

[6] *Janë marrë si model kërkesat për lotin 1 të Rajonit të Veriut pasi njësojë është vepruar edhe për lotet dhe Rajonet e tjera me ndryshime jo thelbësore për çështjen.*

	argumentuara se si do ta zbatojnë këtë kontratë. Gjithashtu, edhe përshkrimi i mësipërm është i tillë që lë vend për subjektivitet gjatë fazës së vlerësimit të ofertave duke mos siguruar kështu mirë përdorim të fondeve dhe transparencë në procedurat e prokurimit. Konstatohet se në procesverbalet e mbajtur mes anëtarëve të NJP dhe në DT nuk është sqaruar qartë se si do të shprehet në shifra vlerësimi i përvojës dhe i cilësisë për çdo nën element të mundshëm që do të konsiderohet si përvojë apo cilësi duke bërë kështu që kjo metodologji vlerësimi me pikë për këto dy drejtime të mos sigurojë objektivitet dhe shmangie të diskriminimit. Pra nga ana e NJP është sqaruar vetëm diapazoni i pikëve nga 0 deri në 20 pikë për përvojën e OE dhe nga 0 deri në 20 pikë për cilësinë e shërbimit të ofruar nga ana e OE duke mos e përkthyer këtë diapazon shifrash në terma teknikë dhe ekonomikë. Përveç kësaj, referuar nenit 31 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, përcaktohet se: *1. Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta ose standarde teknike të mirënjohura, kriter vlerësimi do të jetë oferta me çmimin më të ulët.* *2. Kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme do të përdoret në kontrata komplekse dhe të një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit."* Referuar specifikimeve teknike të kontratës, është kërkuar që shërbimet do të duhet t'i referohen Standardit Shqiptar, S SH EN, Standardit Rrugor Kombëtare Shqiptare, Standardit Shqiptar të Ndërtimit të Rrugëve, Standardeve Evropiane të Shqiptarizuara, etj. Pra në këtë rast jemi në kushtet kur *punët/mallrat/shërbimet kanë specifikime të thjeshta ose standarde teknike të mirënjohura* dhe për këtë arsye *kriter vlerësimi do të duhet të ishte vendosur oferta me çmimin më të ulët*. Gjithashtu, konstatohet se kontrata nuk mund të konsiderohet komplekse dhe as e një natyre të veçantë, kjo pasi në përbërje të preventivit janë parashikuar punime ndërtimi dhe mirëmbajtjeje për të cilat janë kërkuar dëshmitë dhe licencat përkatëse për zbatim punimesh. Kjo do të thotë se sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion plotësohen më së miri kushtet e pikës 1 dhe nuk plotësohen ato të pikës 2. Në kushte të tilla procedura është përzgjedhur në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar, neni 55 *Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*, pika 1 ku përcaktohet se: *1. Oferta fituese duhet të jetë:*

	a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët; ose *b) oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistenca teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kritere të jenë objektive dhe jodiskriminuese.* si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, neni 31 pika nr. 1 dhe pika nr. 2 të cituara si më sipër. Me përjashtim të vlerësimit me pikë për çmimin, vlerësimi me pikë i përvojës dhe cilësisë, ka bërë që praktikisht Autoriteti Kontraktor, edhe pse jo në kushtet e një domosdoshmërie për të ndjekur një metodologji të tillë vlerësimi, të vendos një kriter ku 20 % e peshës së vlerësimit të ndikohet nga eksperienca e gjatë në punë. Në fakt vendosja e një kriteri të tillë është në kundërshtim me nenin 20 të ligjit të prokurimit publik ku përcaktohet se Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre. Për kontratat e shërbimeve siç edhe është rasti në fjalë AK do të duhet të vendoste vetëm ato që kritere të nevojshme për të kryer punën, **<u>pra kritere që mjaftojnë për realizimin punimeve dhe jo vlerësim me pikë maksimale të OE të cilët kanë eksperiencë më të gjatë</u>**. Kjo do të thotë se OE të cilët kanë fituar kontrata në këtë 4 vjeçar do të jenë më të favorizuar në raport me OE e tjerë dhe kështu gjithnjë e më tepër konkurrenca do të kufizohet për efekt të këtyre kritereve.
Kriteri:	- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, Neni 1, *"Objekti dhe qëllimi"*: *"Qëllimi i këtij ligji është:* *b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;* *c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;* *ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;* *d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;* *dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."* Neni 2, *"Parimet e përzgjedhjes"*: *"Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të* *përgjithshme:* *a) mos diskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;* *b) transparencë në procedurat e prokurimit;* *c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose* *kandidatëve."* Neni 20, *"Mosdiskriminimi"*:

	"Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre." Neni 55, *"Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese"*, pika 1: *"Oferta fituese duhet të jetë:* *a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët; ose* *b) oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistenca teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kritere të jenë objektive dhe jodiskriminuese."* VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar: Neni 28, *"Kontratat e shërbimeve"*: *"Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve."* Neni 31, *"Kriteret për vlerësimin e ofertës"*: *"1. Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta ose standarde teknike të mirënjohura, kriter vlerësimi do të jetë oferta me çmimin më të ulët.* *2. Kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme do të përdoret në kontrata komplekse dhe të një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit."* Neni 61, *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"*: *"3) Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre."*

	- Rregullore e Brendshme e ARRSH.
Ndikimi:	Vendosja e kriterit të vlerësimit jo në përputhje me nevojat e investimit nuk ka rritur eficiencën dhe efikasitetin e procedurave, nuk ka arritur të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale, nuk ka nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë si dhe nuk ka nxitur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë për të gjitha procedurat e prokuruara me vlerë 6,342,033,159 lekë pa TVSH.
Shkaku	Interpretim i gabuar i kuadrit ligjor e rregullator të procedurave të prokurimit publik.
Rëndësia:	E lartë.
2.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH të merren masa të menjëhershme për rishikimin në procedurat e prokurimeve të zhvilluara nga ana e ARRSH, përfshirë ato në proces, të kriterit të vlerësimit të ofertës fituese me pikë si më sipër pasi kjo metodë, përmes gjykimeve subjektive të lëna si pasojë e mos saktësimit të elementëve të nevojshëm për tu vlerësuar në drejtim të cilësisë dhe përvojës, nuk rrit eficiencën dhe efikasitetin e procedurave, nuk arrin të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale, nuk nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, nuk nxit konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe si e tillë krijon kushte për përdorim pa EEE të fondeve publike.

Nga ana e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit znj. M. SH., z. A. K. dhe znj. R. L. është dërguar observacioni i administruar në subjekt me nr. 11865/3 prot., datë 26.12.2022 dhe në KLSH me nr. 385/10 , prot., datë 04.01.2023.

Pretendimi i subjektit:
“ ... Njësia e prokurimit kriterin e përzgjedhjes së fituesit e ka përcaktuar në përputhje me Nenin 55 “Kriteret e përcaktuara të ofertës fituese”, pika b. citon ...
Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH
Pretendimet Tuaja mbi këtë cështje nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren dhe janë përsëritje e observacioneve të dërguara për aktet e konstatimit.

3. Titulli i gjetjes:	Mangësi në drejtim të vendosjes së kritereve.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara për Rajonin e Veriut, Rajonin Qendror dhe Rajonin Jugor rezulton se janë vendosur kritere diskriminuese e të paargumentuara teknikisht dhe ligjërisht. Konkretisht: *“Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve të fundit 2017, 2018 dhe 2019, duhet të mos jetë më e vogël se 30 % e fondit limit të lotit përkatës. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.”* Në fakt nga ana e NJP xhiroja mesatare vjetore do të duhet të ishte kërkuar në bazë të vlerës vjetore të kontratës të parashikuar në marrëveshjen kuadër pasi punimet rutinë janë të vlerësuara dhe fikse kurse volumet e mirëmbajtjes janë volume pune të llogaritura për një afati prej 48 muaj, kjo pasi sipas DT nga ana e NJP janë kërkuar që OE të dëshmojnë një xhiro vjetore 4 herë më të lartë së sa ajo që parashikon VKM për të realizuar

	kontratën.
Kriteri:	- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, Neni 1, *"Objekti dhe qëllimi"*: *"Qëllimi i këtij ligji është:* *b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;* *c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;* *ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;* *d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;* *dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."* Neni 2, *"Parimet e përzgjedhjes"*: *"Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të* *përgjithshme:* *a) mos diskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;* *b) transparencë në procedurat e prokurimit;* *c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose* *kandidatëve."* Neni 20, *"Mosdiskriminimi"*: *"Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre."* VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar: Neni 28, *"Kontratat e shërbimeve"*: *"2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.* *3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit."* Neni 61, *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"*: *"3) Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre."* - Rregullore e ARRSH.
Ndikimi:	Vendosja e kritereve jo në përputhje me nevojat e shërbimit ndikon në

	konkurrencën e lirë e të ndershme si dhe nuk siguron përdorim me efektivitet, eficiencës dhe ekonomicitet të fondeve të ARRSH.
Shkaku	Veprimet dhe mosveprimet e anëtarëve të NJP si dhe mungesa e kontrolleve nga niveli drejtues i institucionit.
Rëndësia:	E lartë.
3.1 Rekomandimi:	Nga ana e ARRSH të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomicitet.

4. Titulli i gjetjes:	Deklarim i angazhimit të stafit dhe mjeteve në dispozicion në kontrata paralele brenda të njëjtit Rajon dhe në Rajone të ndryshme.
Situata:	Sipas dokumentacionit përkatës në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara për Rajonin e Veriut, Rajonin Qendror dhe Rajonin Jugor rezulton se në dy raste nga ana e OE stafi teknik, ai mbështetës dhe mjetet janë deklaruar si të gatshme dhe në dispozicion për lote dhe Rajone të ndryshme por edhe për lote të ndryshme brenda të njëjtit Rajon.
Kriteri:	- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, Neni 46, *"Kualifikimi i Ofertuesve", ku përcaktohet se*: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese".* *a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;* *b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;* *c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevoje, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;* *ç) kapacitetet ligjore: operatorët ekonomikë vërtetojnë se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës."*
Ndikimi:	Risk i lartë për arritjen e cilësisë së kërkuar të shërbimit.
Shkaku	Mungesa e kontrolleve të nevojshme për verifikimin e deklaratave të kryera.
Rëndësia:	E lartë.

4.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorëve të Drejtorive Rajonale, në bashkëpunim me mbikëqyrësit e kontratave të shërbimeve të merren masat e nevojshme e të mjaftueshme për të kryer një analizë më të thelluar në lidhje me situatën e mjeteve dhe stafit teknik e atij mbështetës të angazhuar gjatë zbatimit të kontratave të lidhura për marrëveshjet kuadër respektive, me qëllim identifikimin e pasojave reale të ndodhura për periudhën nga lidhja e kontratës deri aktualisht.

- *Auditimi i lidhjes dhe zbatimit të kontratës deri në marrjen në dorëzim të mallrave ndërtimeve dhe shërbimeve.*

6. Titulli i gjetjes:	Mangësi në drejtim të zbatimit të kontratave të shërbimit.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit teknik të administruar në Drejtoritë Rajonale Veri, Qendër e Jug, raportet mujore të mbikëqyrësve të kontratës si dhe nga verifikimet në terren të kryera për kontrata dhe akse të përzgjedhura rezultuan në mënyrë të përgjithshme për të tre Rajonet mangësitë si më poshtë: 15. Personeli kyç i Kontraktorëve jo në të gjitha rastet është angazhuar sipas deklarimeve të bëra nga ana e tyre gjatë fazës së procedurës së prokurimit me të dhënat, kualifikimet dhe propozimet teknike të kërkuara; 16. Në disa raste, nuk rezultuan të vendosura tabelat emërtuese të kontratave me të dhënat e kërkuara; 17. Nga kontraktorët nuk janë marrë masa për disponimin e pajisjeve të nevojshme për të kryer matje të rregullta të ashpërsisë së rrugës me qëllim ndërgjegjësimin e kontraktorit për mbajtjen e ashpërsisë së rrugës nën vlerat e pragut të vlerave të matura; 18. Në asnjë prej dosjeve të vëna në dispozicion nuk dokumentohet prezenca kryerja e testit të matjes së ashpërsisë dhe kalibrimin e pajisjes përkatëse në prezencë të mbikëqyrësit të kontratës; 19. Nga ana e Kontraktorëve nuk janë marrë masat e duhura për sigurimin e të gjithë sinjalistikës horizontale dhe vertikale, parmakëve të sigurisë në pajtueshmëri të plotë me Standardet Rrugore; 20. Sinjalistika rezultoi në disa raste jo e plotë, e papastër (me bojë të shpërbërë, e ndryshkur, me vizatime, me adezivë reklamash, jo në formë të drejtë lineare, etj.) e paqartë për shkak të dëmtimeve dhe me strukturë jo të mirë. E njëjta situatë rezultoi edhe për sinjalet e njoftimit dhe sinjalet e drejtimit të trafikut. Për të tre këto elementë si më sipër nuk rezulton të jetë kryer asnjë test për verifikimin e reflektueshmërisë; 21. Për sa i takon sinjalistikës horizontale, në disa raste ky element rezultoi jo prezent, jo i qartë dhe në shumë raste i ndërprerë; 22. Mbrojtëset metalike rezultuan në disa raste me deformime të dukshme si rezultat i aksidenteve të ndodhura dhe këto elementë të rëndësishëm të rrugës nuk janë rifreskuar apo riparuar, sipas rastit. Sipas specifikimeve teknike rezulton se verifikimi/hetimi për sinjalistikën është parashikuar me inspektim vizual dhe/ose testim të reflektueshmërisë dhe masat për riparimet e nevojshme janë parashikuar nga 7 deri në 30 ditë; 23. Në dosje nuk disponohen dokumentacioni në format foto dhe video; 24. Në disa raste drenazhet dhe kanalet e kullimit me dhe pa linjëzim

	rezultuan jo të pastra dhe me dëmtime të linjëzimit (për rastet me linjëzim) dhe me pengesa (gurë/vegjetacion/shkurre/aluvione/ etj.); 25. Nga verifikimi në terren i shërbimeve të kryera rezulton se në disa kontrata nuk është respektuar kushti i specifikimeve teknike në lidhje me zonën e lirë nga vegjetacioni (Vegetation free zone) sipas të cilit është kërkuar që e gjithë kjo zonë duhet të jetë e lirë nga e gjithë bimësia deri në 0.5 ml nga përvijuesit anësor; 26. Nga verifikimi në terren rezultoi se në disa raste nuk janë kryer shërbimet e nevojshme për mirëmbajtjen rutinë të veprave të artit dhe të urave të përfshira në kontratë. Konkretisht nuk dokumentohet lyerja me bojë e strukturave metalike të cilat rezultuan në disa raste me ndryshk. Gjithashtu, u konstatuan parmakë dhe parapete metalikë ose betoni të dëmtuar, mure betoni me dëmtime të hershme dhe të pariparuara, tuba kullimi muresh mbajtës të pa zhbllokuara. Situata e mësipërme nuk ka siguruar komfortin e përdoruesve të cilët kanë përdorur rrugën me një shpejtësi normale. Në lidhje me mirëmbajtjen e urave, rezulton se nuk dokumentohet mirëmbajtja e fugave të dilatacionit, kontrolli i gërryerjeve të nën strukturës nga rrjedhja e lumenjve, pastrimi i depozitimeve pranë këmbëve të urave, plotësimi me parapete të rregullt metalikë, riparimi i trotuareve ekzistues si dhe nuk është kryer në disa plotësimi me tabelën informuese për gjatësinë dhe aftësinë mbajtëse të urës. Përveç sa më sipër rezulton se në shumë raste për urat, veprat e artit dhe muret mbajtës nuk janë arritur nivelet e kërkuara të shërbimit, kjo pasi mbrojtëset metalike nuk rezultojnë të testuara dhe janë të deformuara, pjesët metalike nuk janë bojatisur dhe nuk rezulton të jetë kryer ndonjë kontroll për korrozionin. Në pak raste rezultoi e ekspozuar ndaj agjentëve atmosferikë edhe armatura e hekurit. Në lidhje me fugat e bashkimit nuk dokumentohet pastrimi dhe mirëmbajtja e tyre. Muret mbajtës nuk rezultojnë në të gjitha rastet të jenë në gjendje të mirë për shkak të amortizimit (muret e vjetër); 27. Në lidhje me bankinat në disa raste rezulton se nga ana e Kontraktorëve nuk është siguruar qëndrueshmëria pa deformime dhe pa erozion e tyre. Konkretisht bankinat në disa raste rezultuan të pangjeshura dhe me gropëzime; 28. Një pjesë e zërave rezultojnë të mos jenë kryer në përputhje me specifikimet teknike e konkretisht: a. Materialet e dala nga gërmimet e kanaleve nuk janë transportuar gjithmonë jashtë rrugës por në disa raste janë hedhur mbi bankinë, ose në krahun tjetër të guardrailave; b. Në disa raste tombinot rezultuan me depozitime ose të pa pastruara nga bimësia; c. Bankinat rezultuan me gropa dhe valëzime dhe me material shtesë të pa përshtatshëm, të pangjeshur. Për rrjedhojë në shumicën e rasteve bankinat nuk kanë përmbushur kriterin e pjerrësisë prej 4-8 % e duke lejuar qëndrimin e ujit në mbushje si dhe duke mos përmbushur as kushtin sipas të cilit është kërkuar që ngjeshja e bankinave dhe materialet e përdorura duhet të jenë të tilla që të mos lejojnë deformimet e përhershme prej presionit të makinave; d. Në disa prej akseve rrugore, u konstatua prezencë gurishtetsh, gurësh, dherash dhe materiale të tjera prej kalimeve nga kafshët;

	e. Në disa rastet riparimi i gropave është kryer jo në formë të rregullt gjeometrike dhe me kënde të drejta; f. Në lidhje me mbushjen dhe profilimin e nënshtresave në rrugët me asfalt ky zë rezulton se në disa prej rasteve nuk është kryer ose është kryer më një cilësi shumë të ulët nga ajo e kërkuar, pasi ka ulje të përsëritura në po të njëjta vendeve në të cilat është bërë ndërhyrja; Në lidhje me zërin *Mbushje me profilim në rrugët e pashtruara* rezulton se ky zë ka qenë jo efektiv në 100 % të masës në të cilën është përdorur dhe aktualisht në pjesën dërrmuese të akseve rrugore në të cilat është mbuluar me këtë zë/shërbim nuk ka as gjurmë të kryerjes së tij për shkak të përfshirjes në mirëmbajtje të akseve rrugore të degraduara.
Kriteri:	- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u> neni 7/1: *"Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. Kur mbikëqyrësi i punimeve konstaton raste të ndryshimit të projektit, është i detyruar të njoftojë menjëherë Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit të bashkisë"* . - Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 <u>ku përcaktohet se</u>: *'3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.* *3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"*. - Kontrata e shërbimit me objekt *'Supervizion mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Verior* me nr. 96/25 prot., datë 27.08.2021; - Kontrata e shërbimit me objekt *'Supervizion mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Qendror'* me nr. ref. 90248 – 03 – 17 – 2021; - Kontrata e shërbimit me objekt *'Supervizion mirëmbajtje me performancë të rrugëve* Drejtorinë e Rajonit Jugor Gjirokastër" me nr. 96/34 prot datë 08.10.2021;

	- Specifikimet Teknike, Pika 2.3 *Funksionet e Personelit Kyç ku përcaktohet se:* *"Personeli kyç dhe funksionet e tyre do të jenë në përputhje me të dhënat e kualifikimit dhe me propozimet teknike të kërkuara."* - Specifikimet Teknike, Pika 2.4 *"Puna paraprake para fillimit të punimeve"*, germa a *ku përcaktohet se: "Kontraktori është i detyruar që në zbatim të Ligjit për disiplinimin e punimeve të ndërtimit, përpara fillimit të punimeve të vendosë tabelën emërtuese me të dhënat : emrin e kontratës, datën e fillimit, datën e përfundimit, emërtimin e kontraktorit, emërtimin e mbikëqyrësit e tjerë."* - Specifikimet Teknike, Pika 6 *Masat e Qëndrueshmërisë për rrugët e shtruara, ku përcaktohet se: "Kontraktori duhet të ketë pajisje të nevojshme për të kryer masa të rregullta të ashpërsisë së rrugës. Matja e ashpërsisë do të bëhet në baza të vazhdueshme që mundësojnë krahasim të mëtejshëm të ashpërsimit të shkuar dhe të ardhshëm në çdo shtrirje rruge të vazhdueshme 500 metra. Asnjë kriter ashpërsie e rrugës nuk do të zbatohet gjatë fazës se periodike/rehabilitimit të kontratës. Megjithatë, ashpërsia do të kontrollohet në përfundim periodike/rehabilitimit të pranuar dhe vlerat e riregjistruara dhe të pranuara në atë faze do të përbeje pragun kundër të cilit ashpërsitë e ardhshme do të krahasohen. (sipas standardeve te IRI-t). Aty ku asnjë fazë Periodike/Rehabilituese nuk është e parashikuar, ashpërsia do të matet në fillim të kontratës dhe, përsëri, vlerat e riregjistruara dhe të pranuara në atë faze do të përbejnë pragun kundër të cilit ashpërsitë e ardhshme do të krahasohen. Duke ndjekur rehabilitimin/periodike, apo fillimin ku nuk ka rehabilitim, Kontraktori do të jetë i përgjegjshëm për mbajtjen e ashpërsisë së rrugës nën vlerat e pragut të vlerave të matura me sipër. Mbikëqyrësi do të marrë pjese në masat e ashpërsisë të cilat do të mendohen të formojnë një pjese të Inspektimeve Formale. Nëse ashpërsia akoma kalon maksimumin e lejuar, mirëmbajtja mujore bazë për sa i përket gjatësisë së ndikuar do të pakësohet nga një faktor:* *(Ra – Rp) / Rp* *aty ku Ra është ashpërsia aktuale dhe Rp është ashpërsia e lejuar për nivelin e kërkuar të shërbimit. (shprehet në m/km) Pakësimi do të vazhdoje të behet çdo muaj deri në një kohe të tille sa ashpërsia e matur është pakësuar në një vlerë nën maksimalen e lejuar."* - Specifikimet Teknike, pika 7 *Sinjalistika dhe Siguria e Rrugës ku përcaktohet se: "Kontraktori është i përgjegjshëm për të siguruar që e gjithë sinjalistika horizontale dhe vertikale, gjithashtu edhe parmakët dhe pajisjet e sigurisë rrugore pajtohen plotësisht me Standardet Rrugorë Kombëtare Shqiptare."* - Specifikimet Teknik, Pjesa C, pika 1, germa b *Marrja në dorëzim e seksionit rrugor për fillimin e implementimit të mirëmbajtjes*, paragrafi i fundit, *ku përcaktohet se: "Seksionet rrugorë që do të kalojnë nën Mirëmbajtjen me Performancë do t'i dorëzohen Kontraktorit nga Punëdhënësi në formën e një inventari të të gjithë elementëve rrugorë dhe karakteristikat mbi gjendjen e tyre faktike. Formulari i këtij procesi do të përgatitet ku të pasqyrohen :* • *Si pjesë e dosjes të jene pamjet filmike të rrugës, foto dhe video."* - Specifikimet Teknike, Pika 8 *Kullimi/Drenazhet*, Pika 9 *Bimësia* dhe Pika

	10 *Veprat e artit*, Pika 11 *Skarpate – Gërmimet dhe Bankinat*; Etj.
Ndikimi:	Ulje e cilësisë së mirëmbajtjes së aseteve rrugorë sipas standardeve më të mira bashkëkohore për të garantuar jetëgjatësinë dhe shfrytëzimin e rrugës, efikasitetin e shpenzimeve të fondeve publike për këtë qëllim si dhe mos sigurim i qëndrueshmërisë së investimeve.
Shkaku	Mungesa e veprimeve të mbikëqyrësve të kontratave.
Rëndësia:	E lartë.
6.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH si dhe Drejtorëve të Drejtorive Rajonale, në bashkëpunim me mbikëqyrësit e kontratave të shërbimeve si dhe inspektorët e kontratave, të merren masat e nevojshme e të mjaftueshme për të realizuar të gjitha parashikimet e kontratës dhe si dhe mbajtjen e penaliteteve në rastet e mos arritjes së niveleve të kërkuara të shërbimit.

7. Titulli i gjetjes:	Mos respektim i kushteve të kontratave të sipërmarrjes së punimeve dhe mbikëqyrjeve.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë fazës së auditimit në terren si dhe atyre të sjella me observacion pas kësaj faze konfirmohet fakti se ecuria e kontratave të lidhura mes OE dhe AK nuk ka ndjekur parashikimet e bëra në dokumentin *SPECIFIKIMET TEKNIKE, Për Shërbimin e Mirëmbajtjes me Performancë të Rrugëve* si dhe nuk është realizuar në përputhje me *Qëllimin e Investimit*, pasi punimet e rehabilitimit jo në të gjitha rastet janë kryer me fillimin e kontratës të cilat kanë qenë detyrimisht për tu kryer brenda vitit të parë të kontratës, kjo me qëllim sjelljen e rrugëve në kushte të pranueshme e për të vijuar më tej me kryerjen e punimeve/shërbimeve periodike.
Kriteri:	Kapitulli I, Pjesa A1, <u>*ku përcaktohet se*</u>: *"Konceptet themelore të kontratave të mirëmbajtjes me bazë Performance* *Shërbimet që kërkon Mirëmbajtja e një rruge klasifikohen në:* <u>*Punimet Periodike/Rehabilituese*</u>*, në formën e sasisë së një vlere tavan, ndërsa tregohen sasitë e punimeve të matshme që do kryhen në mënyrë që rruga të arrijë Standardet e asaj performance* <u>*Shërbimet e Mirëmbajtjes Rutinë*</u> *në formën e sasisë së shprehur në një vlerë tavan mujore (kjo do jetë një sasi mujore e aplikueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes se kontratës se shprehur në çmim për kilometër për secilin muaj e shumëzuar me gjatësinë e rrugës dhe kohëzgjatjen e shërbimeve);* Pika 2.2.1 *Si shprehen punimet e periodike/rehabilitimit* <u>*ku përcaktohet se*</u>: *"**Punimet e rehabilitimit janë punime të cilat do të kryhen me fillimin e kontratës, detyrimisht brenda vitit të parë, për të sjellë rrugën në kushte të pranueshme, për fillimin e mirëmbajtjes sipas nivelit të përcaktuar për atë rrugë, ndërsa punimet periodike janë punime që do të kryhen gjatë kohëzgjatjes së kontratës në periudha të favorshme nga moti**. Këto punime zënë maksimalisht 40 % të vlerës totale të kontratës. Është kompetencë e mbikëqyrësit të punimeve shtyrja e këtij afati, **<u>me një urdhër të veçantë</u>**, në rastet e kushteve të jashtëzakonshme atmosferike ose shkaqeve të tjera që lidhen me urdhra, vendime apo ligje të Qeverisë."* Pika 2.2.4 *Përshkrimi i Punimeve Periodike/Rehabilitimit* <u>*ku përcaktohet se*</u>: *"Kontraktori do të duhet të kryejë sasinë e punimeve periodike/rehabilitimit të treguara në preventivin për këto lloj punimesh.*

	***<u>Kontraktori duhet të bëjë një vlerësim të pavarur të punimeve periodike/rehabilitimit të cilat në pikëpamjen e tij janë të nevojshme për të sjellë rrugët në nivelet e kërkuara të shërbimit dhe të përfshijë koston për ato punime</u>**. Megjithatë, vetëm ato punime të përcaktuara në artikullin për Punimet Periodike/Rehabilituese do të paguhen specifikisht dhe veçmas sipas kontratës si punë rehabilituese. Punime të tjera të nevojshme për të sjellë rrugët në nivelet e kërkuara të shërbimit, por të cilat nuk janë të përfshira në artikullin për Punimet Periodike/rehabilitimit, do të përfshihen nga ofertuesit në këstin mujor për Shërbime të Mirëmbajtjes. Ofertuesit janë të përgjegjshëm vetëm për vlerësimin e tipit dhe të sasisë së Punimeve Periodike/Rehabilituese të nevojshme për të përmbushur kërkesat e Kontratës. Gjatë ekzekutimit të Kontratës Kontraktori nuk do të ketë të drejtë të bëjë deklarata për ndonjë Punim Rehabilitues që nuk është përfshirë në përgatitjen e ofertës apo nuk është përfshirë në dokumentin e ofertës. Punimet Periodike/Rehabilituese të treguara në Ofertën e Sasive përfaqësojnë sasitë minimale periodike/rehabilitimit të cilat kërkon Kontrata që Kontraktori të kryejë; ato janë në varësi të fondit limit të llogaritur, i cili besohet të jetë i përshtatshëm për të siguruar pajtueshmëri me Nivelet e Shërbimeve të kërkuara nga Kontrata. Këto punime i referohen të gjithë komponentëve të rrugës (drenazheve, punimeve të dheut, strukturave, shtresave asfaltike, urave, elementëve të sinjalistikës, veprave të artit, pajisjeve të sigurisë, vegjetacionit, etj.). **Punimet e Periodike/rehabilitimit kryhen mbi bazën e skicave, vizatimeve dhe preventivave të hartuar nga Kontraktorët (me çmimet e manualeve që janë në fuqi) me qëllim sjelljen e rrugës në kushte të pranueshme për të filluar një mirëmbajtje rutinë sipas nivelit të kërkuar të shërbimit**. Punimet periodike/rehabilitimit janë punime që parashikohen të kryhen me qëllim rinovimin e elementëve të ndryshëm të rrugës, pajisjeve rrugore si dhe rivendosjen dhe përmirësimin e cilësisë fillestare, të njëjtë, kur ato janë të rrezikuara ose të dëmtuara seriozisht dhe përfshijnë punimet e mëposhtme:* *- riveshje e sipërfaqes së pjesës kaluese/karrexhatës* *- përmirësimi i sistemit të kullimit;* *- parandalimin e erozionit të argjinaturës, rrëshqitjes së shkëmbinjve dhe vendosjen e* *sistemeve të mbrojtjes së nevojshme.* *- riparimin e urave, nëse sistemi strukturor dhe materialet nuk kanë ndryshuar;* *- zëvendësimi i sinjalistikës dhe pajisjeve rrugore;* *- gjeometrinë e një rruge duke zgjeruar ose riorganizuar atë;* *Gjatë periudhës së kryerjes së punimeve periodike/rehabilitimit duhet që segmentet e caktuara për rehabilitim të mos kenë gropa të hapura, të cilat duhet të mbyllen në çdo rast që ato paraqiten në të gjithë gjatësinë.”* Në dokumentin me titull TERMA_REFERENCE_SUPERVIZION_MIREMBAJTJE, pika 1.4 *Koncepti i Kontratave me Performancë <u>ku përcaktohet se</u>*:

1.4 Koncepti i Kontratave me bazë Performancë

Ky tip kontratash kërkon që sektori privat të marrë përgjegjësitë për menaxhimin e aseteve rrugore në këmbim të një pagese mujore fikse, e cila është subjekt i zbritjeve (penaliteteve) që lidhen me dështimin për të përmbushur detyrimet e mirëmbajtjes.
Kontratat e mirëmbajtjes me bazë performance përpiqen të adresojnë çështjet në drejtim të kontraktorëve duke specifikuar punët dhe shërbimet që do të kryhen me qëllim arritjen dhe mirëmbajtjen e Niveleve të Shërbimit të përcaktuara në Kontratë. Gjatë proçesit të tenderimit Kontraktorët propozojnë një shumë fikse pagese mujore e shprehur në lekë/km/muaj në këmbim të kryerjes së punës për mirëmbajtjen, me qëllim mbajtjen e rrugës sipas Niveleve të shërbimit të përcaktuara. Kur rrugët që janë planifikuar të mirëmbahen nuk janë në nivelet e kërkuara atëherë një pagesë shtesë aplikohet, me qëllim mbulimin e punimeve fillestare për të sjellë rrugën në nivelin e kërkuar brenda periudhës së përcaktuar në kontratë. Është e rëndësishme të kuptohet që, kontraktorët nuk paguhen direkt për "inputet" ose punimet fizike që kryejnë, (të cilat ato padyshim kanë për detyrë që ti kryejnë) por për ("outputet") rezultatet nga puna e kryer. Si prsh. kryerja e punimeve të rehabilitimit për një rrugë sipas standarteve të

paracaktuara (nëse kjo kërkohet) ndiqet nga një mirëmbajtje e rregullt rutinë e rrugës për të siguruar dhe mbajtur standartet e përcaktuara.
Në kontratat me Bazë Performancë, të cilat janë edhe subjekt i monitorimit nën këtë **kontratë Mbikqyrjeje**, kontraktori do të kryejë një numër aktivitetesh (pune dhe shërbimi) me qëllim që të arrijë të mirëmbajë në nivelin e kërkuar të shërbimit (**N.Sh**) për përdoruesit e rrugës në rrjetin rrugor që përfshin kontrata. Në mënyrë specifike, punimet që do kryhen me kontratat e këtyre mirëmbajtjeve, janë :

- ***Punimet e Rehabilitimit/Periodike të rrugëve*** ; punimet e rehabilitimit fillestar që kryhen gjatë 12 muajve të parë të kontratës me qëllim për të sjellë rrugën në standarte të caktuara, për të vijuar me punime periodike gjatë 3 viteve të tjera të kontratës. Këto punime i referohen të gjithë komponentëve të rrugës (drenazheve, punimeve të dheut, strukturave, shtresave asfaltike, elementëve të sinjalistikës, pajisjeve të sigurisë, veprave të artit, etj.) dhe duhet të mos kalojnë vlerën në masën 40% në raport me vlerën e kontratës. Punimet e Rehabilitimit/Periodike kryhen mbi bazën e skicave, vizatimeve dhe preventivave të hartuar nga Kontraktorët (me çmimet e ofertuara), aprovimin e supervizorit dhe miratimin e Autoritetit Kontraktor, me qëllim sjelljen e rrugës në kushte të pranueshme për të kryer një mirëmbajtje rutinë sipas nivelit të kërkuar të shërbimit, sipas një grafiku punimesh të miratuar. Punimet e rehabilitimit/periodike janë punime që parashikohen të kryhen me qëllim rinovimin e elementëve të ndryshëm të rrugës, pajisjeve rrugore si dhe rivendosjen dhe përmirësimin e cilësisë fillestare, të njëjtë, kur ato janë të rrezikuara ose të dëmtuara seriozisht dhe përfshijnë punimet e mëposhtme :

- rinovimi i sipërfaqes së pjesës kaluese/karrexhatës
- përmirësimi i sistemit të kullimit;
- parandalimin e erozionit të argjinaturës, rrëshqitjes së shkëmbinjve dhe vendosjen e sistemeve të mbrojtjes së nevojshme;
- riparimin e urave, apo veprave të artit, nëse sistemi strukturor dhe materialet nuk kanë ndryshuar;
- zëvendësimi i sinjalizimit dhe pajisjeve rrugore;
- gjeometrinë e një rruge duke zgjeruar ose riorganizuar atë;

Për të gjitha punimet e rehabilitimit fillestar që do të kryhen do të mbahet 5% garanci punimesh e cila do të çlirohet pas një viti nga përfundimi i punimeve nëse nuk ka vërejtje ose mangësi të konstatuara në secilin rast.

- ***Mirëmbajtje rutinë*****;** janë punime që kryhen rregullisht me qëllim që të mirëmbahen kushtet bazë dhe funksionaliteti i rrjetit rrugor. Këto aktivitete janë:

  - ✓ riparimi i defekteve të shtresave,
  - ✓ mirëmbajtja e bankinave,
  - ✓ mirëmbajtja e drenazheve,
  - ✓ mirëmbajtja e strukturave,
  - ✓ mirëmbajtja e skarpatave,
  - ✓ mirëmbajtja e sinjalistikës dhe vijëzimeve,
  - ✓ kontrolli i vegjetacionit,
  - ✓ pastrimi i plehrave dhe vajrave në rrugë,
  - ✓ përgjigjet ndaj aksidenteve, si dhe

	Pika 1.5 *Një përshkrim i shkurtër i Kontratave Tip Performancë ku përcaktohet se*:  *1.5 Një përshkrim i shkurtër i Kontratave Tip Performancë* Duke marrë në konsideratë faktin që ky projekt aplikohet në një rrjet rrugor që ka disa standarte siç janë: rrugë të reja, të rikonstruktuara ose edhe rrugë në gjendje jo të mirë (pa asfalt, me çakull), është e domosdoshme që fillimisht, ky rrjet rrugor, të sillet në një nivel standarti të pranueshëm për aplikimin e mirëmbajtjes rutinë, dhe më tej, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara për atë nivel shërbimi.  Bazuar në këto pikëpamje Mbikqyrësi i Punimeve, do të angazhohet për të siguruar një Mbikqyrje efektive të punimeve të mirëmbajtjes, për monitorimin dhe çertifikimin e punimeve, (pavarësisht nëse shtohen apo pakësohen kilometrat në administrim të kësaj Drejtorie) : (i) Punime të rehabilitimit fillestar dhe punimet periodike (ii) Punimet e mirëmbajtjes rutinë (duke përfshirë edhe ato dimërore) (iii) Kryerja e punimeve emergjente (sa herë që paraqitet e domosdoshme) Nga krahasimi i fakteve si më sipër rezulton se i janë likuiduar Kontraktorëve të punimeve shuma përkatëse për punime mirëmbajtjeje rutinë në një kohë kur ende nuk janë marrë masat e nevojshme për të sjellë rrugën në një nivel dhe standard të pranueshëm përmes ndërhyrjes në akse me punime rehabilitimi/periodike. Në dosje nuk disponohet asnjë urdhër i veçantë nga ana e mbikëqyrësit për shtyrjen e afatit 1 vjeçar të periudhës së ndërhyrjes përmes rehabilitimit.
Ndikimi:	Ulje e cilësisë së mirëmbajtjes së aseteve rrugorë sipas standardeve më të mira bashkëkohore për të garantuar jetëgjatësinë dhe shfrytëzimin e rrugës, efikasitetin e shpenzimeve të fondeve publike për këtë qëllim si dhe mos sigurim i qëndrueshmërisë së investimeve.
Shkaku	Veprimet dhe mos veprimet e mbikëqyrësve të punimeve.
Rëndësia:	E lartë.
7.1 Rekomandimi:	Nga ana e ARRSH si dhe Drejtorive Rajonale, në bashkëpunim me mbikëqyrësit e kontratave të shërbimeve si dhe inspektorët e kontratave të merren masat e nevojshme për kryerjen e të gjitha punimeve të rehabilitimit të kontratave pasi kryerja paraprake e tyre besohet të jetë e përshtatshme për të siguruar pajtueshmëri me Nivelet e Shërbimeve të kërkuara nga Kontratat.

8. Titulli i gjetjes:	Punime/shërbime të likuiduara por të pakryera në fakt.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave rezultoi se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësve të kontratave të shërbimeve tepër në vlerë si rrjedhojë e likuidimit të punimeve/shërbimeve të pakryera në fakt në shumën totale prej **1,785,568 lekë pa TVSH**, vlerë kjo e cila jepet e detajuar sipas Aneksit nr. 4.
Kriteri:	- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, *ku përcaktohet se:* neni 7/1: *"Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e*

	dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. Kur mbikëqyrësi i punimeve konstaton raste të ndryshimit të projektit, është i detyruar të njoftojë menjëherë Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit të bashkisë" . - Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 <u>*ku përcaktohet se*</u>: *'3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.* *3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"*. - Kontrata e shërbimit me objekt *'Supervizion mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Verior* me nr. 96/25 prot., datë 27.08.2021; - Kontrata e shërbimit me objekt *'Supervizion mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Qendror'* me nr. ref. 90248 – 03 – 17 – 2021; - Kontrata e shërbimit me objekt *'Supervizion mirëmbajtje me performancë të rrugëve* Drejtorinë e Rajonit Jugor Gjirokastër" me nr. 96/34 prot datë 08.10.2021.
Ndikimi:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën **1,785,568 lekë pa TVSH.**
Shkaku	Veprimet dhe mos veprimet e mbikëqyrësve të punimeve.
Rëndësia:	E lartë.
8.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH si dhe Drejtorëve të Drejtorive Rajonale, në bashkëpunim me mbikëqyrësit e kontratave të shërbimeve të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës totale prej **1,785,568 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësve të kontratave për shërbime/punime të pakryera por të likuiduara në kontratat përkatëse të sipërmarrjes në vlerat të cilat jepen të detajuara sipas Aneksit nr. 4.

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve BOE M S. & A&E E me përfaqësues ligjor z. T. S është dërguar observacioni i administruar në subjekt me nr. 262 prot., datë 23.12.2022 dhe në KLSH me nr. 385/8 , prot., datë 27.12.20232.

Pretendimi i subjektit: *" ... Duke u nisur nga periudha e auditimit ...*

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH
Pretendimet Tuaja nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren dhe janë përsëritje e observacioneve të dërguara për aktet e konstatimit.

Nga ana e mbikëqyësit të punimeve OE C GROUP me përfaqësues ligjor z. V. M. është dërguar observacioni i administruar në subjekt me nr. - prot., datë 30.12.2022 dhe në KLSH me nr. 385/9 , prot., datë 30.12.20232.

Pretendimi i subjektit:
" Në lidhje me konstatimin e audituesve shtetërorë të KLSH ...
Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH
Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren dhe janë përsëritje e observacioneve të dërguara për aktet e konstatimit.

9. Titulli i gjetjes:	Përfshirja në mirëmbajtje e rrugëve të amortizuara.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se janë përfshirë në mirëmbajtje rrugore edhe akse të cilat janë cilësuar si të amortizuara dhe me domosdoshmëri ndërhyrjeje përmes investimeve totale. Në fakt përfshirja e akseve në gjendje të tillë ka sjellë si pasojë përdorimin pa efektivitet eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve prej të paktën shumën prej **21,980,880 lekë pa TVSH** dukë bërë që ndërhyrjet të mos kenë impakt të dukshëm në mirëmbajtjen e rrugëve, konkretisht në zëra si *Riparimi i gropave të asfaltit, Mbushje dhe profilim i nënshtresave në rrugët me asfalt, Riparimi dhe rifreskimi i sinjalistikës horizontale, Riparimi dhe rifreskimi i sinjalistikës vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore (mbrojtëset metalike) dhe ndriçimit* si dhe *Mirëmbajtje rutinë e veprave të artit* etj.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, Neni 1, *"Objekti dhe qëllimi"*: *"Qëllimi i këtij ligji është:* *b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale"*
Ndikimi:	Përdorim pa efektivitet eficiencë dhe ekonomicitet i fondeve në shumën prej **21,980,880 lekë pa TVSH**
Shkaku	Përfshirja e rrugëve të amortizuara në mirëmbajtjen e rrugëve.
Rëndësia:	E lartë.
9.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH si dhe Drejtorëve të Drejtorive Rajonale, të merren masa për përfshirjen në preventivat përkatës të marrëveshjeve kuadër në të ardhmen të atyre zërave të cilat kanë impakt të dukshëm dhe që rrisin cilësinë e mirëmbajtjes së aseteve rrugorë sipas standardeve më të mira bashkëkohore për të garantuar jetëgjatësinë dhe shfrytëzimin e rrugës duke siguruar kështu edhe një investim të qëndrueshëm.

2.3 Mbi auditimin e pasqyrave financiare në Drejtoritë Rajonale Veri (Shkodër), Qendër (Tiranë) dhe Jug (Gjirokastër)

9. Titulli i gjetjes:	Mos pasqyrimi i saktë i të transaksioneve dhe lëvizjeve kontabël në shënimet shpjeguese[7].
Situata:	Në Drejtorinë Rajonale të Veriut nga auditimi rezultoi se: 1. Nën rubrika *"Llogari të arkëtueshme"* paraqitet në vlerën **43,211,257 lekë** për vitin 2020, nga **1,654,412 Lekë** që ka qenë në vitin 2019, e cila pasqyron operacione me shtetin (të drejta), si dhe gjendjen e debitorëve të viteve të kaluara. 2. Llogaria 486 *"Shpenzime të periudhave të ardhshme"* është 107,707,919 **lekë** në fund të vitit 2020. Të cilat janë detyrime të prapambetura të krijuara për kontratat e mirëmbajtjes së rrugëve gjatë vitit 2020. *-Në Drejtorinë Rajonale të Jugut konstatohet se:* 1. Nën rubrika *"Llogari të arkëtueshme"*, në shumën **14,661,942** lekë, pasqyron gjendjen e debitorëve të viteve të kaluara **13,421,781** lekë. Llogaria 4342 "Operacione me shtetin, debitorë", në shumën **1,240,161** lekë pasqyron detyrimin e shtetit ndaj institucionit për marrjen e grantit, lidhur me shlyerjen e kreditorëve të vitit paraardhës, në vlerën **773,528** lekë, dhe në shumën **1,222,908** lekë të detyrimeve ndaj punonjësve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, TAP, (llogaritë kundër parti (llogaritë 421,431,435,436), si dhe llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", në postin B / Pasive të Pasqyrës së Pozicionit Financiar). **2.** Llogaria 4341 *"Operacione me shtetin - detyrime"*, paraqitet në vlerën 13,421,781 lekë, me kundër parti në aktivin e bilancit, në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm", dhe pasqyron të drejtat e institucionit ndaj të tretëve, të cilat duhet të derdhen në buxhet. Kjo shuma është e mbartur nga vitet e kaluara. -Rezulton se në Shënimet Shpjeguese nuk ka sqarime lidhur me këta zëra, dhe si e tillë situata është e paqartë dhe nuk jep siguri të arsyeshme. -Shënimet shpjeguese paraqiten të paqarta, të paplota dhe të pa kuptueshme.
Kriteri:	Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr. 2, paragrafi 49, pikat c dhe d, ku citohet: *"(c) informacion-shtesë mbi zërat materialë, të paraqitur në pasqyrat parësore dhe ndryshimet e tyre gjatë periudhës kontabël (pasqyrat parësore do të përmbajnë referenca që të drejtojnë në shënimet e bashkëngjitura, të cilat shpjegojnë më hollësisht informacionin e paraqitur në pasqyrat parësore); (d) informacion tjetër të nevojshëm për një paraqitje të vërtetë e të besueshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë së njësisë ekonomike raportuese (për shembull, pasivet e mundshme, transaksionet me palët e lidhura, ngjarjet që kanë ndodhur pas datës së bilancit)."*
Ndikimi:	Mos paraqitja e shënimeve shpjeguese dhe transaksioneve kontabël sipas detyrimeve përcaktuese dhe kritereve të përcaktuara në SKK nr. 2, sjell si pasojë paqartësi dhe pasiguri në hartimin e Pasqyrave Financiare.
Shkaku	Mos paraqitja e saktë e shënimeve shpjeguese.
Rëndësia:	E mesme.

[7] *Më hollësisht auditimi i zbatimit të pasqyrave financiare është paraqitur në Aneksin nr. 2.*

9.1 Rekomandimi:	Nga sektori i Financës të merren masa lidhur me plotësimin dhe pasqyrimin e saktë të transaksioneve dhe lëvizjeve kontabël në shënimet shpjeguese.

10. Titulli i gjetjes:	Ekzekutim i detyrueshëm i detyrimeve të prapambetura.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë Rajonale Qendrore konstatohet se në zërin *Shërbime nga të Tretët* (klasa 602), *Shërbime bankare* (përmbarimi), nga planifikimi në vlerën 0 lekë është kaluar në një realizim fakti në vlerën 4,391,629 lekë., pra tejkalimi rezulton në vlerën 4,391,629 lekë. Ky tejkalim vjen si pasojë e **likuidimit të ekzekutimit të detyrueshëm** me Urdhër Shpenzimin nr. 183, datë 28.12.2020 nga ana e DQT, ku është shlyer detyrimi në vlerën **4,006,960 lekë**, ndaj V. K., dhe zyrës përmbarimore "J. A. PF" vlerën **384,669 lekë** (tarifë përmbarimore). Me vendimin e Gjykatës të Apelit Administrativ Tiranë, nr. 742, datë 20.07.2020, është lëshuar urdhri i ekzekutimit me nr. 4, date 23.12.2020 për faturat tatimore të shitjes të shoqërisë V. K.. Sa më sipër, tarifa përmbarimore, me vlerë **384,669 lekë** konsiderohet **efekt financiar negativ** për buxhetin e shoqërisë.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, neni 12, pika 3.gj <u>*ku përcaktohet se*</u>: *"…garantimin që të gjithë kreditorët të paguhen në kohë dhe në rastet kur kreditorët nuk janë paguar apo në rast ankesash…"*
Ndikimi:	Mos likuidimi në kohë i faturave të TVSH – së ka sjellë si pasojë efektin negativ financiar në vlerën **384,669 lekë**.
Shkaku	Mos respektimi i përcaktimeve të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*, pika 12.
Rëndësia:	E lartë.
10.1 Rekomandimi:	Nga sektori i Financës, të merren masa për zbatimin e përcaktimeve të kontratave dhe shlyerjen në kohë të detyrimeve ndaj furnitorëve.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET
A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të afatit 20 ditor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH konstatohet se nga ARRSH nuk është respektuar afati 20 ditor i kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimit. Gjithashtu, rezulton se sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 599/12 prot., datë 09.01.2020, janë rekomanduar gjithsej masat sipas tabelës së mëposhtme[8]. Nga auditimi i masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, ka rezultuar se nga ana e subjektit ARRSH, janë pranuar në masën 81 % rekomandimet e lëna, por nuk janë zbatuar në po këtë masë. Konkretisht, situata e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Rekomandime	Rekomanduar	Pranuar	Realizuar	Realizuar pjesërisht	Në proces	Të pa zbatuara
Masa organizative	36	31	2	1	25	3
Masa shpërblim dëmi	3	1	-	-	1	-
EEE	4	3	-	2	-	1
Masa disiplinore	-	-	-	-	-	-
Totali	**43**	**35**	**2**	**3**	**26**	**4**
Totali në %		**81 %**	**4.6 %**	**6.9 %**	**60 %**	**9 %**

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligji nr. 154/2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e kontrollit të lartë të Shtetit"* neni 15.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 15 – 16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH të merren masa për rishikimin dhe zbatimin e të gjitha masave të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH. Gjithashtu, të merren masa për zbatimin e plotë të atyre rekomandimeve të konsideruara të zbatuara pjesërisht, të vijojnë procedurat përkatëse për përfundimin e rekomandimeve të konsideruara në proces si dhe të nisin procedurat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të konsideruara si të pazbatuara.

Në vijimësi

1.2 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH të merren masat e nevojshme për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, mbi programet për zbatimin e rekomandimeve të bëra.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit rezulton se DT kanë përcaktuar llojin e procedurës së prokurimit *E kufizuar* me dy faza kryesore dhe si kriter për përzgjedhjen e fituesit është përcaktuar oferta ekonomikisht më e favorshme bazë të vlerësimit me pikë, konkretisht:

- Çmimi më i ulët 0-60 pikë
- Përvoja në punë e kompanisë 0-20 pikë
- Cilësia 0-20 pikë

Në fakt, vlerësimi me pikë i ofertave për sa i takon çmimit, përvojës dhe cilësisë së shërbimit të ofruar nga operatorët ekonomikë nuk është në përputhje më parashikimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar neni 1, pika 2 pasi kjo metodologji nuk ka rritur eficiencën dhe efikasitetin e procedurave, nuk ka arritur të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale, nuk ka nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë si dhe nuk ka nxitur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë. Përzgjedhja e mënyrë së vlerësimit me pikë gjithashtu është në kundërshtim edhe me

[8] *Më hollësisht auditimi i zbatimit të rekomandimeve është paraqitur në Aneksin nr. 1.*

parashikimet e nenit 2 ***Parimet e përzgjedhjes***. Nga një analizë rezulton se efektiviteti i procedurave për të tre Rajonet ka qenë në masën 5.2 %. Njëkohësisht, për 27 nga 37 procedura prokurimi (vlera e prokuruar për 27 kontrata = 4,368,923,723 lekë pa TVSH), ose për gati 73 % të totalit në numër dhe 70 % në vlerë, efektiviteti mesatar i procedurave ka qenë në masën 1.5 %. Gjithashtu, për 13 procedura (vlera e prokuruar për 13 kontrata = 2,126,844,238 lekë pa TVSH) ose 35 % e totalit në numër dhe 34 % në vlerë, efektiviteti i secilës procedurë ka qenë nën 1 %. Këta tregues janë tregues i një rendimenti shumë të ulët krahasuar edhe me historikun e efektivitetit të procedurave të prokurimit të zhvilluara nga ana e ARRSH ndër vite. Konkretisht nga ana e NJP është cituar si më poshtë: *"Është përcaktuar 20 pikë për përvojën e kompanisë pasi për autoritetin është shumë e rëndësishme që krahas çmimit të përzgjedhë edhe kompani me përvojë në këtë fushë dhe pikërisht në përvojën e kompanive në mirëmbajtjen me performancë"*. Në fakt të gjithë elementët e nevojshëm për të dëshmuar përvojën e OE në drejtim të kontratave në mirëmbajtjen me performancë janë parashikuar në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar (Aneksi nr. 3)[9].

Në lidhje me cilësinë: *Cilësia është përcaktuar me 20 pikë duke i lënë operatorëve të fusin metodologji të reja në këtë fushë, të rrisin performancën e mirëmbajtjes si në kapacitetet teknike ashtu edhe në staf dhe teknologji. Duke vendosur këtë kriter vlerësimi OE do të japin oferta të përgjegjshme dhe të argumentuara se si do ta zbatojnë këtë kontratë.*

Gjithashtu, edhe përshkrimi i mësipërm është i tillë që lë vend për subjektivitet gjatë fazës së vlerësimit të ofertave duke mos siguruar kështu mirë përdorim të fondeve dhe transparencë në procedurat e prokurimit. Konstatohet se në procesverbalet e mbajtur mes anëtarëve të NJP dhe në DT nuk është sqaruar qartë se si do të shprehet në shifra vlerësimi i përvojës dhe i cilësisë për çdo nën element të mundshëm që do të konsiderohet si përvojë apo cilësi duke bërë kështu që kjo metodologji vlerësimi me pikë për këto dy drejtime të mos sigurojë objektivitet dhe shmangie të diskriminimit. Pra nga ana e NJP është sqaruar vetëm diapazoni i pikëve nga 0 deri në 20 pikë për përvojën e OE dhe nga 0 deri në 20 pikë për cilësinë e shërbimit të ofruar nga ana e OE duke mos e përkthyer këtë diapazon shifrash në terma teknikë dhe ekonomikë. Përveç kësaj, referuar edhe nenit 31 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, kërkohet që për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta ose standarde teknike të mirënjohura, kriter vlerësimi do të jetë oferta me çmimin më të ulët. Gjithashtu ky nen ka kërkuar që kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme do duhet të përdoret në kontrata komplekse dhe të një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

Referuar specifikimeve teknike të kontratës, është kërkuar që shërbimet sipas do të duhet ti referohen Standardit Shqiptar, S SH EN, Standardit Rrugor Kombëtare Shqiptare, Standardit Shqiptar të Ndërtimit të Rrugëve, Standardeve Evropiane të Shqiptarizuara, etj. Pra në këtë rast jemi në kushtet kur *punët/mallrat/shërbimet kanë specifikime të thjeshta ose standarde teknike të mirënjohura* dhe për këtë arsye *kriter vlerësimi do të duhet të ishte vendosur oferta*

[9] *Janë marrë si model kërkesat për lotin 1 të Rajonit të Veriut pasi njësojë është vepruar edhe për lotet dhe Rajonet e tjera me ndryshime jo thelbësore për çështjen.*

me çmimin më të ulët. Gjithashtu, konstatohet se kontrata nuk mund të konsiderohet komplekse dhe as e një natyre të veçantë, kjo pasi në përbërje të preventivit janë parashikuar punime ndërtimi dhe mirëmbajtjeje për të cilat janë kërkuar dëshmitë dhe licencat përkatëse për zbatim punimesh. Kjo do të thotë se sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion plotësohen më së miri kushtet e pikës 1 dhe nuk plotësohen ato të pikës 2. Në kushte të tilla procedura është përzgjedhur në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar, neni 55 *Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*, pika 1 si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, neni 31 pika nr. 1 dhe pika nr. 2. Me përjashtim të vlerësimit me pikë për çmimin, vlerësimi me pikë i përvojës dhe cilësisë, ka bërë që praktikisht Autoriteti Kontraktor, edhe pse jo në kushtet e një domosdoshmërie për të ndjekur një metodologji të tillë vlerësimi, të vendos një kriter ku 20 % e peshës së vlerësimit të ndikohet nga eksperienca e gjatë në punë. Në fakt vendosja e një kriteri të tillë është në kundërshtim me nenin 20 të ligjit të prokurimit publik ku përcaktohet se Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre. Për kontratat e shërbimeve siç edhe është rasti në fjalë AK do të duhet të vendoste vetëm ato që kritere të nevojshme për të kryer punën, **pra kritere që mjaftojnë për realizimin punimeve dhe jo vlerësim me pikë maksimale të OE të cilët kanë eksperiencë më të gjatë**. Kjo do të thotë se OE të cilët kanë fituar kontrata në këtë 4 vjeçar do të jenë më të favorizuar në raport me OE e tjerë dhe kështu gjithnjë e më tepër konkurrenca do të kufizohet për efekt të këtyre kritereve. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, Neni 1, *"Objekti dhe qëllimi"*, Neni 2, *"Parimet e përzgjedhjes"*, Neni 20, *"Mosdiskriminimi"*, Neni 55, *"Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese"*, pika 1, germa a dhe b, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar, Neni 28, *"Kontratat e shërbimeve"*, Neni 31, *"Kriteret për vlerësimin e ofertës"*, pikat 1 dhe 2, Neni 61, *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"*, pika 3 si dhe me Rregulloren e Brendshme të ARRSH. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 17 – 27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH të merren masa të menjëhershme për rishikimin në procedurat e prokurimeve të zhvilluara nga ana e ARRSH, përfshirë ato në proces, të kriterit të vlerësimit të ofertës fituese me pikë si më sipër pasi kjo metodë, përmes gjykimeve subjektive të lëna si pasojë e mos saktësimit të elementëve të nevojshëm për tu vlerësuar në drejtim të cilësisë dhe përvojës, nuk rrit eficiencën dhe efikasitetin e procedurave, nuk arrin të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale, nuk nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, nuk nxit konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe si e tillë krijon kushte për përdorim pa EEE të fondeve publike.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara për Rajonin e Veriut, Rajonin Qendror dhe Rajonin Jugor rezulton se janë vendosur kritere diskriminuese e të paargumentuara teknikisht dhe ligjërisht. Konkretisht:

"Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve të fundit 2017, 2018 dhe 2019, duhet të mos jetë më e vogël se 30 % e fondit limit të lotit përkatës. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.". Në fakt nga ana e NJP xhiroja mesatare vjetore do të duhet të ishte kërkuar në bazë të vlerës vjetore të kontratës të

parashikuar në marrëveshjen kuadër pasi punimet rutinë janë të vlerësuara dhe fikse kurse volumet e mirëmbajtjes janë volume pune të llogaritura për një afati prej 48 muaj, kjo pasi sipas DT nga ana e NJP janë kërkuar që OE të dëshmojnë një xhiro vjetore 4 herë më të lartë së sa ajo që parashikon VKM për të realizuar kontratën. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, Neni 1, *"Objekti dhe qëllimi"*, Neni 2, *"Parimet e përzgjedhjes"*, Neni 20, *"Mosdiskriminimi"*, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, ndryshuar, Neni 28, *"Kontratat e shërbimeve"*, pika 2 dhe 3, Neni 61, *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"*, pika 3 si dhe Rregulloren e Brendshme të ARRSH. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 17 – 27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomicitet.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit përkatës në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara për Rajonin e Veriut, Rajonin Qendror dhe Rajonin Jugor rezulton se në dy raste nga ana e OE stafi teknik, ai mbështetës dhe mjetet janë deklaruar si të gatshme dhe në dispozicion për lote dhe Rajone të ndryshme por edhe për lote të ndryshme brenda të njëjtit Rajon. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, Neni 1, *"Objekti dhe qëllimi"*, Neni 46, *"Kualifikimi i Ofertuesve"*. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 17 – 27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorëve të Drejtorive Rajonale, në bashkëpunim me mbikëqyrësit e kontratave të shërbimeve të merren masat e nevojshme e të mjaftueshme për të kryer një analizë më të thelluar në lidhje me situatën e mjeteve dhe stafit teknik e atij mbështetës të angazhuar gjatë zbatimit të kontratave të lidhura për marrëveshjet kuadër respektive, me qëllim identifikimin e pasojave reale të ndodhura për periudhën nga lidhja e kontratës deri aktualisht.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik të administruar në Drejtoritë Rajonale Veri, Qendër e Jug, raportet mujore të mbikëqyrësve të kontratës si dhe nga verifikimet në terren të kryera për kontrata dhe akse të përzgjedhura rezultuan në mënyrë të përgjithshme për të tre Rajonet mangësitë si më poshtë:

1. Personeli kyç i kontraktorëve jo në të gjitha rastet është angazhuar sipas deklarimeve të bëra nga ana e tyre gjatë fazës së procedurës së prokurimit me të dhënat, kualifikimet dhe propozimet teknike të kërkuara.
2. Në disa raste, nuk rezultuan të vendosura tabelat emërtuese të kontratave me të dhënat e kërkuara.
3. Nga kontraktorët nuk janë marrë masa për disponimin e pajisjeve të nevojshme për të kryer matje të rregullta të ashpërsisë së rrugës me qëllim ndërgjegjësimin e kontraktorit për mbajtjen e ashpërsisë së rrugës nën vlerat e pragut të vlerave të matura.
4. Në asnjë prej dosjeve të vëna në dispozicion nuk dokumentohet prezenca kryerja e testit të matjes së ashpërsisë dhe kalibrimin e pajisjes përkatëse në prezencë të mbikëqyrësit të kontratës.
5. Nga ana e kontraktorëve nuk janë marrë masat e duhura për sigurimin e të gjithë sinjalistikës horizontale dhe vertikale, parmakëve të sigurisë në pajtueshmëri të plotë me Standardet Rrugore.

6. Sinjalistika rezultoi në disa raste jo e plotë, e papastër (me bojë të shpërbërë, e ndryshkur, me vizatime, me adezivë reklamash, jo në formë të drejtë lineare, etj.) e paqartë për shkak të dëmtimeve dhe me strukturë jo të mirë.
7. Për sa i takon sinjalistikës horizontale, në disa raste ky element rezultoi jo prezent, jo i qartë dhe në shumë raste i ndërprerë.
8. Mbrojtëset metalike rezultuan në disa raste me deformime të dukshme si rezultat i aksidenteve të ndodhura dhe këto elementë të rëndësishëm të rrugës nuk janë rifreskuar apo riparuar, sipas rastit.
9. Në dosje nuk disponohen dokumentacioni në format foto dhe video.
10. Në disa raste drenazhet dhe kanalet e kullimit me dhe pa linjëzim rezultuan jo të pastra dhe me dëmtime të linjëzimit (për rastet me linjëzim) dhe me pengesa (gurë/vegjetacion/shkurre/aluvione/ etj.);
11. Nga verifikimi në terren i shërbimeve të kryera rezulton se në disa kontrata nuk është respektuar kushti i specifikimeve teknike në lidhje me zonën e lirë nga vegjetacioni (Vegetation free zone).
12. Nga verifikimi në terren rezultoi se në disa raste nuk janë kryer shërbimet e nevojshme për mirëmbajtjen rutinë të veprave të artit dhe të urave të përfshira në kontratë.
13. Në lidhje me bankinat në disa raste rezulton se nga ana e kontraktorëve nuk është siguruar qëndrueshmëria pa deformime dhe pa erozion e tyre. Konkretisht bankinat në disa raste rezultuan të pangjeshura dhe me gropëzime.
14. Një pjesë e zërave rezultojnë të mos jenë kryer në përputhje me specifikimet teknike si: materialet e dala nga gërmimet e kanaleve nuk janë transportuar gjithmonë jashtë rrugës; tombinot rezultuan me depozitime ose të pa pastruara nga bimësia; bankinat rezultuan me gropa dhe valëzime dhe me material shtesë të pa përshtatshëm; në disa prej akseve rrugore, u konstatua prezencë gurishtetsh, gurësh, dherash dhe materiale të tjera; riparimi i gropave është kryer jo në formë të rregullt gjeometrike dhe me kënde të drejta; zëri mbushje dhe profilimin i nënshtresave në rrugët me asfalt në disa prej rasteve nuk është kryer ose është kryer më një cilësi shumë të ulët nga ajo e kërkuar; zëri *Mbushje me profilim në rrugët e pashtruara* rezulton se qenë jo efektiv në 100 % të masës në të cilën është përdorur. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Kontratën e shërbimit me objekt *'Supervizion mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Verior* me nr. 96/25 prot., datë 27.08.2021, Kontratën e shërbimit me objekt *'Supervizion mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Qendror'* me nr. ref. 90248 – 03 – 17 – 2021, Kontratën e shërbimit me objekt *'Supervizion mirëmbajtje me performancë të rrugëve* Drejtorinë e Rajonit Jugor Gjirokastër" me nr. 96/34 prot datë 08.10.2021, Specifikimet Teknike, Pika 2.3 *Funksionet e Personelit Kyç*, Pika 2.4 *"Puna paraprake para fillimit të punimeve"*, germa a, Pika 6 *Masat e Qëndrueshmërisë për rrugët e shtruara*, Pika 7 *Sinjalistika dhe Siguria e Rrugës*, Specifikimet Teknik, Pjesa C, pika 1, germa b *Marrja në dorëzim e seksionit rrugor për fillimin e implementimit të mirëmbajtjes*, paragrafi i fundit, Pika 8 *Kullimi/Drenazhet*, Pika 9 *Bimësia*, Pika 10 *Veprat e artit*, Pika 11 *Skarpate – Gërmimet dhe Bankinat*, Etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 27 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH si dhe Drejtorëve të Drejtorive Rajonale, në bashkëpunim me mbikëqyrësit e kontratave të shërbimeve si dhe inspektorët e kontratave, të merren masat e nevojshme e të mjaftueshme për të realizuar të gjitha parashikimet e kontratës dhe si dhe mbajtjen e penaliteteve në rastet e mos arritjes së niveleve të kërkuara të shërbimit me qëllim rritjen e cilësisë së mirëmbajtjes së aseteve rrugorë sipas standardeve më të mira bashkëkohore për të garantuar jetëgjatësinë dhe

shfrytëzimin e rrugës, efikasitetin e shpenzimeve të fondeve publike për këtë qëllim si dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së investimeve.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit përkatës në lidhje me zbatimin e kontratave gjatë fazës së auditimit në terren, konfirmohet fakti se ecuria e kontratave të lidhura mes OE dhe AK nuk ka ndjekur parashikimet e bëra në dokumentin *SPECIFIKIMET TEKNIKE, Për Shërbimin e Mirëmbajtjes me Performancë të Rrugëve* si dhe nuk është realizuar në përputhje me *Qëllimin e Investimit*, pasi punimet e rehabilitimit jo në të gjitha rastet janë kryer me fillimin e kontratës të cilat kanë qenë detyrimisht për tu kryer brenda vitit të parë të kontratës, kjo me qëllim sjelljen e rrugëve në kushte të pranueshme e për të vijuar më tej me kryerjen e punimeve/shërbimeve periodike. Nga krahasimi i fakteve si më sipër rezulton se i janë likuiduar Kontraktorëve të punimeve shuma përkatëse për punime mirëmbajtjeje rutinë në një kohë kur ende nuk janë marrë masat e nevojshme për të sjellë rrugën në një nivel dhe standard të pranueshëm përmes ndërhyrjes në akse me punime rehabilitimi/periodike. Në dosje nuk disponohet asnjë urdhër i veçantë nga ana e mbikëqyrësit për shtyrjen e afatit 1 vjeçar të periudhës së ndërhyrjes përmes rehabilitimit. Sa më sipër është në kundërshtim me Kapitullin I, Pjesa A1, Pika 2.2.1 *Si shprehen punimet e periodike/rehabilitimi*, Pika 2.2.4 *Përshkrimi i Punimeve Periodike/Rehabilitimit*, Termat e Referencës së kontratës së Supervizionit për mirëmbajtjet, pika 1.4 *Koncepti i Kontratave me Performancë* si dhe Pika 1.5 *Një përshkrim i shkurtër i Kontratave Tip Performancë.*
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 27 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1 Rekomandimi: Nga ana e ARRSH si dhe Drejtorive Rajonale, në bashkëpunim me mbikëqyrësit e kontratave të shërbimeve si dhe inspektorët e kontratave të merren masat e nevojshme për kryerjen e të gjitha punimeve të rehabilitimit të kontratave pasi kryerja paraprake e tyre besohet të jetë e përshtatshme për të siguruar pajtueshmëri me Nivelet e Shërbimeve të kërkuara nga Kontratat, kjo me qëllim rritjen e cilësisë së mirëmbajtjes së aseteve rrugorë sipas standardeve më të mira bashkëkohore për të garantuar jetëgjatësinë dhe shfrytëzimin e rrugës, efikasitetin e shpenzimeve të fondeve publike për këtë qëllim si dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së investimeve.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me pasqyrat financiare rezulton se në Drejtorinë Rajonale të Veriut:
1. Nën rubrika *"Llogari të arkëtueshme"* paraqitet në vlerën **43,211,257 lekë** për vitin 2020, nga **1,654,412 Lekë** që ka qenë në vitin 2019, e cila pasqyron operacione me shtetin (të drejta), si dhe gjendjen e debitorëve të viteve të kaluara.
2. Llogaria 486 *"Shpenzime të periudhave të ardhshme"* është 107,707,919 **lekë** në fund të vitit 2020. Të cilat janë detyrime të prapambetura të krijuara për kontratat e mirëmbajtjes së rrugëve gjatë vitit 2020.
-*Në Drejtorinë Rajonale të Jugut konstatohet se:*
1. Nën rubrika *"Llogari të arkëtueshme"*, në shumën **14,661,942** lekë, pasqyron gjendjen e debitorëve të viteve të kaluara **13,421,781** lekë. Llogaria 4342 "Operacione me shtetin, debitorë", në shumën **1,240,161** lekë pasqyron detyrimin e shtetit ndaj institucionit për marrjen e grantit, lidhur me shlyerjen e kreditorëve të vitit paraardhës, në vlerën **773,528** lekë, dhe në shumën **1,222,908** lekë të detyrimeve ndaj punonjësve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, TAP, (llogaritë kundër parti (llogaritë 421,431,435,436), si dhe llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", në postin B / Pasive të Pasqyrës së Pozicionit Financiar).
2. Llogaria 4341 *"Operacione me shtetin - detyrime"*, paraqitet në vlerën 13,421,781 lekë, me kundër parti në aktivin e bilancit, në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm", dhe pasqyron të

drejtat e institucionit ndaj të tretëve, të cilat duhet të derdhen në buxhet. Kjo shuma është e mbartur nga vitet e kaluara.
-Rezulton se në Shënimet Shpjeguese nuk ka sqarime lidhur me këta zëra, dhe si e tillë situata është e paqartë dhe nuk jep siguri të arsyeshme për saktësinë e vlerave të paraqitura në Pasqyrat Financiare.
-Shënimet shpjeguese paraqiten të paqarta, të paplota dhe të pa kuptueshme.
Sa më sipër është në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 2, paragrafi 49, pikat c dhe d.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqen nr. 37 – 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
7.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH si dhe Drejtorëve të Drejtorive Rajonale, Sektori i Financës të merren masa lidhur me plotësimin dhe pasqyrimin e saktë të transaksioneve dhe lëvizjeve kontabël në shënimet shpjeguese.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësve të kontratave të shërbimeve tepër në vlerë si rrjedhojë e likuidimit të punimeve/shërbimeve të pakryera në fakt në shumën totale prej **1,785,568 lekë pa TVSH**, vlerë kjo e cila jepet e detajuar sipas Aneksit nr. 4. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Kontratën e shërbimit me objekt *'Supervizion mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Verior* me nr. 96/25 prot., datë 27.08.2021, Kontratën e shërbimit me objekt *'Supervizion mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Qendror'* me nr. ref. 90248 – 03 – 17 – 2021, Kontratën e shërbimit me objekt *'Supervizion mirëmbajtje me performancë të rrugëve* Drejtorinë e Rajonit Jugor Gjirokastër" me nr. 96/34 prot datë 08.10.2021.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 27 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH si dhe Drejtorëve të Drejtorive Rajonale, në bashkëpunim me mbikëqyrësit e kontratave të shërbimeve të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës totale prej **1,785,568 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësve të kontratave për shërbime/punime të pakryera por të likuiduara në kontratat përkatëse të sipërmarrjes në vlerat të cilat jepen të detajuara sipas Aneksit nr. 4.

Menjëherë

C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit përkatës në lidhje me zbatimin e kontratave rezulton se janë përfshirë në mirëmbajtje rrugore edhe akse të cilat janë cilësuar si të amortizuara dhe me domosdoshmëri ndërhyrjeje përmes investimeve totale. Në fakt përfshirja e akseve në gjendje të tillë ka sjellë si pasojë përdorimin pa efektivitet eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve prej të paktën shumën prej **21,980,880 lekë pa TVSH** dukë bërë që ndërhyrjet të mos kenë impakt të dukshëm në mirëmbajtjen e rrugëve, konkretisht në zëra si *Riparimi i gropave të asfaltit, Mbushje dhe profilim i nënshtresave në rrugët me asfalt, Riparimi dhe rifreskimi i sinjalistikës horizontale, Riparimi dhe rifreskimi i sinjalistikës*

vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore (mbrojtëset metalike) dhe ndriçimit si dhe *Mirëmbajtje rutinë e veprave të artit*. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, Neni 1, *"Objekti dhe qëllimi"*.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 27 – 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH si dhe Drejtorëve të Drejtorive Rajonale, të merren masa për përfshirjen në preventivat përkatës të marrëveshjeve kuadër në të ardhmen të atyre zërave të cilat kanë impakt të dukshëm dhe që rrisin cilësinë e mirëmbajtjes së aseteve rrugorë sipas standardeve më të mira bashkëkohore për të garantuar jetëgjatësinë dhe shfrytëzimin e rrugës duke siguruar kështu edhe një investim të qëndrueshëm.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë Rajonale Qendrore konstatohet se në zërin *Shërbime nga të Tretët* (klasa 602), *Shërbime bankare* (përmbarimi), nga planifikimi në vlerën 0 lekë është kaluar në një realizim fakti në vlerën 4,391,629 lekë, pra tejkalimi rezulton në vlerën 4,391,629 lekë. Ky tejkalim vjen si pasojë e likuidimit të ekzekutimit të detyrueshëm me Urdhër Shpenzimin nr. 183, datë 28.12.2020 nga ana e DQT, ku është shlyer detyrimi në vlerën **4,006,960 lekë**, ndaj V. K., dhe zyrës përmbarimore "J. A. PF" vlerën **384,669 lekë** (tarifë përmbarimore). Me vendimin e Gjykatës të Apelit Administrativ Tiranë, nr. 742, datë 20.07.2020, është lëshuar urdhri i ekzekutimit me nr. 4, date 23.12.2020 për faturat tatimore të shitjes të shoqërisë V. K.. Sa më sipër, tarifa përmbarimore, me vlerë **384,669 lekë** konsiderohet **efekt financiar negativ** për buxhetin e shoqërisë dhe është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, neni 12, pika 3.gj <u>*ku përcaktohet se*</u>: *"…garantimin që të gjithë kreditorët të paguhen në kohë dhe në rastet kur kreditorët nuk janë paguar apo në rast ankesash…"*.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqen nr. 37 – 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
<u>2.1 Rekomandimi</u>: Nga sektori i Financës, të merren masa për zbatimin e përcaktimeve të kontratave dhe shlyerjen në kohë të detyrimeve ndaj furnitorëve.

Në vijimësi

D. <u>MASA DISIPLINORE</u>

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 - Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe Kontratës kolektive për punonjësit e ARRSH, kërkojmë nga Drejtori i Përgjithshëm fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore për punonjësit të cilët janë konstatuar me shkelje nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

V. ANEKSE

Aneksi nr. 1 – Trajtimi i zgjeruar i auditimit të zbatimit të rekomandimeve.

Në zbatim të pikës 1 të Programit të Auditimit nr. 385/1prot., datë 04.05.2022, *"Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së"*, u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e .

-Për 27 gjetje janë rekomanduar 36 masa organizative gjithsej, nga të cilat 2 janë zbatuar plotësisht, 1 është zbatuar pjesërisht, 25 janë në proces zbatimi, nuk janë zbatuar 3 dhe nuk janë pranuar 5.

-Nga 3 masa për shpërblim dëmi të rekomanduara gjithsej në vlerën 62,110,052 lekë dhe 41,475 Euro (ose 5,050,411 lekë), 0 janë zbatuar plotësisht , 0 janë zbatuar pjesërisht , 1 është në proces zbatimi në vlerën 1,154 Euro (ose 140,523 lekë) nuk janë pranuar 2 rekomandime që kanë të bëjnë me vlerën 40,321 Euro (ose 4,909,889 lekë) dhe 62,110,052 lekë.

-Nga 4 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet të fondeve publike të rekomanduara gjithsej në vlerën 137,500,000 lekë dhe 1,965,011 Euro (ose 240,872,105 lekë), 0 janë zbatuar plotësisht ,0 janë zbatuar pjesërisht, 2 janë në proces zbatimi për vlerën 290,811 Euro (ose 35,891,893 lekë), 1 nuk është zbatuar për vlerën 1,674,200 Euro (ose 204,980,212 lekë) dhe nuk është pranuar 1 për vlerën 137,500,000 lekë .

-Nuk ka masa disiplinore të rekomanduara.

ARRSH, ka marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna në zbatim të shkresës nr. prot. 599/12 prot., datë 09.01.2020 dhe ka informuar Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve, me shkresën nr. 306/6 prot., datë 05.06.2020 "Informacion mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH për auditimin e kryer në bazë të programit të auditimit nr. 599/1 datë 09.09.2019.

Nga auditimi i zbatimit të afatit 20 ditor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH konstatohet se nga ARRSH, nuk është respektuar afati 20 ditor i kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimit në zbatim të nenit 15 germa "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Nga auditimi i zbatimit të afatit 6 mujor për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, konstatojmë se është zbatuar nga ARRSH, i cili ka informuar KLSH për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2914"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", me shkresën nr. nr. 4764 prot. datë, 01.07.2020 "Për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi auditimin e Përputhshmërisë për projektin "Mirëmbajtje dhe Siguria Rrugore bazuar në rezultate".

ARRSH, rekomandimet e lëna nga auditimi i KLSH i ka zbatuar dhe trajtuar si më poshtë vijon:

-Për 27 gjetje janë rekomanduar 36 masa organizative gjithsej, nga të cilat 2 janë zbatuar plotësisht, 1 është zbatuar pjesërisht, 25 janë në proces zbatimi, nuk janë zbatuar 3 dhe nuk janë pranuar 5.

-Nga 3 masa për shpërblim dëmi të rekomanduara gjithsej në vlerën 62,110,052 lekë dhe 41,475 Euro (ose 5,050,411 lekë), 0 janë zbatuar plotësisht , 0 janë zbatuar pjesërisht , 1 është në proces zbatimi në vlerën 1,154 Euro (ose 140,523 lekë) nuk janë pranuar 2 rekomandime që kanë të bëjnë me vlerën 40,321 Euro (ose 4,909,889 lekë) dhe 62,110,052 lekë.

-Nga 4 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet të fondeve publike të

rekomanduara gjithsej në vlerën 137,500,000 lekë dhe 1,965,011 Euro (ose 240,872,105 lekë), 0 janë zbatuar plotësisht , 0 janë zbatuar pjesërisht, 2 janë në proces zbatimi për vlerën 290,811 Euro (ose 35,891,893 lekë), 1 nuk është zbatuar për vlerën 1,674,200 Euro (ose 204,980,212 lekë) dhe nuk është pranuar 1 për vlerën 137,500,000 lekë .
-Nuk ka masa disiplinore të rekomanduara.

REZULTATET E AUDITIMIT

Realizimi i rekomandimeve në mënyrë të detajuar pasqyrohet si më poshtë vijon:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Subjekti Autoriteti Rrugor Shqiptar nuk ka kthyer përgjigje në KLSH në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH ka ngritur grup pune me urdhrin nr. 84 datë 03.6.2020 mbi hartimin e planit të masave mbi zbatimin e rekomandimeve të lënë nga KLSH për projektin *"Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate"* dhe ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 306/6 prot., datë 05.06.2020"Informacion mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH për auditimin e kryer në bazë të programit të auditimit nr. 599/1 datë 09.09.2019. Në këtë shkresë Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH, bën me dije se vonesa për njoftimin e PMU-së në lidhje me raportin përfundimtarë dhe rekomandimet si dhe fillimi për implementimin e tyre është bërë për shkak të situatave të krijuara si fillim me ngarkesat e shumta të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH dhe grupeve të punës në mbështetje të shtabit të emergjencave civile për eliminimin e dëmeve të krijuara nga tërmeti i vitit 2019, këto bazuar në urdhrin nr. 328, datë 26.11.2019 dhe urdhrin nr. 328/1 datë 27.11.2019 si dhe situatës COVID- 19. Raporti i është përcjellë projektit me shkresën nr. 306/5 datë 04.06.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH.
Në programin e punë për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të hartuar është përcaktuar afati kohorë për secilën masë personat përgjegjës për zbatimin e tyre.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6-muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për projektin *"Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate"* Autoriteti Rrugor Shqiptare ka përmbushur detyrimin e afatit 6-mujor të raportimit dhe ka kthyer përgjigje ne KLSH me shkresën nr. 4764 prot datë, 01.07.2020 "Për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi auditimin e Përputhshmërisë për projektin "Mirëmbajtje dhe Siguria Rrugore bazuar në rezultate".

III. B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Grupi i Menaxhimit të Projektit në dakordësi me Bankën Botërore ka bërë kërkesë për shtyrjen e afatit të përfundimit të marrëveshjes me shkresën nr. 9592 prot., datë 21.10.2019 "Rishikimi dhe amendimi i marrëveshjes së huas". ARRSH i ka dërguar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë kërkesën për komunikim me Ministrinë e Financave lidhur me amendimet e kërkuara dhe argumentet përkatëse. Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 71, datë 02.07.2015 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin "Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate", pjesa 4 përcaktohet se "Viti 1" i Projektit është viti 2016 dhe "Viti 5" është viti 2020. Referuar dakordësisë me Bankën kërkohet që "Viti 1" i projektit të ripërcaktohet si viti kalendarik 2017 dhe "Viti 5" të jetë viti 2021. Data e përfundimit të kësaj marrëveshje huaje të ripërcaktohet data 30 Qershor 2022.

Gjithashtu nga palët kërkohet modifikimi i Indikatorëve të Disbursimit 2.1 dhe 2.2, ku i pari ka të bej me sondazhet e sigurisë së rrugës (iRAP) dhe i dyti me afatin final i realizimit të tij Kërkesa për rishikimin dhe amendimin e marrëveshjes së huas është dërguar në ministrinë e linjës me vonesë ndërkohë që procedurat për ndryshimin e marrëveshjes duhet te kishin nisur menjëherë pas lidhjes së kontratave në janar dhe shkurt të vitit 2017 të lidhura një vit me vone nga përcaktimi në marrëveshje. *(Me hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 15-24 të Raportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: *Nga Grupi i Menaxhimit të Projektit të merren masa për ndjekjen dhe realizimin sa më të shpejtë të procedurave të miratimit të këtij amendimi, për përfundimin në kohë dhe me sukses të Projektit.*

Menjëherë

1.2. Rekomandim: *Ministri i MIE të analizojë shkaqet e kësaj situate, ku amendimet e marrëveshjes shikohen si një nevojë reale dhe t' a shoqërojë me përgjegjësi konkrete të çdo niveli për të eliminuar përsëritjen e situatave të tilla në këtë projekt.*

Menjëherë

Rekomandimi është në proces

ARRSH i ka dërguar MIE kërkesën për komunikim me Ministrinë e Financave lidhur me amendimet e kërkuara dhe argumentet përkatëse për zgjatjen e afatit të huas, shkresë me nr prot 9592, datë 21.10.2019. Marrëveshja është futur si procedure dhe pritet te firmoset nga Këshilli i Ministrave vendimi respektive.

2. Gjetje nga auditimi: Realizimi i ILD-ve (Indikatorët e Lidhur me Disbursimin) në vitet 1 dhe 2 të Projektit (2016 dhe 2017) për komponentët e përcaktuar nuk është realizuar në afat, për shkak se Kontratat e Mirëmbajtjes së Projektit janë lidhur me vonesë, ndërkohë që këto kontrata duhet të ishin lidhur që në vitin 2016 (viti i parë i zbatimit të Projektit), konkretisht janë lidhur një vit më vonë.

Po ashtu rezulton se realizimi i ILD-ve për vitin e tretë (viti 2018) është në masën 40.05%.

Mosrealizimet e indikatorëve janë për indikatorin 1.1 për mirëmbajtjen periodike të rrjetit kombëtar të rrugëve është realizuar në masën 60.2%, për indikatorin 1.3 për zhvillimin dhe operacionalizimin e Sistemit të Transparencës Sociale nuk është realizuar (0%), dhe për indikatorin 2.1 për auditët vjetorë të sigurisë rrugore nuk është realizuar (0%).

-Në lidhje me procedurën e disbursimit të ILD-ve nga auditimi u konstatua se raporti i auditimit të ILD-ve me korrigjimet përkatëse sipas komenteve të Menaxherit të Projektit është dorëzuar në format elektronik nga kompania ndërkombëtare NTU në datën 29.03.2019. Pas kësaj date kanë vijuar komentet e Menaxherit të Projektit lidhur me çështje tashmë të marra në konsideratë. Këto komente konsistojnë në llogaritjen e ILD-ve duke marrë parasysh se kontratat e mirëmbajtjes me kontraktorët janë lidhur në janar dhe shkurt të vitit 2017, ndërkohë që duhet të ishin lidhur në vitin "1" të Projektit pra në vitin 2016. Në datën 11.04.2019 me konfirmimin e Bankës Botërore ndërpritet puna audituese deri në verifikimin e këtyre komenteve të cilat janë shkak i mos dakordësisë midis Menaxherit të Projektit dhe kompanisë audituese NTU. Ndërkohë nga ana e NTU këshillohet që Menaxheri i Projektit të rilexojë raportin paraprak të auditimit të ILD-ve. Në datën 29.04.2019 vjen konfirmimi i raportit të datës 29.03.2019 në format elektronik duke konfirmuar kështu që komentet e Menaxherit të Projektit tashmë ishin marrë në konsideratë, si dhe kërkohet vazhdimi i procedurave të mëtejshme të disbursimit të fondeve me dokumentacion justifikues. Komentet e Njësisë të Menaxhimit janë të nevojshme, por nga ana e tyre duhet mbajtur parasysh se tejkalimi i afateve të përcaktuara në POM dëmton procesin e disbursimit të fondeve. *Referuar Manualit Operacional të Projektit, pika 35/i është përcaktuar se afati për të hartuar Progres Raportin e gjysmës së vitit është jo më vonë se 45 ditë nga përfundimi i periudhës raportuese*

duke përfshirë parashikimin e financimit për periudhën e ardhshme; si dhe rezultatet dhe kornizën e arritje të IlD-ve. Pas korrespondencave të vazhdueshme midis Menaxherit të Projektit dhe Specialistes së Menaxhimit Financiar në lidhje me vijimin e përgatitjes së dokumenteve justifikuese për disbursimin e ILD-ve, vetëm me shkresën nr. 5417 prot., datë 05.06.2019 "Përmbushja e kushteve të disbursimit të ILD-ve të Marrëveshjes së Kredisë Nr.8489-ALB për Projektin Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore bazuar në rezultate ", dërguar Menaxheres Rajonale të Bankës njoftohet përmbushja e kushteve për disbursim i vlerës prej 19.575 milionë Euro, krahasuar me vlerën 42.219 milionë Euro e cila ishte parashikuar të realizohej nga Viti 1 në Vitin 3 të Projektit. Pra sa më sipër kjo shkresë është dërguar 36 ditë me vonesë. Gjithashtu konstatohet se nga data 29.04.2019 deri në përfundim të auditimit nuk ka nisur proceduara e disbursimit të fondeve me dokumentacion justifikues. Një nga shkaqet e kësaj vonese është pushimi nga puna e Specialistes së Menaxhimit Financiar në datën 16 Korrik 2019, duke bërë kështu të pamundur vazhdimin e aplikimit për disbursimin e fondeve të huas. Kjo nuk e justifikon vonesën në hartimin e dokumentacionit justifikues, për më tepër duke pasur parasysh gjendjen kritike të fondeve të këtij Projekti.
Këto veprime bien në mos përputhshmëri me përcaktimet e Manualit të Operacioneve të Projektit, pikat 23/2, 32/5 dhe 119/4, 119/5, 119/6. (Me hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 24-36 të Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandim: *Grupi i Menaxhimit të Projektit të hartojë planin e masave për të ndjekur, zbatuar dhe realizuar në kohë objektivat e përcaktuara në Marrëveshjen e Huas, jo vetëm për periudhën aktuale por, dhe për periudhat e prapambetura.*

Vazhdimisht

Rekomandimi është në proces
Referuar shkresave të vëna në dispozicion nga Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH. PMT ka punuar për realizimin e të gjithë kushteve dhe më datë 12.11.2019 ka dërguar kërkesën për tërheqjen e fondeve në shumën 17 milion euro, që është edhe shuma e parashikuar për dy vitet 2018-2019. Disbursimi i fondeve ka dy kushte, (1) arritja e DLI-ve, (2) përgatitja dhe aprovimi i raporteve financiare të projektit (IFR). Në rastin konkret, për disbursimin për të cilin i referohemi, kushti (2) ishte miratimi i IFR të vitit 2018, miratim i cili ka ardhur nga Banka Botërore më datë 28 Tetor 2019.

2.2. Rekomandim: *Grupi i Menaxhimit të Projektit të marrë masa për hartimin në kohë të raporteve financiare, të ILD-ve dhe ato teknike. Të merren masa për hartimin në kohën e duhur të dokumenteve justifikuese lidhur me disbursimin e fondeve të huas.*

Vazhdimisht

Rekomandimi është në proces.
Në dt. 20/11/2019 është lëvruar kësti i radhës nga Banka Botërore në Llogarinë respektive në Bankën e Shqipërisë. Për sa i përket procedurave të disbursimit për vitin 2020, PMT, pas miratimit të Raportit të Auditit të pavarur për vitin 2019, në dt. 29/04/2020 ka dërguar për miratim pranë Bankës Botërore, miratimin e arritjeve të DLI-ve dhe pritet miratimi i tyre për të vijuar më tej me procedurat e disbursimit të radhës.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave për 4 kontratat e punimeve civile në vlerë të ndryshuar 60,855,150 Euro dhe 1 kontratë e konsulentit monitorues në vlerën me vlere 5,880,360.00 Euro, për punime të situacionura dhe miratuara nga muaji Qershor 2019 – Shtator 2019, ka rezultuar shuma e pa paguar në vlerën 2,784,987.79 Euro për pjesën e kredisë, si pasojë e mungesës së mjeteve monetare të llogarisë në Euro në C. B. Kjo ka ardhur

si pasojë e zvarritjes dhe mosveprimeve në kohë, konform procedurave të miratuara për tërheqjen e shumave për disbursim.
Gjithashtu mungesa fondesh janë paraqitur dhe për fondet e Qeverisë Shqiptare (GOA) për Kosto Lokale dhe TVSH në vlerën 1,808,024 Euro si rezultat i çeljes së fondeve në buxhetin vjetor në nivel më të ulët se kërkesa e projektit dhe ARRSH. Për një pjesë të fondeve për TVSH dhe Kosto Lokale është kërkuar rialokim fondesh nga fondet e lira të projekteve në vartësi të ARRSH. Gjithashtu nga Titullari i ARRSH nuk rezultoi dërgim kërkesë për shtesë fondesh në Ministrinë e linjës dhe Ministri të Financave dhe Ekonomisë për TVSH dhe Koston Lokale për ato fonde që nuk mbulohen nga rialokimi i kërkuar deri në momentin e auditimit si dhe për situacionet që janë në vijim për pagesë për muajt tetor dhe nëntor 2019. (*Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 36-52 të Raportit të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi*:* Nga Drejtori i Projektit dhe Menaxhimi i Projektit të merren masat e menjëhershme për aplikimin e tërheqjen se shumës së miratuar të disbursimit dhe kryerjen e pagesave në mënyrë të njëpasnjëshme, duke mos krijuar hapësira kohore nga veprimi në veprim dhe përfunduar pagesat e miratuara, menjëherë me tërheqjen e disbursimit.

Menjëherë

Rekomandimi është realizuar.
Disbursimi i fondeve të komponentit IBRD është realizuar në datë 20.11.2019 dhe janë kryer te gjitha pagesat e prapambetura brenda muajit Dhjetor 2019.

3.2. ***Rekomandimi****:* Nga Drejtori i ARRSH dhe Drejtoria e Buxhet -Financës të insistohet në përshpejtimin e procesit të miratimit të rialokimeve të miratuara nga Bordit i menaxhimit të ARSH " Mbi rialokimin e fondeve të Buxhetit të vitit 2019, proces që pret miratimin nga MIE dhe MF, deri në momentin e auditimit i pa konfirmuar. Programimi i kostove buxhetore të sigurojë që pagesat e TVSH-së dhe kostos lokale të realizohen në kohë reale.

Menjëherë

Rekomandimi është realizuar pjesërisht.
Ky proces është realizuar në dhjetor të vitit 2019 dhe u plotësua pjesërisht diferenca nga kosto lokale dhe TVSH. Referuar shkresës së ARRSH-së, drejtuar MIE, nr. 1718.1 prot., datë 27.02.2020 "Mbi rialokimin e kredisë".

3.3. ***Rekomandimi****:* Nga Drejtori i ARRSH dhe Drejtoria e Buxhet –Financës, referuar saktësimit të shifrave dhe përditësimit të tyre për nevojat për fonde për Kosto Lokale dhe TVSH të pambuluara nga rialokimi i fondeve, të kërkohen fonde shtesë për mbulimin e nevojave të vitit 2019, duke theksuar faktin që projekti është në kushtet e aplikimit të penaliteteve të paraqitura zyrtarisht nga kontraktorët. Ky fakt të jetë i theksuar edhe në çdo fazë të hartimit të buxhetit për vitet në vijim, pavarësisht, tavaneve për buxhetin të miratuara me VKM dhe të paraqitura nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

Menjëherë

Rekomandimi është realizuar.
Në Dhjetor të vitit 2019, është reflektuar tek kërkesa që projekti ka bërë për buxhetin e vitit 2020. Për këtë problem PMT ka nisur dy shkresa drejtuar Ministrisë se Infrastukturës dhe Energjitikës me nr, 2737, date 14.04.2020 dhe me nr 3497, date 18.05.2020. Në këto shkresa është ngritur problemi i mangësisë së fondeve buxhetore që i janë çelur projektit për vitin 2020.
4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se punimet e kryera dhe të përfunduara për projektet (CHO) e rrugëve nuk janë dorëzuar në ARRSH, pasi kontraktori akoma nuk ka

disponibël dokumentin e certifikatës së dorëzimit provizor dhe për rrjedhojë nuk ka filluar dhe përfunduar periudha e garancisë së punimeve, pavarësisht se shumë nga këto punime kanë mbi 6 muaj dhe 1 vit që kanë përfunduar për secilën kontratë. Kjo situatë ka ardhur si pasojë e faktit se kontraktori (i cili kryen dhe rolin e kolaudatorit dhe supervizorit) nuk ka përgatitur setin e dokumenteve të nevojshëm për këtë fazë referuar kushtit të kontratës PC 28.1, për rrjedhojë nuk është kryer dhe shqyrtimi i dokumentacionit dhe monitorimi i punimeve nga konsulenti monitorues, proces i domosdoshëm që realizohet para marrjes së certifikatës së përkohshme të punimeve. Në kontratë referuar kushteve të saj PC 28.1 dhe PC 28.2, nuk ka të përcaktuar afat kohor për këtë proces pra, as për kontraktorin dhe as për konsulentin monitorues, në një kohë që aktualisht referuar njoftimeve për përfundim të punimeve, ka përfunduar 60% e afatit të realizimit të punimeve civile sipas projekteve të miratuar dhe kontraktorët vazhdojnë punimet në projektet e radhës duke shtuar kështu ngarkesën e punës dokumentare për periudhën e fundit të zbatimit të kontratave.

- Gjithashtu theksojmë se punimet e emergjencës referuar shqyrtimit të kontratave nuk kanë afat të përcaktuar për garanci punimesh. Referuar argumentimit të dhënë rezultoi arsyetimi se kontraktori vazhdon të jetë përgjegjës për segmentet e mbuluara me mirëmbajtje deri në fund të kontratës. Referuar këtij argumentimi japim shpjegimin se me përfundimin e afatit të kontratës (në 31 Dhjetor të vitit 2021) punimet e emergjencës të cilat mund te kryhen në vitin e fundit të punimeve mbesin të pambuluara me periudhë garancie dhe përgjegjësie. *(Më hollësisht trajtuar në pikën F faqe 123-127 të Raportit të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi*: Nga Drejtori i projektit dhe Njësia e Menaxhimit të projektit në dakordësi me kontraktonin dhe konsulentin monitorues, të vlerësohet dhe përcaktohet afati i nevojshëm nga raportimi i projektit të përfunduar deri në dorëzimin e tij, për marrjen e TO (certifikatën e dorëzimit të përkohshme). Ky afat duhet të ketë të përcaktuar qartë afatin e kontraktorit për hartimin e setit të dokumentacionit të projektit të përfunduar, që duhet ti dorëzojë tek konsulenti monitorues dhe kohën për shqyrtim dhe miratim të konsulentit monitorues, kjo në referencë të akteve ligjore në fuqi (shqiptar apo i huaj) që mbulojnë këto afate kohore.*

Në vazhdim

Rekomandimi nuk është realizuar.

Nga PMT komentohet se në lidhje me këtë rekomandim do të duhej dakordësia e palëve e cila me pas do te duhej të formatizohej nëpërmjet nënshkrimit te një amendimi të ri.

Procedurat dhe afatet për dorëzimin e dokumentacionit te nevojshëm për projektet e përfunduara (i.e marrjen ne dorëzim të përkohshëm & përfundimtar) janë te parashikuara ne kontrate dhe specifikime teknike (Kontrata Origjinale dhe sipas revisionimeve/Amenduara). Gjithashtu ne kontrate janë parashikuar edhe penalitetet te cilat rrjedhin si pasojë e mos-përmbushjes (i.e dorëzimin jashtë afateve te përcaktuara) se detyrimeve kontraktuale. Nëse këto afate janë te pa-pranueshme nga audituesit atëherë duhen propozime konkrete si duhen te ndryshohen.

4.2. Rekomandimi*: Nga Drejtori i Projektit dhe Njësia e Projektit në dakordësi me kontraktonin dhe konsulentin monitorues, të merren masa që të bëhen ndryshime me amendament për periudhën e garancisë për punimet e emergjencës, pavarësisht natyrës së tyre permanente apo strukturore, domosdoshmëri kjo për projekte që mund të jenë të mundshme në vitin e fundit të kontratës dhe që nuk mbulohen me periudhë garancie dhe përgjegjësie me përfundimin e kontratës.*

Në vazhdim

Rekomandimi nuk është zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave u konstatuan shumë raste ku data e faturës së paraqitur nga kontraktorët dhe konfirmuar nga Menaxheri i projektit, ka një diferencë të madhe në kohë, e pa argumentuar, me datën e miratimit nga Menaxheri i projektit të

situacionit në kundërshtim me kapitullin "Faturimi" në ligjin nr. 92/2014" Mbi tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Me diferencë nga miratimi i situacionit paraqiten dhe datat e miratimit nga Menaxheri i projektit i autorizimit të faturës dhe të pagesës së faturës dhe për rrjedhojë, diferenca midis datës së faturës dhe konfirmimit të pagesës së faturës nga menaxheri i projektit në 39 situacione për 4 kontrata referuar 83 situacioneve të audituar, tejkalon afatin 14 ditësh në kundërshtim me klauzolën e kontratës GC 49.2 dhe afatin e përcaktuar për miratimet nga menaxheri i projektit në anualin e funksionimit të projektit.
Gjithashtu referuar klauzolës GC.50.1 të vendosura në kontratë, për çdo situacion të paraqitur nga kontraktori duhet të kryhet pagesa brenda 28 ditësh. Në këtë periudhë brenda 14 ditëve Menaxheri i Projektit miraton setin e dokumenteve për pagesë si situacion, autorizimin e faturës si dhe pagesën e faturës dhe periudha tjetër prej 14 ditësh i takon miratimit të pagesës nga Drejtori i Projektit dhe mbas këtij fakti përgatiten nga Menaxherja financiare dhe struktura e financës së ARRSH urdhër shpenzimet për pagesë për pjesën e IBRD dhe për pjesën e GOA-s për Kosto Lokale dhe TVSH, ku kjo pjesë nuk është e ndarë në kohë midis strukturave që i përgatit dhe miraton ato. *(Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 36-52 të Raportit të Auditimit).*
***5.1.Rekomandimi**:*Nga Menaxheri i projektit të shmangen rastet ku data e faturave tatimore është e ndryshme nga data e situacionit bashkëlidhur dhe paraqitur zyrtarisht në ARRSH.
Gjithashtu për efekte të respektimit të afateve dhe kursit të këmbimit në datën e prerjes së faturës të shmangen rastet e paraqitjes faturave dhe situacionit me diferenca në kohë nga data e paraqitjes së tyre zyrtare.

Menjëherë

Rekomandimi është në proces.
Aktualisht Projekt Menaxher i Projektit ka lidhur Kontratën me ARRSH në datë 02.03.2018 dhe ka çertifikuar të gjitha pagesat e prapambetura deri në ato momente. nga ana e MC/Supervizori pagesa është protokolluar pranë ARRSH në një datë, ndërsa Fatura e TVSH rezulton të jetë prerë më herët se Certifikimi i IPC nga ana e MC. Konkretisht për IPC 15 dhe 16 nga data e hyrjes në protokollin e ARRSH (17.07.2018 dhe 24.07.2018) janë dashur vetëm 13 ditë për IPC 15 dhe 9 ditë për IPC 16 që të lëshohej certifikata e pagesës. Ky rekomandim do të shikohet në vazhdimësi nga KLSH për projektet e huaja sepse ka të bëjë me procese pune.

***5.2. Rekomandimi**:* Nga Drejtori i ARRSH (Drejtori i Projektit) për efekt të transparencës dhe përcaktimin e përgjegjësive, me rregulla dhe udhëzime të brendshme, të përcaktohet afati brenda 14 ditëve që duhet të ndahet midis ditëve të nevojshme të tij për miratimin e pagesave të projektit si dhe strukturës së Buxhet Financës për përgatitjen e urdhër shpenzimeve dhe kryerjen e pagesave në thesar për TVSH e Kosto Lokale si dhe pagesat e IBRD nga llogaria në Bankën e nivelit të dytë (C. B)

Menjëherë

Rekomandimi është në proces
ARRSH shprehet se gjatë implementimit të Projektit ka ndodhur të ketë vonesa për situacionet, për shkak edhe të fluksit të lartë të punëve dhe sasisë së lartë të situacioneve për t'u kontrolluar dhe aprovuar, gjë e cila do të merret parasysh dhe do të reflektohet në vijim të pagesave të tjera. Por, kjo nuk ka përbërë problem në vijueshmërinë e punëve nga ana e Kontraktorëve, nga ana tjetër asnjë prej tyre nuk ka kërkuar një dëm financiar shkaktuar kjo nga vonesa e pagesave.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se nga njësia e menaxhimit të projektit nuk ka pasur korrektësi në afatin e kryerjes së pagesave për: a- efekt të vonesave në miratimin e situacioneve dhe hartimit të autorizimeve përkatëse nga Menaxheri i Projektit në 39 raste; b- vonesa për efekt të mungesës së fondeve për TVSH e Kosto lokale ku aktualisht nga auditimi deri më 31 Tetor 2019 mungojnë fondet për 4 raste në shumën 116,446 euro për TVSH dhe 14 raste në shumën 1,691,578.61 Euro për Kosto Lokale; c-vonesa për mungesë të fondeve të kredisë në llogarinë e pagesave si rezultat i neglizhencave dhe zvarritjeve në kohë të përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm për tërheqjen e transhit të disbursimit në 19 raste në shumën 2,784,987.79 Euro.
Për mos korrektësinë në pagesa si dhe mos realizim të tyre deri në këtë moment për situacione të periudhës qershor – tetor 2019, nga kontraktorët janë paraqitur njoftime për kërkesë të penaliteteve (claim) referuar neneve dhe të drejtave të përcaktuara në kontratë si:
a. Nga operatori "G" shpk *për Kontratën A Loti 1* me dokumentin hyrje në ARRSH me nr. 4896, datë 21.5.2019 "Vonesa për pagesat e situacioneve të aprovuara për kontratën A ku referuar neneve, klauzolës 50.1 dhe 58.2 njofton për aplikimin e normave të interesave.
Gjithashtu ky kontraktor ka njoftuar me dokumentin hyrës në ARRSH me nr. 9191, datë 14.10.2019 "pagesa të vonuara për certifikata pagese të përkohshme" duke paraqitur dhe një llogaritje totale të pagesës së interesit për vonesat në pagesa të situacioneve (IPC). Referuar pasqyrës së paraqitur për penalitete të llogaritura për pagesa me vonesë rezultojnë të llogaritura penalitete për të gjithë periudhën e vitit 2017, 2018 dhe 2019.
b. Nga operatori "G" shpk *për Kontratën B Loti 2* me dokumentin hyrje në ARRSH me nr. 9200, datë 14.10.2019 "Pagesa të vonuara për certifikata pagese të përkohshme" për kontratën B ku referuar neneve, klauzolës 50.1 dhe 58.2 njofton për aplikimin e normave të interesave duke paraqitur dhe një llogaritje totale të pagesës së interesit për vonesat në pagesa të situacioneve (IPC). Referuar pasqyrës së paraqitur për penalitete të llogaritura për pagesa me vonesë rezultojnë të llogaritura penalitete për të gjithë periudhën e vitit 2017,2018 dhe 2019.
c. Nga operatori JV" E A & A L. për kontratën D Loti 4 me dokumentet hyrëse me nr.3086, datë 1.04.2019, nr.5287, datë 30.05.2019, janë kërkuar pagesat për ditë vonesë të rezultuara nga situacionet e Dhjetorit 2018 dhe të shkurtit 2019 të cilat nuk janë paguar deri më maj të 2019.
-Me dokumentin hyrës në ARRSH me nr. 8676, datë 24.09.2019 "Vonesa në pagesat e faturave" për situacionet 26 deri në 30.
- Me dokumentin hyrës në ARRSH me nr. 9131, datë 10.10.2019 "Njoftim për ngadalësimin e punimeve" si rezultat e vonesave në pagesa për situacionet 26 deri në 30 si dhe llogaritur pretendimet për pagesë për ditë vonesat (claim)
- Me dokumentin hyrës në ARRSH me nr. 9293, datë 15.10.2019 përsëritja e njoftimit për ngadalësim të punimeve.
Referuar auditimit janë krijuar kushtet e favorshme, të konsiderimit të penaliteteve (claim), aq më tepër që deri në këtë moment auditimi, nuk janë disponibël fondet në llogaritë e pagesave në euro në C. B dhe fondet në thesar për kosto lokale dhe TVSH për kontratat e lidhura për situacionet e papaguara. Referuar pretendimeve të kontraktorëve për claim e përllogaritura prej tyre, konstatohet një shumë e konsiderueshme që riskon në kosto shtesë të fondeve të projektit.
Referuar Klauzolës 6.1 të kontratës dhe klauzolës 6 të kushteve të veçanta të kontratës, parashikohet se kur midis kontraktorit dhe autoritetit kontraktor ka mosmarrëveshje për çështje të zbatimit të kontratës, të cilat nuk janë zgjidhur, atëherë çështja i drejtohet bordit apo një eksperti të pavarur ndërkombëtar, i cili merret me zgjidhjen e drejtë dhe të paanshme të konfliktit apo konflikteve të rezultuara gjatë zbatimit të kontratës. Ky ekspert (i zgjedhur sipas kushteve të veçanta të kontratës që pre valojnë nga kushtet e kontratës) pavarësisht

parashikimeve në kontratë nuk është i kontraktuar deri në momentin e këtij auditimi. (*Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 36-52 të Raportit të Auditimit*).

6.1Rekomandim: Nga Drejtori i Projektit (Drejtor i ARRSH) dhe Menaxheri i Projektit të merren masat e nevojshme organizative dhe mbikëqyrëse duke shmangur të gjitha hapësirat penguese në disponibilitetin e fondeve në mënyrë që procesi i pagesave të situacioneve të realizohet brenda afateve të përcaktuara në kontratë, në mënyrë që të eliminohet mundësia për kërkesë penaliteti (claim) nga kontraktorët për situacionet e punimeve në vijim.

Menjëherë

Rekomandimi është në proces.
ARRSH/PMT ka bërë të mundur që të shlyhen të gjitha detyrimet e akumuluara gjatë periudhës së referuar nga ana e KLSH-së. Gjithashtu, PMT ka marrë masa për ndjekjen e procedurave bazuar Manualit të Operimit të Projektit, për të patur fondet e nevojshme (në të tre komponentët) për të realizuar objektivat e projektit. Këtë rekomandim, PMT po e vë në zbatim në mënyrë periodike.

6.2 Rekomandim: Nga Drejtori i Projektit dhe Njësia e Projektit të parashikohet dhe miratohet në planin e prokurimeve, si dhe të realizohet kontraktimi i ekspertit të pavarur ndërkombëtar konform parashikimeve në udhëzuesit e BB dhe kërkesave të kushtin 6 të parashikuar në klauzolat e veçanta të kontratës, për shqyrtimin e konfliktit që ka pasur indicien nga moskryerja e pagesave në kohë nga Autoriteti Kontraktor për situacionet e paraqitur nga kontraktorët në zbatim të kontratave për vitet 2017,2018,2019 si për fondet e IBRD, ashtu dhe për fondet e Qeverisë Shqiptare.

Menjëherë

Rekomandimi është në proces.
Procedura për përzgjedhjen e ekspertit të pavarur ndërkombëtar është iniciuar me shkresën datë 18 Shkurt 2018 no. 1696 prot. Ashtu siç edhe është parashikuar në kontratë, ky ekspert nominohet nga ICC. Këta të fundit me shkresën datë 04 tetor 2019 kanë konfirmuar/nominuar Z. C. M., me të cilin kanë filluar negociatat për nënshkrimin e (i) marrëveshjes dhe (ii) rregulloren e procedurave. Disa vonesa kane ardhur edhe si rrjedhoje e situatave te krijuara (tërmeti & COVID 19). Pas negociatave me ekspertin e caktuara nga ICC – z.M, dokumentacioni i është dërguar kontraktorëve kontrata për firmë. z.M. mbetet i disponueshëm dhe do të fillojë të angazhohet menjëherë sapo dokumentacioni i nevojshëm të firmoset nga kontraktorët.

7. **Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i pagesave për fondet e kredisë si dhe rakordimet me shumat disponibël në llogari, rezultoi se gjendja e llogarisë në Euro me datën 15.07.2019 ka qenë në shumën 35,479.28 Euro.
Nga struktura e Buxhet Financës së ARRSH, për përgatitjen e pagesave referuar miratimit të situacionit nr. 27 dhe faturës nr. 102, datë 19.06.2019 të operatorit "S" SHPK dhe procedimit për pagesë në vijim, është paraqitur për likuidim në C. B (llog në Euro) shpenzimi me shumën 147,333.43 Euro. Ky shpenzim ka kaluar nga Banka i plotë pavarësisht se shuma gjendje e llogarisë nuk ishte e mjaftueshme për kalimin e gjithë vlerës së situacionit duke e kaluar kështu llogarinë në vlerën -111,856.15 Euro duke krijuar kushtet për mbajtjen e interesave shumat e kaluara mbi gjendjen e mjeteve monetare në llogari dhe krijimin e efektit financiar negativ për projektin. *(Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 36-52 të Raportit të Auditimit).*
7.1 Rekomandim: Nga Drejtori i ARRSH dhe Drejtoria e Buxhet Financës së ARRSH të komunikohet zyrtarisht me bankën C. B, për mos aplikim të interesave kundrejt shumave të likuiduara më shumë se gjendja në llogari për shkak të tyre.

Gjithashtu nga struktura e financës (Menaxheri Financiar dhe Nëpunësi Zbatues) të shmangen rastet e kalimit të shpenzimeve pa njohur më parë gjendjen e llogarisë përkatëse në Euro në çdo likuidim të tyre.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Rekomandimi është në proces.
B. C.nuk ka aplikuar komisione për këtë diference negative, dhe pas datës 20.11.2019 janë ndjekur sistematikisht të gjitha lëvizjet bankare ne llogarite e Bankës C.

8. **Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi ka rezultuar se regjistrimet në sistemin e kontabilitetit sipas programit të instaluar "A PMR" nga Menaxherja Financiare janë kryer jo në kohë reale, ku paraqiten raste të regjistrimit të pagesave edhe mbas 6 muajsh në kundërshtim me udhëzimin nr. 34, datë 24.12.2018 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2018" të Ministrit të Financave. Kjo ka bërë që nga ana e Menaxheres financiare të mos kryhen rakordimet mujore me bankën (pra në kohën e mbylljes së veprimeve brenda muajit).
-Gjithashtu nga auditimi ka rezultuar se për vitin 2018 nuk na u paraqitën pasqyra financiare të projektit si dhe shkresat përkatëse të dorëzimit të tyre në Ministritë Financave në kundërshtim me kapitullin I pikën nr. 4; kapitullin II pika 3,kapitullin III pika I të Udhëzimi nr. 14, datë 28.12.2006 dhe 26, datë 27.12.2007 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, vendore dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësive të zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj", ndryshuar me udhëzimin nr. 10, datë 27.02.2008 ku referuar kërkesave të formateve të miratuar pasqyrat financiare kërkojnë dhe pasqyrimin e vitit paraardhës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 36-52 të Raportit të Auditimit).*
8.1Rekomandim: Nga Menaxheri financiar i projektit të shmangen praktikat e hedhjes dhe regjistrimeve kontabël në mënyrë jo të njëpasnjëshme dhe jo në kohën reale të veprimeve dhe shpenzimeve nga llogaritë e pagesave me bankat e nivelit të dytë dhe degën e thesarit. Regjistrimet dhe rakordimet të realizohen konform rregullave dhe legjislacionit.

Menjëherë

Rekomandimi është në proces.
Hedhja në regjistër është bërë në mënyrë sistematike dhe po monitorohen lëvizjet ne banke te nivelit te dyte dhe ne thesar. Çdo fillim muaji është bere rakordimi me bankat e nivelit te dyte dhe me thesarin për lëvizjet buxhetore. Ky rekomandim ka të bëjë me procese pune dhe do të auditohet në auditimin e radhës së KLSH mbi projektin.

8.2 Rekomandim: Nga Menaxheri financiar i projektit të hartohen pasqyrat financiare të projektit për vitin 2018 të pa përgatitura si një domosdoshmëri për hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2019, ku referuar formateve të miratuar dhe kërkesave të udhëzimeve në fuqi kërkohet dhe plotësimi i vitit paraardhës.

Menjëherë

Rekomandimi është në proces.
Pasqyrat financiare të projektit për vitin 2018 dhe 2019, janë kryer dhe janë dorëzuar në Bankën Botërore. Në bazë të këtyre pasqyrave është kryer edhe disbursimi i fondeve të Huasë. Kjo pikë do të verifikohet në auditimin e radhës së KLSh, për projektin.

9. Gjetje nga auditimi: Me anë të Amendamentit Nr. 1 datë 16.03.2018 dhe Specifikimeve Teknike të Rishikuara të katërta kontratave të punëve civile ju është ndryshuar koncepti origjinal i kontratave të rrugëve Bazuar në Rezultate dhe Performancë në një koncept tjetër të përzier, ku punimet e reja kryesisht ato të rehabilitimit ekzekutohen nëpërmjet Urdhrave të Ndryshimit. Bazuar në konceptin original OPCR me rezultate dhe performancë, dokumentet e

tenderit dhe kushtet e kontratës, ofertuesi kishte në përgjegjësinë e tij të vlerësonte tipet dhe volumet e punimeve të nevojshme në varësi të kushteve dhe nevojës konkrete për punime specifike dhe të jepte ofertën e tij për volume të punës që do të kryente për te arritur nivelin e shërbimit të kërkuar të rrugës. Gjithashtu Kontraktoret sipas këtij koncepti janë vetë përgjegjës për projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe mbikëqyrjen e punimeve. Ata propozojnë një cmim "lump-sum" të fiksuar për të sjellë rrugën në një nivel të caktuar shërbimi dhe për ta mirëmbajtur atë në këtë nivel për një periudhe të caktuar relativisht të gjatë. Kontraktorët aktual nuk e kanë kryer këtë vlerësim në 2017, dhe një vit pas firmosjes së kontratës në një kohë kur punimet e rehabilitimit duhet të kishin përfunduar, ata s'kishin kryer asnjë punim. Një muaj pas përfundimit të afatit të punimeve rehabilituese ata paraqitën nevojën e shtimit të volumit të punëve dhe afateve mbi ofertën fillestare. Ky shtim është aplikuar nëpërmjet urdhrave të ndryshimit të parashtruara në Amendamentin Nr.1 dhe Specifikimet e Rishikuara. Urdhrat e Ndryshimit janë projektuar mbi bazën e çmimeve njësi me preventive për punime të llojeve të ndryshme, jo sipas konceptit OPRC, por pagesa për to kryhet mujore mbi bazën e një shume lump-sum proporcionale për seksionin e rrugës në të cilën punimet kanë përfunduar në muajin paraardhës gjithashtu dhe kontrolli/monitorimi i punimeve nga Konsulenti Monitorues mbeti i njëjtë në bazë performance pavarësisht se natyra dhe volumi i punëve ndryshoi. *(Me hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 87-123 të Raportit të Auditimit).*

9.1 Rekomandim: Nga ana e Drejtorit të ARRSH në cilësinë e Drejtorit të Projektit dhe instancave me të larta pjesë e këtij projekti, duke qenë se natyra dhe vëllimi i punëve kanë ndryshuar gjithashtu dhe koncepti OPRC i kontratave, të merren masa që dizajnët dhe punimet të kontrollohen dhe aprovohen nga një supervision dhe mbikëqyrje e mirëfilltë me të gjithë kompetencat ligjore të saj.

Menjëherë

Rekomandimi nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar.

Komenti i subjektit:

Audituesi nuk vë në dyshim nevojën për ndryshimin konceptual të bërë, ai shpreh mendimin e tij se marrëveshjet për Monitorimin dhe Mbikëqyrjen e katër kontratave OPRC gjithashtu duhet të ishin modifikuar për të lejuar një mbikëqyrje më intensive të Rehabilitimit, Përmirësimit dhe Punimet e urgjencës. Në veçanti, ai rekomandon që ARRSH të "marrë masa që projektet dhe punimet të kontrollohen dhe aprovohen nga një mbikëqyrje e duhur me të gjitha kompetencat e saj ligjore". Në fakt, kjo është ajo që ARRSH ka bërë tashmë përmes amendamenteve 6 dhe 7 të kontratës së Konsulentit Monitorues, i cili shton stafin e nevojshëm në ekipin e MC për të qenë në gjendje të kryejë një monitorim më të thelluar të punimeve. Përgjegjësia e Kontraktuesit sipas kontratës OPRC për të kryer testimin dhe raportimin e cilësisë ruhet, me Konsulentin Monitorues që ka për detyrë të verifikojë raportimin e Kontraktuesit përmes vizitave të shpeshta në terren. Detyra tjetër kryesore e Konsulentit Monitorues për verifikimin e Nivelit të Shërbimit (për Shërbimet e Mirëmbajtjes së Kontraktuesit) nuk është modifikuar. Në përgjithësi, ARRSH ka bërë të gjitha përpjekjet për të mbajtur sa më pak të jetë e mundur koston e përgjithshme të shërbimeve të Këshilltarit Monitorues. Kalimi në mbikëqyrje në shkallë të plotë të punimeve dhe dhënia e fuqisë dhe përgjegjësisë së plotë për vendimmarrje për MC nuk ishte e nevojshme dhe do të ngrinte koston e kontratës së MC-së shumë më tepër.

10. Gjetje nga auditimi: Në të katër kontratat e punimeve civile është amenduar neni 51 i kushteve të veçanta dhe pika C.2.1 të Specifikimeve teknike sipas Amendamenti nr 3 datë 16.10.2019. Neni 51 i Kushteve të Veçanta të kontratës ndryshohet duke shtuar tekstin e mëposhtëm: "*Mbajtja prej 10% do ti aplikohet edhe punimeve të Emergjencës të cilat janë të përhershme, si për shembull shtrime dhe struktura. Në raste të veçanta përshkruar në*

specifikime C.2.1 përqindja e mbajtjes mund të rritet deri në 20%."Pika C.2.1 e specifikimeve teknike sqaron se gjatë progresit të punimeve, inxhinieri duhet të kryhej teste mbi materialet dhe punimet për të siguruar përputhshmërinë me specifikimet e kërkuara. Normalisht sipas kushteve të kontratës nëse testet nuk kryhen ose nuk kanë rezultate të pranueshme, kontraktori nuk do të paguhet për ato punime ose do ti duhet ti ri kryhej ato sipas specifikimeve. Nëpërmjet ndryshimit të pikës 2 pra nenit 51, me amendamentin 3, kontraktorit i jepet mundësia që në keto raste (duke mos paraqitur asnjë lloj testi) ti rritet përqindja e mbajtjes së sigurisë deri ne 20%, kur në të vërtetë punimet që ai ka kryer mund të mos jenë konform specifikimeve teknike. Në këtë rast atij i mbahet një garanci maksimumi në 20% e cila në të ardhmen do ti rikthehet kur në fakt ai nuk duhej të paguhej fare për punimet e kryera jo konform specifikimeve. Kjo situate në amendamentin 3 preket edhe me ndryshimin e pikës K të specifikimeve teknike ku gjithë teksti nën pikën C.2.1 të specifikimeve fshihet dhe zëvendësohet si me poshtë:

Kontaktori duhet të kryhej testet të materialeve dhe punimeve të përshkruara në specifikime teknike……. Pamundësia e kontraktorit për të kryer testet e nevojshme, apo pamundësia për të dërguar rezultatet e testeve të kryera, apo dërgimi i rezultateve të cilat nuk përmbushin kërkesat apo nuk janë të plota, çojnë në pamundësinë e Menaxherit të projektit për të certifikuar pagesat për punimet e kryera. Megjithatë, në raste të veçanta Konsulenti Monitorues mund ti rekomandoje Menaxherit të Projektit pagesën e ndërmjetme të punimeve, pavarësisht serezultatet e testeve nuk janë konform me kërkesat dhe specifikimet, me kusht që kontraktori të pranoje (i) një zgjatje të periudhës së garancisë se defekteve për punimet përkatëse, me një zgjatje minimale prej 6 muajsh dhe deri në përfundimin e periudhës se kontratës, (ii) një rritje të përqindjes së mbajtjes së garancisë të nenin 51.

Këto ndryshime mundësojnë që të certifikohen e të paguhen punime të cilat mund të jenë jo-konform specifikimeve teknike, për të cilat nuk janë kryer teste ose nuk janë paraqitur rezultate, dhe maksimumi që mund ti mbahen kontraktorit për të tilla mos përputhshmëri është 20% e vlerës, mbajtje e cila në fund do ti rikthehet përsëri. Ky ndryshim heq instrumentet që garantojnë cilësinë e punimeve dhe favorizon kontraktorin në pagesat e tij.

(Me hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 87-123 të Raportit të Auditimit).

10.1 Rekomandim: Nga ana e Drejtorit të ARRSH në cilësinë e Drejtorit të Projektit dhe instancave me të larta pjesë e këtij projekti, të merren të gjitha masat dhe të ndiqen hapat administrative dhe ligjore për të anuluar ndryshimin e Nenit 51 i Kushteve të Veçanta dhe pikës C.2.1 të specifikimeve teknike nga Amendamenti nr. 3 duke ndjekur procedurat ligjore dhe në asnjë rast mos të paguhen punime, pa rezultatet e testeve apo me rezultate jo konform me kërkesat dhe specifikimet.

Menjëherë

Rekomandimi nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar.

Komenti i subjektit:

Duke ju referuar dokumentit "Aid Memoire" me nr. prot., 4857 dt. 20/05/2019 i Misionit të Bankës Botërore të Rishikimit Afatmesëm të Projektit tonë ku cilësohet se: "As described in previous Aide-Memoires and project reports, deficiencies during the preparation of the bidding documents for the OPRC contracts resulted in the need for major adjustments to those contracts. There have already been tëo contract amendments, ëhich resolved the more profound issues and made the contracts overall implementable. However, more changes are needed which, even though of a less profound nature, are nevertheless very necessary to regularize numerous practical day to-day implementation issues ëhich have arisen. They are also necessary to alloë better enforcement of compliance ëith some performance requirements (such as environmental and social safeguards) through effective financial disincentives (payment reductions) in cases of non-compliance ëith contractual requirements. At the time of

the Mid-Term Review mission, the drafting of the 3rd Amendment by the MC ëas completed, based on ëritten suggestions from ARA, the MC and Contractors. Similar to the process applied for the previous to amendments, a transparent procedure ëill again be used by ARA to finalize the 3rd Amendment (by mid-June 2019) ëhich ëill then be submitted to the Bank for no-objection" – "Siç përshkruhet në Aide-Memoires dhe raportet e mëparshme si dhe në raportet e projektit, mangësitë gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderimit për kontratat OPRC rezultuan në nevojën për rishikime të mëdha për ato kontrata. Tashmë janë bërë dy amendime të kontratave, të cilat zgjidhën çështjet më të thella dhe i bënë kontratat të zbatueshme. Sidoqoftë, nevojiten më shumë ndryshime të cilat, edhe pse me një natyrë më pak të thellë, janë shumë të nevojshme për të rregulluar çështje të shumta praktike që lidhen me implementimin e përditshme. Ato gjithashtu janë të domosdoshme për të lejuar zbatimin më të mirë me disa nga kërkesat e performancës (siç janë masat mbrojtëse mjedisore dhe sociale) përmes efekteve financiare (ulje pagese) në rastet e mosrespektimit të kërkesave kontraktuale. Në kohën e misionit të Rishikimit Afatmesëm, përfundoi hartimi i amendimit të 3-të nga MC, bazuar në sugjerimet me shkrim nga ARRSH, MC dhe Kontraktorët. Për hartimin është ndjekur procesi i aplikuar për dy amendimet e mëparshme, e njëjtë procedurë transparente do të ripërdoret nga ARRSH për të finalizuar Amendamentin e 3-të (nga mesi i qershorit 2019) i cili më pas do t'i paraqitet Bankës për No-Objection".

11. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të zbatimit të kontratave të punimeve civile u konstatua se katër kontraktorët aktual të punimeve civile kanë hyrë në tender me një përqindje të caktuar të secilit operator sipas marrëveshjes së bashkimit të operatoreve. Sipas Nenit 12.1 i kushteve të përgjithshme të kontratës origjinale "*Kontraktorit i lejohet specifikisht të nënkontraktojë pjesë të kontratës deri në një maksimum 80% të çmimit total të saj. Megjithatë, Kontraktori nuk është i lejuar të nënkontraktojë më shumë se 40% të shumës totale të kontratës tek një nën kontraktor i vetëm.* Me ndryshimin sipas Amendamentit Nr. 3 datë 16.10.2019 të nenit 12.1 të kushteve të veçanta të kontratës, *Kontraktori nuk është i lejuar të nënkontraktojë më shumë se 40% të shumës totale të kontratës tek një nën kontraktor i vetëm, **përveç se në rastet kur kontraktori është bashkim operatoresh dhe nën kontraktori është pjesëtar i bashkimit të operatorëve***." Me këtë ndryshim operatorit me përqindje më të vogël në bashkimin e operatoreve i jepet e drejtë të kryej punime mbi përqindjen e lejuar të nën kontraktimit dhe mbi përqindjen e lejuar sipas marrëveshjes se bashkimit të operatoreve duke ndryshuar kushtet e kontratës fillestare në favor të tij. *(Me hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 87-123 të Raportit të Auditimit).*

11.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të ARRSH në cilësinë e Drejtorit të Projektit dhe instancave me të larta pjesë e këtij projekti,të merren masat dhe të ndiqen hapat administrative dhe ligjore për të anuluar ndryshimin nenit 12.1 të kontratës nëpërmjet amendamentit nr. 3 duke ndjekur procedurat ligjore dhe operatoreve ti lejohet nën kontraktimi sipas dispozitave të kontratës fillestare.

Menjëherë

Rekomandimi nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar.
Komenti i subjektit:
Kontrata origjinale kufizon nën kontraktimin për secilin nënkontraktues në 40% të punimeve. Amendimi 3 hap mundësinë që Kontraktuesi kryesor (nëse është një sipërmarrje e përbashkët midis firmave) të nënkontraktojë deri në 80% të punimeve ndaj një nën kontraktori, që ky nën kontraktor është në të njëjtën kohë partner i kësaj Joint Venture. Audituesi e kritikoi këtë modifikim, duke pretenduar se krijon pabarazi të kushteve për ofertuesit e tjerë që morën pjesë në procesin e tenderimit. Ne nuk jemi dakord me vlerësimin e Audituesit, për arsyet e mëposhtme:

• Në një marrëveshje të Joint Venture, partnerët bien dakord për përqindjen në të cilën ata e detyrojnë veten të marrin pjesë në një sipërmarrje (tender, punime etj…). Ky është një detyrim vis-à-vis për punëdhënësit I cili mund t'i mbajë ata përgjegjës ndaj kësaj përqindje.
• Pavarësisht nga sa më sipër, partnerët e Joint Venture mund të bien dakord mes tyre, zyrtarisht ose jo formalisht, që një partner mund të bëjë më shumë punë sesa përqindja e përcaktuar në marrëveshjen e JV. Kjo në fakt është praktikë e zakonshme në të gjithë botën dhe Punëdhënësi nuk ka asnjë arsye të kundërshtojë për sa kohë që punimet kryhen si duhet.
• Në çështjen e përshkruar më lart, një nën kontraktim zyrtar midis kontraktuesit kryesor (JV) dhe anëtarit të JV nuk kërkohet aspak, dhe në fakt mjaft i pazakontë. Sidoqoftë, i mundëson partnerit JV (i cili gjithashtu bëhet nënkontraktues i JV) të përfshijë në Deklaratën e tij të Përvojës vëllimin e plotë të punimeve të ekzekutuara nga ai. Kjo është shumë e rëndësishme për partnerët shqiptarë të JV, sepse u mundëson atyre të marrin pjesë në proceset e tenderimit në të ardhmen për vepra më të mëdha, duke stimuluar në të njëjtën kohë përfshirjen e biznesit shqiptar në to.
• Ne nuk e shohim se në cilën mënyrë ky ndryshim i kontratës mund të ketë ndikuar ndoshta në shanset e ndonjë prej ofertuesve të tjerë (të pasuksesshëm) për të fituar këtë kontratë.

12. Gjetje nga auditimi: Amendamenti Nr 3. datë 16.10.2019 parashtron një nivel të ri shërbimi të reduktuar të rrugës i cili modifikon kërkesat e nivelit të shërbimit për seksione rrugore ku shtresa ekzistuese e rrugës nuk mund të mirëmbahet sepse punimet rehabilituese të përfshira në kontratë janë pezulluar ose anuluar nga autoriteti kontraktues. Ky nivel i ri është jashtë kushteve, specifikimeve teknike, dhe dokumenteve të tenderit dhe pranon një nivel shërbimi rruge shumë më të ulët nën normat e projektit, ndërkohë që kontraktori vazhdon të paguhet me të njëjtën vlerë mirëmbajtje për kilometër. Pranimi i një nivel shërbimi rruge shumë më të ulët nën normat e projektit, ul sigurinë e rrugëve të parashtruar nga projekti. *(Me hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 87-123 të Raportit të Auditimit).*

12.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të ARRSH në cilësinë e Drejtorit të Projektit dhe instancave me të larta pjesë e këtij projekti, të merren masa dhe të ndiqen hapat administrative dhe ligjore për të anuluar këtë pikë të Amendamentit nr.3. Në asnjë rast të mos pranohen nivele të reja shërbimi të reduktuara jashtë kërkesave të projektit dhe në raste të tilla kur punimet e rehabilitimit janë pezulluar apo anuluar nga autoriteti kontraktues të anulohet dhe mirëmbajtja e këtyre rrugëve nga projekti dhe ti lihet Autoritetit Rrugor Shqiptar mirëmbajtja e tyre.

Menjëherë

Rekomandimi nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar.
Komente i subjektit:
• Kontratat OPRC përfshijnë disa rrugë me trafik të ulët, por që jeta e shtresave asfaltike është tejkaluar dhe të cilat urgjentisht kanë nevojë për rehabilitim të tyre. Në disa vende, paketa asfaltike po shpërbëhet plotësisht. Si rrjedhim është e pamundur të mirëmbahen ato segmente të rrugës në nivelin e shërbimit të parashikuar në kontrata (p.sh. pa gropa, pa çarje, pa deformime, etj.)
• Në kontratat OPRC, këto rrugë u caktuan për rehabilitim në vitin e parë, përmes ri veshjes të thjeshta të shtresave të asfaltit (i cili rezultoi se ishte i papërshtatshëm dhe i pamjaftueshëm për sa i përket ndërhyrjes të nevojshme). Këto rrugë kanë nevojë për rehabilitim të plotë, por aktualisht nuk ka fonde në dispozicion brenda ose jashtë kontratave OPRC për të paguar atë.
• Për shkak të situatës së përshkruar më lart, e vetmja mundësi që ARrSh ka në dispozicion është të kërkojë nga kontraktorët që të mirëmbajnë rrugën e hapur dhe të shfrytëzueshme për automjetet, pa kërkuar nivelin e plotë të shërbimit normal, por përkundrazi një "Nivel të Shërbimit të Reduktuar të Fushëveprimit" i cili u përcaktua përmes këtij Amendimi.

• Për Kontraktoret, mbajtja e një rrugë të shtruar rishtazi, në nivelin e plotë të kërkuar të Shërbimit është sigurisht më e lirë se mbajtja e "Nivelit të Shërbimit të Reduktuar të Fushëveprimit" në një rrugë shumë të përkeqësuar dhe shpërbërëse. Në këtë rast, kontraktori nuk ka asnjë avantazh apo përfitim, përkundrazi përfituesit direkt janë përdoruesit e rrugës.
Për sa më lart, Autoriteti Rrugor Shqiptar, ka vendosur të mos zbatojë këtë rekomandim.

13. Gjetje nga auditimi: Me ndryshimin sipas amendamentit nr. 3 të datës 16.10.2019 kontraktorit i hiqet përgjegjësia që mbante për dëmtimin e aseteve rrugore. Me ndryshimet në Amendamentit nr.3 kontraktori do të paguhet nga ARRSH për heqjen e mjeteve ose faciliteteve/punimeve të instaluara në rrugë nga palë të treta të paautorizuara (veprim që konsiderohen dëmtim i aseteve rrugore sipas amendamentit nr. 3) por edhe për dëmtime të aseteve rrugore sipas paragrafit të shtuar në pikën B 3.6.4. Gjithashtu sipas këtij amendamenti ky ndryshim do të aplikohet edhe për rastet e ndodhura përpara 16 Marsit të 2018. Opinioni me rezervë i audituesit është se rreth kësaj date specifike kanë ndodhur dëmtime të aseteve rrugore me vlerë të konsiderueshme, për të cilën sipas amendamentit nr. 3 kontraktori do të favorizohet duke iu hequr përgjegjësia për dëmtimin. *(Me hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 87-123 të Raportit të Auditimit).*
13.1Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të ARRSH në cilësinë e Drejtorit të Projektit dhe instancave me të larta pjesë e këtij projekti,të merren masat dhe të ndiqen hapat administrative dhe ligjore për të anuluar Pikën F të amendamentit nr. 3 që bën ndryshimin e seksionit B 3.6.4 e specifikimeve teknike duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore.

Menjëherë

Rekomandimi nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar.
Komenti i subjektit:
Duke ju referuar dokumentit "Aid Memoire" me nr. prot., 4857 dt. 20/05/2019 i Misionit të Bankës Botërore të Rishikimit Afatmesëm të Projektit tonë ku cilësohet se: "As described in previous Aide-Memoires and project reports, deficiencies during the preparation of the bidding documents for the OPRC contracts resulted in the need for major adjustments to those contracts. There have already been tëo contract amendments, ëhich resolved the more profound issues and made the contracts overall implementable. Hoëever, more changes are needed ëhich, even though of a less profound nature, are nevertheless very necessary to regularize numerous practical day to-day implementation issues ëhich have arisen. They are also necessary to alloë better enforcement of compliance ëith some performance requirements (such as environmental and social safeguards) through effective financial disincentives (payment reductions) in cases of non-compliance ëith contractual requirements. At the time of the Mid-Term Revieë mission, the drafting of the 3rd Amendment by the MC ëas completed, based on ëritten suggestions from ARA, the MC and Contractors. Similar to the process applied for the previous tëo amendments, a transparent procedure ëill again be used by ARA to finalize the 3rd Amendment (by mid-June 2019) ëhich ëill then be submitted to the Bank for no-objection" – "Siç përshkruhet në Aide-Memoires dhe raportet e mëparshme si dhe në raportet e projektit, mangësitë gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderimit për kontratat OPRC rezultuan në nevojën për rishikime të mëdha për ato kontrata. Tashmë janë bërë dy amendime të kontratave, të cilat zgjidhën çështjet më të thella dhe i bënë kontratat të zbatueshme. Sidoqoftë, nevojiten më shumë ndryshime të cilat, edhe pse me një natyrë më pak të thellë, janë shumë të nevojshme për të rregulluar çështje të shumta praktike që lidhen me implementimin e përditshme. Ato gjithashtu janë të domosdoshme për të lejuar zbatimin më të mirë me disa nga kërkesat e performancës (siç janë masat mbrojtëse mjedisore dhe sociale) përmes efekteve financiare (ulje pagese) në rastet e mosrespektimit të kërkesave kontraktuale. Në kohën e misionit të Rishikimit Afatmesëm, përfundoi hartimi i amendimit të 3-të nga MC, bazuar në sugjerimet me shkrim nga ARRSH, MC dhe Kontraktorët. Për hartimin është

ndjekur procesi i aplikuar për dy amendimet e mëparshme, e njëjtë procedurë transparente do të ripërdoret nga ARRSH për të finalizuar Amendamentin e 3-të (nga mesi i qershorit 2019) i cili më pas do t'i paraqitet Bankës për No-Objection".

14. Gjetje nga auditimi: Nëpërmjet ndryshimeve të pikës G dhe H të specifikimeve të rishikuara me Amendamentin 3. hiqet detyrimi për kryerjen sipas afateve të përcaktuara të testeve të indeksit të ashpërsisë se asfaltit IRI dhe kriterit të fortësisë FËD që janë të rëndësishme për sigurinë rrugore sipas specifikimeve teknike. Matjet e IRI dhe FËD sipas specifikimeve fillestare duhet të kryheshin menjëherë pas përfundimit të çdo punimi shtrimi rehabilitimi apo mirëmbajtjeje rutine; përpara përfundimit të kontratës dhe bazuar në matjet FËD përpara përfundimit të kontratës, të llogaritet jetëgjatësia e mbetur e shtresës së rrugës
Me ndryshimet e Amendamentit nr. 3, raporti i Inventarit të Aseteve (përfshire IRI dhe FËD dhe llogaritjet e jetëgjatësisë së rrugës) do të dorëzohen të ARRSH çdo vit respektivisht në datat 30.12.2019, 30.12.2020 dhe 30.12.2021
Ndryshimi i afateve me Amendamentin Nr. 3 lidhet me heqjen e detyrimit për kryerjen e këtyre testeve që janë të rëndësishme për sigurinë rrugore pas përfundimit të punimeve.
Gjithashtu specifikohet se: Për llogaritjen prapavepruese të reduktimeve të pagesave për vonesa të ndodhura përpara Amendamentit nr. 3, vetëm vonesat pas fazës së rehabilitimit të përcaktuar në kushtet e veçanta 39.1 prej 25 muajsh pas firmosjes së kontratës, do të konsiderohen.
Aktualisht nuk janë mbajtur penalitete të tipit MPM 4 për mos dërgim të raportit të inventarit të aseteve sipas afateve, as penalitete MPM9 apo MPM10 për testet IRI dhe FËD. Edhe pse një pjese e madhe e punimeve të rehabilititmit kanë përfunduar, për to nuk janë kryer testet IRI dhe FËD dhe nuk janë dorëzuar rezultat dhe as raportet e inventarit të aseteve. Me anë të këtij amendamenti penalitetet e ardhshme MPM 4 për vonesa ne dorëzimin e Raportit të inventarit te aseteve zerohet pra fshihen fare bashke me penalitetet e mundshme që duhet të ishin mbajtur për këto vonesa deri ne periudhën e mbarimit te punimeve te rehabilitimit, gjithashtu dhe penalitetet e mundshme MPM 9 dhe MPM10 hiqen duke qene se ndryshohen afatet e dorëzimit te testeve IRI dhe FËD nga përfundimi i punimeve te rehabilititmit në një date fikse si 31.12.2019.
Grupit të auditmit nuk i janë vënë në dispozicion vlerat e këtyre penaliteteve përpara amendamentit nr. 3 sepse ato nuk janë përllogaritur në asnjë situacion të miratuar pavarësisht se testet nuk janë kryer e raportet nuk janë dorëzuar sipas parashikimeve në kontratë. Këto ndryshime heqin instrumentet për garancinë e cilësisë së punimeve dhe performancës. *(Me hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 87-123 të Raportit të Auditimit).*
14.1 Rekomandimi: Ekipi i menaxhimit të projektit dhe Konsulenti Monitorues të llogarisin këto penalitete sipas dispozitave të kontratës fillestare. Nga ana e Drejtorit të ARRSH në cilësinë e Drejtorit të Projektit dhe instancave me të larta pjesë e këtij projekti, të merren masa qe afatet e kryerjes dhe dorëzimit të rezultateve të testeve të ashpërsisë së rrugëve dhe fortësisë së tyre të rikthehen sipas kontratës dhe specifikimeve fillestare duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për këtë rikthim.

Menjëherë

Rekomandimi nuk është zbatuar.
Qëndrimi i subjektit të audituar:
Sipas kontratës fillestare, matjet e IRI dhe FVVD kërkohej të kryheshin "menjëherë" pas përfundimit të punimeve rehabilituese. Kërkesa e këtyre testeve në disa pika të specifikimeve teknike e bënte të paqartë situatën dhe kontradiktore. Me Amendamentin Nr. 3, rezultatet e testit IRI dhe FVVD është kërkuar të dorëzohen si pjesë e "Raportit të Përfundimit Substancial" dhe seksioni B 4.6.7 i Specifikimeve fshihet për të shmangur në këtë mënyrë përsëritjen ose kërkesat që sillnin konflikt në këtë pikë. Gjithashtu në pikën H të Amendimit

Nr. 3 është mirë përcaktuar dhe detajuar pjesa teknike e "Back Calculation" e FVVD me anë të së cilës llogaritet jetëgjatësia e paketës rrugore.

15. Gjetje nga auditimi: Sipas pikës U të Amendamentit 3 Kontraktori i kontratës C duhet të sigurojë ambient për zyra për përdorimin e stafit të ekipit të menaxhimit të projektit të ARRSH dhe njësisë RAMS të ARRSH nëpërmjet fondeve të projektit. Zyrat do t'i sigurohen dhe dorëzohen ekipit të menaxhimit të projektit brenda 14 ditëve nga dorëzimi i një kërkese të shkruar nga ARRSH dhe do të jete e disponueshme për përdorim nga personeli i njësisë së Menaxhimit të Projektit të ARRSH për një periudhë që mund të shtyhet deri me 31.12.2021. Në periudhën e auditimit është konstatuar se ekipi i menaxhimit të projektit është i akomoduar në zyra jashtë ARRSH, të cilat përmbushin kërkesat e sipërpërmendura prej muajsh, por qiraja për to nuk është paguar deri tani as nga njësia dhe as nga ARRSH. Kjo pikë e amendamentit është jashtë objektivave të kontratës të punimeve civile dhe jashtë përcaktimeve për mbulimin e shpenzimeve të kostove operative si dhe me devijim të procedurave ligjore të marrjes së ambienteve me qira që bazohen në parimet e transparencës referuar nenit 7 germa "a" e ligjit 9643 datë 20.11.206 "Për prokurimin publik" i ndryshuar. Detyrimi për sigurimin e ambienteve të punës për njësinë e projektit është i ARRSH. *(Me hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 87-123 të Raportit të Auditimit).*

15.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të ARRSH në cilësinë e Drejtorit të Projektit dhe instancave me të larta pjesë e këtij projekti, të merren masa dhe të ndiqen hapat administrative dhe ligjore që kjo pikë e amendamentit të anulohet si shpenzim jashtë objektivave të projektit dhe me devijim të procedurave ligjore të marrjes së ambienteve me qira, sigurimi i ambienteve për stafin është detyrim i ARRSH.

Menjëherë

Rekomandimi është në proces.

Stafi i Njësisë së Menaxhimit të Projektit është akomoduar në ambientet e ARRSH.

16. Gjetje nga auditimi: Të katër kontraktorët e punimeve civile nuk i kanë përmbushur detyrimet e tyre kontraktuale në lidhje me sigurimin e cilësisë dhe mënyrës së raportimit. Kontraktorët nuk kanë dërguar të gjitha raportet e dizajnit/projektimit/testimit/inventarët/ të përfundimit të punimeve etj., sipas afateve të përcaktuara në specifikimet teknike. Referuar nenin 25.2 dhe 25.3 të kontratës kontraktori brenda strukturës së tij organizative duhet të krijonte një njësi vetëkontrolli, detyra e të cilës është të verifikoje në mënyrë të vazhdueshme përputhshmërinë e kontraktorit me nivelin e kërkuar të shërbimit dhe gjenerimin e dokumentacionit të nevojshëm të përcaktuar në specifikimet teknike. Nga auditimi rezulton se tek të katër kontraktorët kjo njësi nuk funksionon konform kërkesave duke sjellë vonesa ose pamundësi të kontraktoreve për të gjeneruar dhe dërguar në afat raporte të ndryshme detyrime të tij referuar specifikimeve teknike. *(Me hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 87-123 të Raportit të Auditimit).*

16.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të ARRSH në cilësinë e Drejtorit të Projektit të marren masa që Kontraktorët e kontratave të punëve civile A, B, C dhe D të plotësojnë detyrimet e tyre kontraktuale në lidhje me njësinë e vetëkontrollit duke ristrukturuar dhe rritur kapacitetet e njësisë se tyre të vetëkontrollit për të përmbushur në afat dhe me cilësi detyrimet kontraktuale mbi raportimet dhe sigurimin e performancës.

Menjëherë

Rekomandimi është në proces.

Kontraktorit i janë rikujtuar detyrimet te cilat burojnë nga kontrata e nënshkruar. Kontrata gjithashtu parashikon edhe penalitete ne rastet kur evidentohen mangësi ne performancën e njësisë se vetëkontrollit te cilat janë aplikuar rregullisht ne pagesat mujore ne forme (OPM-

11). Gjithashtu kontraktorëve iu është nisur një shkrese Mbi marrjen e masave për funksionalitetin e Njësisë se Vetkontrollit me Nr. 3668 prot., date 27.05.2020.

17. Gjetje nga auditimi: Implementimi i Urdhrave të ndryshimit sipas Amendamentit Nr.1 për të katër kontratat ka shtuar volume e punëve dhe rrjedhimisht ka rritur vlerën e kontratave. Kjo rritje në të katërt rastet është shume afër vlerës 15%. Projektit i kanë mbetur ende 2 vjet e 2 muaj kohë për përfundimin. Referuar Udhëzimeve te Bankës Botërore Aneksi 1. Pika 3. Modifikime të kontratës së lidhur, si dhe nënpika (c), nenin 63.3.5 te kushteve të përgjithshme të kontratës në rastet e kontratave nëpërmjet Urdhër Ndryshimi apo Amendament, të cilat në mënyrë individuale apo të gjithë bashkë, rrisin vlerën fillestare të kontratës me më shume së 15%, Huamarrësi duhet të kërkoje aprovimin e bankës (no objection). Nëse Banka përcakton se propozimi është i papajtueshëm me dispozitat e Marrëveshjes dhe/ose Planin e Prokurimit, ajo do të informojë menjëherë Huamarrësin dhe të specifikoje arsyet e vendimeve të saj. Gjithashtu ne rastet kur nëpërmjet Urdhrave te ndryshimin çmimi i kontratës ndryshohet me 15% (në rastin konkret ngrihet mund mbi 15 %) kontraktori ka të drejtë të dërgojë një njoftim me shkrim për kundërshtime dhe në këtë mënyrë mund të kërkojë të negociojë çmime. *(Me hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 87-123 të Raportit të Auditimit).*

17.1 Rekomandimi: Njësia e menaxhimit te projektit të marrë masa që për shumat e disponueshme por të papërdorura nga Huaja për komponentin e punimeve civile, ne rast se merret aprovim i bankës për përdorim dhe nëse Kontraktorët kërkojnë negocim duke propozuar çmime me te larta se ato te ofertës aktuale, njësia te analizoje këto çmime dhe ne asnjë rast të mos pranojë oferta ku çmimet e negociuara të mos jenë të argumentuara me analiza reale.

Në vijim

Rekomandimi është në proces.

Negocimi do të fillojë pasi të jetë konfirmuar nga Ministria e Financës përdorimi i fondeve te kursyera te cilat do te rrisnin vlerën e kontratave te punimeve mbi 15%. Aktualisht ndonëse ka në parim një dakordësim nga ana e Bankës, kjo e fundit ka kërkuar edhe konfirmimin e Ministres se Financës. MF deri në këto momente nuk ka konfirmuar përdorimin e këtyre fondeve.

18. Gjetje nga auditimi: Për të katër kontraktorët e kontratave të punëve civile A, B, C dhe D gjatë verifikimeve në terren rezultuan tabela rrugore dhe sinjalistika të pavendosura sipas projektit. Konkretisht për kontratën A gjatë verifikimit të punimeve të Urdhrit të Ndryshimit Nr. A03 për seksionin rrugor K/Bushat (Melgushë K/rr.1) - Mjedë degëzimi Shkodër) u konstatuan 5 tabela rrugore të pavendosura, për punimet e Urdhrit të Ndryshimit Nr. A 04 për seksionin rrugor Ura e Kirit-Guri i Zi, Guri i Zi-Ura Spatharë, gjatë verifikimit të punimeve rezultuan 11 tabela rrugore të pavendosura, vijëzime të fshira, për urdhrin e punimeve të emergjencës A-06 për seksionin Fillimi i Knadhës majtas degëzimi rruga Shëngjin –Kune gjatë auditimit janë konstatuar disa dëmtime të rrjetave në zonën periferike të barrierave ku rrjetat janë shkëputur nga strukturat mbajtëse anësore duke mos e kryer në këtë mënyrë të plotë funksionin e tyre mbrojtës.

Për kontratën B u shqyrtua Urdhër Ndryshimit Nr. B03 për aksin rrugor Vorë-Kthesa e Rinasit-Fushë Krujë dhe gjatë verifikimit në terren të punimeve të kryera u konstatua mos vendosja e 2-3 tabelave sipas projektit.

Për kontratën C u verifikua urdhri i Punimeve te Përmirësimi të tipit Kryqëzime të Thjeshtë Gështenjas dhe u konstatua mungesa e 2 tabelave standarde rrethore dhe mungese e vijëzimit specifik në sasinë 25 m^2. Gjithashtu dhe për Urdhrin e Punimeve te Përmirësimi të tipit Kryqëzime të Thjeshtë Buçimas u konstatua mungesa e 3 tabelave standarde rrethore dhe mungese e vijëzimit specifik në sasinë 25 m2.

Për kontratën C në punimet e Urdhër i Ndryshimit Nr. D05 Fier Levan u konstatuan 3 tabela të pavendosura. Punimet në akset e verifikuar kane përfunduar, por inspektimi final nga Konsulenti Monitorues nuk është kryer ende si rrjedhojë as pagesa e tyre nuk është kryer në masën 100 % por mos vendosja tabelave dhe sinjalistikës në kohe ulin performancën e sigurisë rrugore. *(Me hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 87-123 të Raportit të Auditimit).*

18.1 Rekomandimi: Të merren masa e menjëhershme nga ana e Drejtorit të ARRSH në cilësinë e Drejtorit të Projektit që kontraktorët e kontratave civile A, B, C dhe D të vendosin tabelat dhe sinjalistikën sipas projektit në akset e konstatuara dhe cilësuara me sipër referuar detyrimeve të punimeve te rehabilitimit e përmirësimit por edhe mirëmbajtjes. Vendosja të jetë e plotë dhe pa mangësi sepse ato ndikojnë direkt në sigurinë rrugore.

Menjëherë

Rekomandimi është në proces.
Është komunikuar me Kontraktorët dhe Konsulentin e Monitorimit, që të vendosen të gjitha tabelat dhe sinjalistika, dhe të raportohet pranë ARRSH, në mënyrë që të mos cënohet siguria rrugore në asnjë moment. Bazuar në shkresën e ARRSH nr. 4128 prot., datë 11.06.2020 "State Audit Report ad Recommendation".

19. Gjetje nga auditimi: Gjatë verifikimit në terren të punimeve të kontratës D për Urdhrin e Ndryshimit D14 në segmentin rrugor Shkozet-Mbikalimi Plepa u konstatua se pothuajse gjysma e ndriçimit në gjatësi rrugore është jashtë funksionit. Kontraktori ka paraqitur situacionin për pagesën e plotë për punimet e kryera në masën 100%, por aktualisht ai ende nuk është paguar. Projekti është në bazë rezultatesh kështu që edhe pse kontraktori mund të pretendoje kryerjen 100% të punimeve dhe të fajësoje cilësinë e materialeve të ndërtimit për ketë defekt, deri në momentin e funksionimit të plotë të ndriçimit ai nuk i ka përmbushur detyrimet e tij të performancës rrugore
Gjithashtu u konstatua një numër i lartë përvijuesish anësor normal (delineatorësh) të thyer nga palë të treta në krahun e majtë të aksit rrugor Fier Levan i përfshirë në urdhrin e ndryshimit D05. Nga ana e kontraktorit të punëve civile të kontratës D nuk është marrë asnjë masë për zëvendësimin e aseteve rrugore të dëmtuara duke ulur sigurinë rrugore. *(Me hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 87-123 të Raportit të Auditimit).*
19.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të ARRSH në cilësinë e Drejtorit të Projektit të marren masa që kontraktori i kontratës së punëve civile C të realizojë ndriçimin e aksit rrugor Shkozet-Mbikalimi Plepa, gjithashtu Drejtori i Projektit dhe Konsulenti Monitorues mos të miratojnë pagesa për këto punime deri në realizimin e ndriçimit sipas kushteve të projektit.
Nga ana e njësisë menaxhuese të projektit të monitorohet procesi dhe marrja e masave për realizimin e detyrimit të kontraktorit të kontratës D referuar kushteve të kontratës për zëvendësimin menjëherë të aseteve rrugore të dëmtuara.

Menjëherë dhe në vijim

Rekomandimi është në proces.
Bazuar në shkresën nr. 4764 datë 01.07.2020 që në cilësinë e titullarit dhe në përgjegjësinë e institucionit z. E. V. konfirmon se për çdo aset rrugor të konstatuar si të dëmtuar Kontraktorit i janë aplikuar penalitete bazuar në Kushtet e Kontratës dhe Specifikimet Teknike deri në zëvendësimin e tyre. Ky rekomandim do te verifikohet më saktësisht në auditimin e radhës për projektin.

20. Gjetje nga auditimi: Sipas termave të referencës së kontratës së konsulentit dhe në termat e rishikuara konsulenti duhet të përmbushë kërkesat të raportimit për secilën nga 4 kontratat e punimeve civile. Gjatë auditimit u identifikua që Konsulenti Monitorues nuk i ka dorëzuar të gjitha raportet në ARRSH në tre kopje fizike (dy në gjuhën angleze dhe një në shqip), dhe një

kopje elektronike në CD edhe pse mund ti ketë përgatitur ato. *(Me hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 87-123 të Raportit të Auditimit).*

20.1 Rekomandimi:Nga ana e Drejtorit të ARRSH në cilësinë e Drejtorit të Projektit të marren masa që ti kërkohet Konsulentit Monitorues të dorëzoje të gjitha raportet që ka si detyrim referuar kontratës dhe të përmbushe kërkesat e raportimit për secilën nga 4 kontratat e punimeve civile.

Në vijim

Rekomandimi është në proces.

Konsulentit Monitorues i është rikujtuar procedura lidhur me dorëzimin e raporteve e cila duhet te jete ne përputhje te plote me detyrime e parashikuar ne kontratën e nënshkruar.

21. Gjetje nga auditimi: Në dy procedurat e prokurimit të zhvilluara me objekt konsulent individual ekspert mjedisor dhe konsulent individual ekspert social "Individual Consultant (Environmental Expert dhe Social Expert)', u konstatua se këto procedura janë zhvilluar në kundërshtim me Ligjin nr. 71/2015, datë 02.07.2015 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin "Mirëmbajtje dhe Siguri rrugore bazuar në rezultate", konkretisht me pikën 2 "Huaja", pikën 3 "Projekti" të kushteve të përgjithshme dhe me objektivat e projektit përshkruar hollësisht në pjesën e parë dhe pjesën e dytë të marrëveshjes Udhëzuesin e Bankës Botërore për përzgjedhjen dhe punësimin e konsulentëve nën huat e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe grandet dhe kreditë e Bashkimit Ndërkombëtar për Zhvillim për Huamarrësit e Bankës Botërore të janarit 2011, i rishikuar në korrik 2014. Në bazë të termave të referencës dhe kontratave të tyre këta konsulent duhet të siguronin raporte në lidhje me objektin e kontratës e cila është e përpiluar referuar objektivave dhe komponentëve të projektit të transportit dhe tregtisë në Ballkanin perëndimore, i cili nuk gjen zbatim në asnjë pikë të projektit përmirësimi i sigurisë rrugore bazuar në performancë. Referuar korrespondencës me bankën, termat e referencës janë përgatitur nga Donatori dhe fondet për të financuar këta konsulentë janë hequr nga nën komponenti "Kosto Operative" të cilat referuar marrëveshjes janë shpenzime të arsyeshme që lidhen me realizimin e veprimtarive të projektit. Miratimi për të financuar me fondet e projektit dy konsulentë të cilët janë kontraktuar për dy kontratat e sipërpërmendura është jashtë objektivave të marrëveshjes, gjithashtu nuk ka pasur minimalisht një miratim nga Ministria e Financave si huamarrës pasi ndryshimet në bazë të Ligjit 71/2015 bëhen me miratimet të palëve, konkretisht pala shqiptare dhe Banka Botërore. Përpos kësaj, nuk ka pasur një garë të hapur në lidhje me përzgjedhjen e këtyre konsulentëve, nuk është bërë shpallje për procedurën, nuk ka një raport vlerësimi nga (EC) dhe nuk evidentohet fakti pse është ngritur komisioni i vlerësimit duke mos pasur garë. Nga korrespodencat me bankën këta konsulent janë ftuar për të marr pjesë në këtë procedurë, gjithashtu edhe gjatë fazës së lidhjes së kontratës nuk ka pasur procedurë për negocimin e çmimit të kontratës. Duke qenë se kontratat janë lidhur dhe ka mbaruar realizimi i tyre, ekspertët e kontraktuar janë paguar në shumën totale 7,750.00 Euro (3,500,00 Euro eksperti mjedisor + 4,250.00 Euro eksperti social) vlerë e cila përbën shpenzime jo në përputhje me 3E për buxhetin e projektit si shpenzim i kryer jashtë objektivave të projektit. *(Trajtuar me hollësisht në pikën D, faqe 52-87 të Raportit të Auditimit).*

21.1Rekomandim*:* Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH -së në cilësinë e Drejtorit të Projektit të marrë masa për t`i kushtuar vëmendjen e duhur institucionale procesit të zhvillimit të procedurave të prokurimit që zhvillohen në kuadër të këtij projekti apo projekteve të ngjashme në të ardhmen, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të zhvillojë procedura prokurimi të cilat janë për plotësimin e nevojave të projektit dhe brenda objektivave të tij.

Vazhdimisht

Rekomandimi është në proces.
Ky rekomandim ka të bëje me procese pune dhe do të auditohet në vazhdimësi nga KLSH por nga PMU konfirmohet se do të mbahet në konsideratë dhe do të zbatohet në procedurat në vijim.

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të prokurimit për "Konsulentë për procedurat e prokurimit", "Konsulentë financiar", "Projekt Menaxher", u konstatuan mangësi në lidhje me:
-Gjurmë mbi hartimin e Termave të Referencës për procedurën dhe miratimi I BB për këto terma para kryerjes së procedurës;
-Ofertuesit nuk kanë sjell dokumentacion që vërteton faktet e përmendura në CV ç'ka e bënë të pamundur gjykimin në lidhje me plotësimin e kritereve të vendosura tek termat e referencës;
-Mënyra e vlerësimit dhe s'kualifikimit për konsulentët të cilët kanë shprehur interes dhe që më pas nuk janë short listuar nuk është pasqyruar në raportin e vlerësimit të përpiluar nga EC duke mos e bërë transparent këtë proces dhe duke mos garantuar efektivitetin e fondeve të shpenzuara të projektit.
Mangësi të cilat janë në kundërshtim me Udhëzuesi i Bankës Botërore për përzgjedhjen dhe punësimin e konsulentëve nën huat e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe grandet dhe kreditë e Bashkimit Ndërkombëtar për Zhvillim për Huamarrësit e Bankës Botërore, i janarit 2011, rishikuar në korrik 2014; Manuali Operacional të Projektit. *(Më hollësisht trajtuar me hollësisht në pikën D, faqe 52-87 të Raportit të Auditimit).*
22.1Rekomandim: Njësia e Menaxhimit të Projektit, të kërkojë nga Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të ngritura për qëllimet e projektit, që në procedurat e prokurimit për konsulentë, para zhvillimit të procedurës, të marr miratimet e bankës për termat e referencës që do të përdoren.
-Gjatë përpilimit të raportit të vlerësimit të pasqyrohen arsyet e s' kualifikimit të gjithë specialistëve që kanë shprehur interes për procedurën dhe të kërkojë, dokumentojë në dosjet individuale të specialistëve të përzgjedhur dokumentacionin justifikues të kualifikimeve të paraqitura në CV e tyre, me qëllim realizimin e një procesi sa më transparent, të pakontestueshëm dhe tërësisht të kontrollueshëm.

Vazhdimisht

Rekomandimi është në proces.
Referuar shkresës nr. 4764 datë 01.07.2020 që në cilësinë e titullarit dhe në përgjegjësinë e institucionit z. E. V. konfirmon se procedura e përzgjedhjes së konsulentëve është hartuar dhe protokolluar si në ARRSH, ashtu edhe me Bankën Botërore është mbajtur korrespondencë. Për çdo procedurë është bërë publikim i njoftimit publik. Gjithashtu, në dosjet e konsulentëve janë depozituar dokumentet dhe janë dërguar nga PMT, pranë Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme të ARRSH me shkresën nr. 433/2 prot., datë 25.02.2020 "Dërgohet dokumentacioni i personelit të Njësisë së Menaxhimit të Projektit RRMSP". Ky rekomandim ka të bëjë me procese pune dhe do të verifikohet në auditimin e ardhshëm për projektin.

23. Gjetje nga auditimi: Bazuar në marrëveshjen e financimit dhe në Manualin Operacional të projektit pika 146, duhet të kontraktohet një asistent teknik ndërkombëtar për prokurime/menaxhim kontrate për ti asistuar njësisë së menaxhimit të projektit dhe komitetit të vlerësimit për kontratat e mëdha të punimeve civile dhe shërbimeve komplekse të konsulentit për të gjithë periudhën e implementimit të këtyre kontratave. Në datë 13.11.2017 është lidhur kontrata nr. CS 11-13 me numër protokolli 9102/1 për shërbim konsulence teknike me objekt "Eksperti Ndërkombëtar" nënshkruar midis ish Drejtorit të Përgjithshëm të

ARRSH z. A. Q. dhe konsulentit ndërkombëtar L. E., me vlerë 587,671.20 Euro me tvsh dhe me afat nga 20.11.2017 deri në 20.11.2020. Me shkresën nr. 6116 prot., datë 10.07.2018 të ish-Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. Q i janë ndërprerë marrëdhëniet kontraktuale konsulentit individual z. L.E. Në bazë të kësaj shkrese ish drejtori i ARRSH shpreh pakënaqësitë e tij lidhur me shërbimin e ofruar nga ky konsulent në bazë të kontributeve me vlera të limituara në dhënien e zgjidhjeve konkrete dhe konstruktive për çështje dhe probleme me të cilat duhet të përballeshin në përditshmërinë e punës së tyre. Për sa më lart nuk na u vu në dispozicion asnjë evidencë ku të evidentohen faktet e performancës jo të mirë të shprehura në letrën e ndërprerjes së kontratës, të cilat kanë ndikuar në vendimin e ish-drejtorit të përgjithshëm të ARRSH. Nuk na u paraqit asnjë komunikim zyrtar me këtë konsulent ku t'i jetë shprehur shqetësimi dhe të jetë paralajmëruar për ndërprerjen e kontratës në rast se nuk do ta përmbushte atë sipas kërkesave të saj dhe nuk ka asnjë komunikim me Bankën Botërore ku t'i jetë shprehur shqetësimi në lidhje me z. E. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga ana e ARRSH ky konsulent është paguar për shërbimin e tij sipas situacioneve të firmosura nga ish Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH, ndërsa faturat dhe time sheet të ditëve të punës së tij janë të konfirmuara nga projekt menaxherët z. E. N. dhe K. S. sipas periudhave përkatëse. Si rezultat i kësaj ndërprerje ky konsulent ka dërguar pranë ARRSH shkresën me nr. 9985 datë 31.10.2019 "*Claims for breach of contract*" me anë të së cilës parashtron kërkesat e tij si dhe e paralajmëron ARRSH se në rast se nuk do të konfirmojë detyrimet e saj si pasojë e ndërprerjes së kontratës do të filloj procedurat e arbitrazhit pa njoftim tjetër. Për zgjidhje kontrate ky konsulent ka kërkuar shpërblim për shumën totale të kontratës, plus interesa dhe kosto. Nga momenti i ndërprerjes së kontratës me konsulentin individual e deri në momentin e auditimit nuk është lidhur kontratë tjetër dhe nuk është e mbuluar me konsulencë e gjithë periudha nga korriku 2018 deri në nëntor 2019, periudhë gjatë të cilave janë bërë amendimet e kontratave të punimeve civile të cilat kanë qenë shumë të rëndësishme për ecurinë e projektit. Nevoja për një konsulent individual ndërkombëtar dhe me eksperiencë është parashikuar që në marrëveshjen e financimit dhe në Manualin Operacional, funksionet e këtij konsulenti konsiderohen si një garanci për kontratën pasi detyrë kryesore e tij ka qenë sigurimi i niveleve të shërbimit të përcaktuara në kontratat e punimeve. Gjithashtu edhe në planin e prokurimit të miratuar nga banka është parashikuar një konsulent i tillë i cili duhet të ishte dhe të mbulonte të gjitha faza e zhvillimit të projektit. Në ARRSH nuk është shpallur asnjë procedurë tjetër për përzgjedhjen e një konsulenti të ri duke e lënë të pa zëvendësuar dhe të pa mbuluar me konsulencë periudhën. Ndërprerja e papritur e kontratës me konsulentin individual ndërkombëtare dhe mos shpallja e procedurës për kontraktimin e një konsulenti tjetër është në kundërshtim me Manuali Operacional të Projektit neni 146, paragrafi i fundit dhe ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë e vendimmarrjes teknike gjatë zbatimit të projektit. *(Me hollësisht trajtuar në pikën D, faqe 52-87 të Raportit të Auditimit).*

23.1 Rekomandim: Njësia e menaxhimit të projektit të fillojë procedurat e duhura administrative dhe ligjore për të mbuluar me ekspertizën e nevojshme për konsulencë teknike periudhën e mbetur të zhvillimit të projektit me një konsulent individual ndërkombëtarë me eksperiencë dhe pa konflikt interesi për projektin, me qëllim dhënien e një garancie për mbarëvajtjen e tij.

Menjëherë

Rekomandimi është në proces.

Përzgjedhja e konsulentit është përfshirë në planin e prokurimit që me konstatimin në projekt raporti, dhe në bashkëpunim më Bankën Botërore, është marrë miratimi i Planit të Prokurimit. Procedura e prokurimin (publikimi për shprehje interesi) pritet te iniciohet ne ditët ne vazhdim.

23.2 Rekomandim: Komiteti Drejtues Teknik i projektit, ARRSH nëpërmjet strukturave të saj dhe Njësia e Menaxhimit të Projektit, të analizojnë kushtet e ndërprerjes së kontratës me konsulentin individual L. E. dhe produktet e parashikuara prej saj, dhe të ndjekin me rigorozitet të gjitha hallkat administrative dhe ligjore (duke parë dhe mundësinë e negocimit) duke shmangur arbitrazhin, me qëllim shmangien e shpenzimeve në dëm të projektit në të ardhmen, si pasojë e dëmshpërblimit në shuma të konsiderueshme të kërkuar nga ky konsulent për ndërprerjen e kësaj kontrate.

Menjëherë

Rekomandimi është në proces.
Ka një komunikim edhe me Drejtorinë Juridike të ARRSH për rastin e konsulentit L. E.. Ref: Shkresa e PMT, drejtuar DJPS nr. 2470.1 prot., datë 02.04.2020 "Kthim përgjigje shkresës nr. 2470 date 31.03.2020".

24. Gjetje nga auditimi: Për të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara për këtë projekt, dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar dhe arkivuar në kundërshtim me Neni 3 e 29 të "Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat". *(Me hollësisht trajtuar në pikën D, faqe 52-87 të Raportit të Auditimit).*
-Gjithashtu u konstatua se në disa raste mungonin dokumente justifikues lidhur me marrjet dhe largimet nga puna të Projektit. Ky veprim bie në kundërshtime ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat". *(Më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 24-36 të Raportit të Auditimit).(Me hollësisht trajtuar në pikën D, faqe 52-87 të Raportit të Auditimit).*
24.1 Rekomandim: Nga Njësia e Menaxhimit të Projektit, në bashkëpunim me ARRSH, të merren masat për protokollimin dhe arkivimin e të gjitha dosjeve të procedurave të prokurimit të zhvilluara për këtë Projekt në zbatim të Normave Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë
24.2 Rekomandim: Nga Grupi i Menaxhimit të Projektit të merren masa që çdo dokument që lidhet me projektin, në të ardhmen të inventarizohet dhe të arkivohet sipas përcaktimeve në ligjin dhe udhëzimin e arkivave në Arkivin e Projektit ose në Arkivin e ARRSH.

Vazhdimisht

Rekomandimi është në proces.
Nga ana e stafit të Njësisë së Menaxhimit të Projektit, ka nisur inventarizimi i të gjitha dosjeve, në përputhje me Normat Tekniko Profesionale dhe Metodologjinë e Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

25. Gjetje nga auditimi: Në kontratën e fundit të lidhur për shërbim konsulence me objekt përgatitjen e RAP (Individual Consultant Services for RAP preparation) lidhur në datë 03.05.2019 me vlerë 11,100.00 Euro nuk është bërë shpallje, por janë ftuar për të marr pjesë nëpërmjet e-maileve ekspert të ndryshëm, nuk është argumentuar mënyra e përzgjedhjes së këtyre konsulentëve të ftuar në pjesëmarrje duke mos u realizuar procedura konform kërkesave të kërkuara nga udhëzuesit e BB për përzgjedhjen e konsulentëve. (*Me hollësisht trajtuar në pikën D, faqe* 52-87 *të Raportit të Auditimit).*
25.1Rekomandim*:* Njësia e menaxhimit të projektit në të ardhmen në procedura të ngjashme për shërbim konsulence kur procedura zhvillohet pa shpallje por me ftesë për ofertë të argumentojë qartë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e konsulentëve të ftuar për të marr pjesë duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kritereve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, me synimin e përzgjedhjes së ofertës më të mirë ekonomik dhe kapacitetit më të mirë profesional.

Rekomandimi është në proces.
Ky rekomandim ka të bëje me procese pune dhe do të auditohet nga KLSH në auditimet e radhës. Njësia e Menaxhimit të Projektit, konfirmon se do të zbatojë këtë rekomandim në vijim për prokurime të kësaj natyre.

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në datën 28.02.2018 është pushuar nga puna Menaxheri i Projektit me motivacion performancë e dobët gjatë ushtrimit të detyrës, pasi me shkresën nr. 9168/2 prot., datë 06.12.2017 "Kërkesë zyrtare për dorëheqje" nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. A. Q., i është kërkuar Menaxherit të Projektit z. E. N. dorëheqja zyrtare. Mbas kësaj kërkese për dorëheqje nga ana e ARRSH është publikuar në faqen ëeb shpallja e vendit të lirë të punës. Për këtë z. E. N. me shkresën nr. 1358 prot., datë 19.02.2018 "Kërkesë për informacion mbi njoftimin e publikuar në web-in zyrtar të ARRSH-së më datë 15.02.2018 për shpalljen e vendit të lirë punës për pozicionin e Menaxherit të Projektit RRMSP" i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, pasi deri në këtë moment nuk është larguar nga puna. Në datën 28.02.2018 është pushuar nga puna Menaxheri i Projektit z. E. N., me motivacion performancë e dobët. Z. N. ka hapur proces gjyqësor kundër ARRSH për pushim të padrejtë nga detyra, duke u bazuar në kontratën e shërbimit të lidhur mes tij dhe ARRSH. Nga drejtoria e ARRSH nuk u vu në dispozicion asnjë dokument që ngarkonte me përgjegjësi z. N. për veprime të kryera ose të mos kryera nga ana e tij konform detyrave funksionale, apo miratimi nga ana e Bankës Botërore lidhur me pushimin nga puna të Menaxherit të Projektit .Këtë gjë e konfirmon dhe vendimi nr. 6086, datë 05.07.2018, ku Gjykata e Shkallës së Parë të Tiranës ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë dhe dëmshpërblimin e paditësit me dyzetë e dy paga në vlerën *63.000 Euro që përbën efekt ekonomik negativ në të ardhmen.*
-Nga auditimi u konstatua se pozicioni i specialistit të prokurimeve ka qenë vakant nga periudha 22.08.2016 deri në 14.06.2018, dhe nga data 04.07.2019 është larguar nga detyra specialistja e prokurimeve. Nga kjo datë deri në periudhën aktuale ky pozicion konstatohet të jetë vakant. Grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion asnjë dokumentet justifikues i largimit nga puna të znj. E. K..
Në pozicionin e Specialistes së Menaxhimit Financiar është emëruar në datën 02.03.2018 znj. E. A., e cila më pas është pushuar nga puna për performancë të dobët në detyrë, në datën 16.07.2019. Vendi bosh i mbetur në strukturë nga ky largim nga puna ka dëmtuar procesin e disbursimit të fondeve të projektit, dhe ka shkaktuar ngërç.
- Bazuar në pikën 30, faqja 19 të MOP *"Stafi/konsulentët e Projektit mund të pushohen bazuar në performancë dhe në parashikimet e kontratës së punës. Vlerësimet vjetore të performancës së të gjithë stafit duhet të bëhen nga Drejtori i PMT dhe t'i raportohet ARRSH-së dhe Bankës"* largimet nga detyra të stafit/konsulentëve mund të kryhen duke u bazuar në performancën e tyre apo në parashikimet e kontratave të lidhura. Po ashtu referuar këtij manuali, duhet të kryhen vlerësime vjetore të vlerësimeve të performancës të stafit bazuar në specifikimet teknike, e cila duhet të udhëhiqet nga Drejtori i Projektit (pra Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH) dhe t'i raportohet Bankës. *(Me hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 15-24 të Raportit të Auditimit).*
26.1 Rekomandim*:* Nga Drejtori i Projektit të merren masa për kryerjen e vlerësimeve vjetore të performancës së stafit të Projektit bazuar në specifikimet teknike, të mos krijohen vakanca në stafin e Projektit për arsye se sjellin vonesa në implementimin e Projektit. Gjithashtu të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave te shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e tij, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat nga veprimet e deritanishme konsiderohen vlera me efekte negative për projektin.

-Nga Drejtori i Projektit të merren masa për mbrojtjen në të gjitha shkallët e gjykimit të vendimeve për largimin nga detyra që janë në proces gjykimi.

Vazhdimisht

Rekomandimi është në proces.
Nga instancat drejtuese të Projektit do të merren masat, që në vijim të kryhen vlerësimet vjetore të stafit. Tagrin e përfaqësimit ligjor, e ka Drejtoria Juridike pranë ARRSH e cila po i ndjek të gjitha hapat ligjorë dhe procedural, në të gjitha shkallët e gjykimit. Nga ana e Njësisë së Menaxhimit të Projektit janë dërguar të gjithë dokumentet e nevojshme për mbarëvajtjen e procesit gjyqësor.

27. Gjetje nga auditimi: Duke implementuar Amendamentin Nr. 1 dhe Nr. 2 janë shtuar volumet e punimeve dhe kontraktorët nuk kanë dorëzuar siguri bankare shtesë për shtesat e kontratave referuar Kushteve të përgjithshme të kontratës dhe nenit 53.3.3. Në total për të katërt kontratat nuk është depozituar garancia bankare shtesë në vlerën **931,771.7 Euro,**vlerë cila përbën efekt financiar. *(Me hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 87-123 të Raportit të Auditimit).*
***27.1 Rekomandim*:** Nga ana e njësisë menaxhuese të projektit të merret në analizë ky fakt e të ndiqet me rigorozitet hap has hapi për çdo shtesë të kontratave në vlerë, zbatimi i nenin 53.3.3, në mënyrë që kontraktorët e të katërt kontratave A,B,C dhe D të punimeve civile të depozitojnë garanci bankare për shtesat e kontratave.

Menjëherë

Rekomandimi është në proces.
Nga ARRSH janë marrë masat dhe janë dërguar shkresat për kontratorët, me nr. 2999 prot., datë 27.04.2020 "Performance security amendment CD", Shkresa nr. 3000 prot., datë 27.04.2020 "Performance security amendment CA & CB" dhe Shkresa nr. 3001 prot., datë 27.04.2020 "Performance security amendment CC".

IV. C. MASA SHPËRBLIM DËMI

Janë konstatuar dëme ekonomike në masën 62,110,052 lekë dhe 41,475 Euro si më poshtë vijon:

1. Gjetje nga auditimi: Me anë të ndryshimeve të Amendamentit Nr. 2 datë 12.11.2018 të kontratave të punëve civile, çmimi njësi i penalitetit për çdo ditë vonesë për të gjitha Masat e Performancës Menaxheriale (MPM) është reduktuar me mbi 90% në kundërshtim me dokumentet e tenderit dhe kushtet e kontratës. Konkretisht për të gjitha MPM çmimi i penaliteteve është reduktuar në 75 Euro për ditë vonese nga 140,000 lekë apo 350,000 lekë (MPM9, MPM10) për ditë vonese që ishte në specifikimet teknike të kontratës. Në këto tip kontratash bazuar në rezultate dhe performance, kontraktori është vetë përgjegjës për projektimin, implementimin dhe mirëmbajtën dhe ai nuk paguhet direkt për punimet fizike por në bazë performance. Këto penalitete në formën e reduktimeve të pagesave për faza të ndryshme të implementimit të projektit janë një element shumë i rëndësishëm për kontrollin e performancës së kontraktorit e cila përcaktohet pikërisht nga matja e indikatorëve që janë Matës të Performancës Menaxheriale (MPM) dhe Matës të Performancës Operacional (OPM). Zvogëlimi i vlerës së aplikueshme të penaliteteve të pagesave në masë kaq të madhe konsiderohet i paarsyeshëm në një projekt që bazohet në rezultate dhe performance dhe ku performanca e kontraktorit rregullohet pikërisht në bazë të këtyre masave, për më tepër që kontraktorët janë njohur me këto penalitete dhe i kanë pranuar ato që në fazën e tenderit. Në total për të katër kontratat janë mbajtur penalitete në shumen 30,450 euro pa TVSH dhe pa aplikimin e zbritjes, ndërkohe që sipas kushteve të kontratës për të njëjtat kushte duhet të mbaheshin 56,840,000 Lekë pa tvsh dhe pa aplikimin e zbritjes. Diferenca nga ndryshimi i penaliteteve të mbajtura dhe penaliteteve që duhej të ishin mbajtur sipas specifikimeve

teknike për këto situacione, është 435,638 Euro pa TVSH ose **62,110,052.6 Lekë** me TVSH dhe aplikimin e zbritjes referuar kontratave. Kjo vlerë përbën dëm ekonomik që përfaqëson penalitetet e munguara referuar ndryshimeve të paargumentuara të kontratave rrjedhur nga miratimi i Amendamentit Nr.2. (*Me hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 87-123 të Raportit të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të ARRSH në cilësinë e Drejtorit të Projektit dhe instancave më të larta pjesë e këtij projekti, të merren masat dhe të ndiqen hapat administrative dhe ligjore te nevojshme për anulimin e pikës A të Amendamentit Nr. 2 dhe kthimin e aplikimit të Masave të Performancës Menaxheriale sipas kushteve fillestare të kontratës, sepse këto ndryshime janë të paargumentuara dhe të pabazuara në një studim të duhur për uljen e tyre, duke ulur kështu sigurinë dhe nxitjen e kontraktorit për kryerjen në kohë të detyrimeve të tij menaxheriale dhe operacionale të përkthyera në performancë.

Menjëherë

Rekomandimi nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar.

Arsyetimi i subjektit të audituar

1.1 - Ulje në shumat e pagesës për mospërputhje me Masat e Performancës së Menaxhimit (MPM).

Auditori kritikoi si të paarsyeshëm dhe shumë të favorshëm për kontraktorët uljen e bërë në Amendimin 2 të normave ditore të uljeve të pagesave (penalitete) për mosrealizimin e MPM. Qëllimi i zvogëlimit të pagesës është të sigurojë një incentivë (negativ) për kontraktorët që të respektojnë kërkesat e MPM. Këto penalitete duhet të jetë i ashpër për kontraktuesit, por nuk duhet të çojë në falimentimin e tyre, përveçse në raste ekstreme. Kur u përcaktuan normat fillestare të zbritjes së pagesës, nuk u bë studim i duhur dhe shumica e shumave të penaliteteve u vendosën në mënyrë të paarsyeshme të larta. Kjo duhej të korrigjohej, ose përndryshe do të çonte kontraktorët në terminimin e zbatimit të kontratës, ose në falimentimin e kontraktuesit, me kosto të lartë për Shtetin e Shqipërisë. Siç ka vënë në dukje auditi, janë bërë shumë diskutime nga të gjitha palët në këtë proces (dhe kujdesi nga Auditimet e ardhshme) përpara se të miratoheshin normat e rishikuara.

Ndryshimi i Klauzolës së PC-së 57.1 në dokumente dhe raporte që duhet të dorëzohen.

Auditi pretendon se modifikimi i Klauzolës së PC-së 57.1 ka cuar në heqjen e afateve për dorëzimin e Raporteve të Dorëzimit të Punimeve, duke bërë të pamundur aplikimin e nenit 57.2. Sqarojmë se në Amendimin nr. 3, pika B.3.6.5 është rivendosur afati prej 56 ditësh për dorëzimin e Raporteve të Dorëzimit të Punimeve. Sa më sipër, mosrespektimi i këtij afati aktivizon klauzolën 57.2, si rrjedhim ne e quajmë të ezuruar këtë koment.

(i) Teksti origjinal i Specifikimeve deklaron që MC do të përcjellë memorandumin e tij "menjëherë" pasi të ketë përfunduar inspektimi formal. Sidoqoftë, përvoja praktike me inspektime formale ka treguar që koha që është e nevojshme për MC për të përfunduar këtë raport voluminoz është dy ditë, dhe se ajo i transmetohet kontraktorit në ditën e tretë. Teksti i rishikuar e merr parasysh këtë realitet. (ii) Auditi ka arritur në përfundimin se me këtë ndryshim, ulja e pagesës OPM u zhvendos nga e njëjta ditë e inspektimit në katër ditë më pas. Kjo është e pasaktë, sepse zbritja e pagesës së ditës së parë ende aplikohet me efekt të menjëhershëm. Është vetëm Periudha Gri (Grace Period) për korrigjimin e mangesive të evidentuar në terren e cila fillon ditën e tretë pas inspektimit kur kontraktori merr memorandumin nga Konsulenti Monitorues dhe informohet me shkrim për mospërputhjet.

2. Gjetje nga auditimi: Afati i përfundimit të punimeve të rehabilitimit dhe përmirësimit nga 25 muaj, me anë të ndryshimeve të parashtruara në amendamentin nr. 3 është shtyrë në 28 muaj nga data e firmosje së kontratës. Gjithashtu kjo shtyrje afati të punimeve është bërë disa muaj mbasi punimet kanë përfunduar, duke i dhënë amendamentit vendimmarrje me fuqi prapavepruese. Në rastet kur punimet e përmirësimit nuk përfundonin brenda afatit 25 muaj

do të aplikoheshin penalitete Liquidated Damages në vlerën 0.10 % për ditë kalendarike vonese të pagesës për punë specifike për të cilat ka kaluar afati i përfundimit, me një maksimum total prej 10% të vlerës së kontratës për punime përmirësimi. Aktualisht punimet e përmirësimit kanë përfunduar me vonesë duke tejkaluar afatin 25 muaj por brenda afatit 28 muaj të parashtruar nga Amendamenti Nr.3, ose shumë pak ditë mbi të. Ky ndryshim i nenit 39.1 të kushteve të veçanta favorizon kontraktorin dhe liron kontraktorin nga penaliteti Liquidated Damages për vonesa të deritanishme në përfundimin e punimeve të përmirësimit, gjithashtu i kthen mbrapsht kontraktorit ato penalitete që i janë mbajtur deri tani. Për tre kontratat e punimeve civile A,B,D që përfshijnë punime përmirësimi, penalitetet Liquidatet Damages i deritanishëm në vlerën në total **40,321.07 Euro,** sipas Amendamentit Nr. 3 do t'i rikthehen kontraktorit. *(Me hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 87-123 të Raportit të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi:Nga ana e Drejtorit të ARRSH në cilësinë e Drejtorit të Projektit dhe instancave me të larta pjesë e këtij projekti, të merren masat dhe të ndiqen hapat administrative dhe ligjore për të anuluar ndryshimin e nenit 39.1 të kushteve të veçanta të kontratës nëpërmjet amendamentit nr. 3 dhe operatoreve t'i mbahet garancia LD sipas afateve fillestare.

Menjëherë

Rekomandimi nuk pranuar dhe nuk është zbatuar.
Arsyetimi i subjektit të audituar:
Ky ndryshim ndoshta është keqkuptuar nga Audituesi. Ky ndryshim favorizon qartë ARRSH-në, duke lejuar ARRSH që t'i kërkojë Kontraktuesit që të bëjë Punime Rehabilitimi dhe Përmirësimi në çdo kohë gjatë periudhës së mbetur të kontratës. Kufizimi fillestar kohor prej 12 muajsh, i cili më pas u zgjat në 25 muaj, është bërë i parëndësishëm, sepse të gjitha veprat e Rehabilitimit dhe Përmirësimit janë porositur dhe ekzekutuar në bazë të Urdhrave të Ndryshimit ose Urdhrave të Punës, secila prej të cilave përcakton kohën e vet për përfundim. Nga ana tjetër, punimet e parashikuara në mirëmbajtjen periodike (shtresat asfaltike) të cilat janë të shtrira deri në 5 vite, sikurse është theksuar, u vërejt se nuk do të ishin efikase pasi dëmtimet në rrugë nuk ishin për shkak të konsumimit të asfaltit, por për shkak të kapacitetit mbajtjes të shtresave, prandaj ato janë zëvendësuar ose do të zëvendësohen me punime rehabilitimi. Pra kjo kohë tashmë është bërë pjesë e këtij ndryshimi dhe e urdhrave të punës. Shumë objekte shtesë rehabilitimi akoma nuk hanë përcaktuar nga ARRSH për të ardhmen për shkak të fondeve. Ndryshimi i bërë nuk ndikon në zbatueshmërinë e penalitetit të likuidimit të dëmeve, nëse përfundimi i punimeve vonohet përtej datës së përfundimit të përcaktuar në Urdhrin Ndryshim ose Urdhrin e Punës.

3. Gjetje nga auditimi: Gjatë verifikimit në terren të punimeve civile të kontratës D konkretisht Urdhrin e punimeve të emergjencës EË01 seksioni i rrugës Vila Jonufer km 1+400, u konstatuan 13.35 m3 betone të pavendosura për zërin e punimeve muri gravitacional prej betoni që i korrespondon vlerës ***1,154.5 Euro*** për Urdhrin e emergjencës EË01. Vlera në total ***1,154.5 Euro*** përben dëm ekonomik për punime te pakryera nga kontraktori i Kontratës D. *(Me hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 87-123 të Raportit të Auditimit).*
3.1 Rekomandimi: Njësia e menaxhimit të projektit dhe Konsulenti Monitorues të marrin masa që në Situacionet në vijim të zbritet vlera e punimeve të miratuara e të pakryera në shumën **1,154.5 Euro.**

Menjëherë

Rekomandimi është në proces.
Bazuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Klauzola 49.5 "Projekt Menaxheri mund të zbresë çfarëdo Zë Punimesh ose mund të reduktojë volumet e çdo Zëri Punimesh të

certifikuar më herët, në Pagesat e ardhshme sipas verifikimeve të mëvonshme."Në këto kushte duke qenë se pagesat janë Pagesa të Ndërmjetshme dhe jo përfundimtare, çdo pagesë e bërë më herët për Zëra Punimesh të konstatuara më vonë si të pa realizuara, do të zbriten. Është komunikuar me Kontraktorin, dhe janë bërë rregullimet përkatëse. Konfirmuar nga shkresa e ARRSH nr. 4001 prot., datë 08.06.2020 "Regarding the State Audit Recommendation for EVVO D1".

V. D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.
Janë konstatuar efekte negative financiare në masën 137,500,000 lekë dhe 1,965,011 Euro si më poshtë vijon:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se nga mos tërheqja e fondeve të kredisë pra mos aftësisë menaxhuese të tërheqjes së disbursimeve referuar planifikimit të paraqitur në marrëveshje, janë paguar komisione angazhimi deri më 30 tetor të vitit 2019 shuma gjithsej 564,611.07 Euro (**ose 283,061.07 Euro më shumë)** kundrejt 281,550 Euro që do të paguhej në qofte se do të realizoheshin sipas afateve, objektivat e projektit deri në fund të zbatimit të tij. Gjithashtu referuar faktit të afrimit të afatit të pagesës së këstit të dytë të komisionit të angazhimit për vitin 2019 (në nëntor) kjo shumë pritet të jetë më e lartë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 36-52 të Raportit të Auditimit).*
1.1 Rekomandim: Nga Komisioni Drejtues Teknik dhe Drejtori i Projektit, të analizohet situata dhe shkaqet e rezultuara me pasojë efektin financiar në shumën 283,061.07 Euro për pagesa për komisione angazhimi më shumë se planifikimi deri në momentin e auditimit, shumë e cila do të rritet me afro 60,000 euro me pagesën pasardhëse (në fund të vitit 2019) në qoftë se nuk realizohet disbursimi që është në proces.
-Të merren të gjitha masat teknike dhe organizative për zbatimin në kohë të kërkesave të përcaktuara në kontratat e kontraktorëve si dhe hartimin sipas përgjegjësive të dokumentacionit, në çdo rast të kërkesave për disbursim, referuar realizimit të DLI.

Menjëherë

Rekomandimi është në proces.
Nga PMU do ti dërgohet shkresë Komitetit Drejtues që të analizohet situata dhe shkaqet për komisionet e angazhimit.

2. Gjetje nga auditimi: Me ndryshimin e nenit 57.1 sipas Amendamentit Nr. 2 janë hequr afatet e dorëzimit të raportit të përfundimit të punimeve, por afati i përcaktuar në kontratë lidhet me nenin 57.2 që specifikon se nëse dokumentet e mësipërme nuk dorëzohen sipas afateve të caktuara, kontraktorit do t'i mbahet shuma 1,500,000 lekë. Pra ky ndryshim me amendamentin nr. 2 përveç datës së dorëzimit të raporteve të përfundimit të punimeve, heq dhe shumën që duhet ti mbahet kontraktorit kur nuk dorëzon këto dokumente në afat. Ky ndryshim sjell vonesa ne dorëzimin e raportit te përfundimit te punimeve dhe justifikim t*ë* vonesave duke mos mbajtur shumen e sipërpërmendur. Në total në të katër kontratat referuar datave të deklaruara të përfundimit te punimeve duhej të ishte mbajtur vlera ***137,500,000 Lekë.*** Ndryshimi i kësaj pike me Amendamentin Nr. 2 ka shkaktuar efekt financiar negativ ne vlerën 137,500,000 Lekë. *(Me hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 87-123 të Raportit të Auditimit).*
2.1 Rekomandim: Nga ana e Drejtorit të ARRSH në cilësinë e Drejtorit të Projektit dhe instancave me të larta pjesë e këtij projekti, të merret në analizë ky fakt, si dhe të ndërmerren veprime konkrete të nevojshme për anulimin e pikës se Amendamentit Nr. 2 që bën ndryshimin e nenit 57.1.

Menjëherë

Rekomandimi nuk pranuar dhe nuk është zbatuar.

Arsyetimi i subjektit të audituar

2.1 – Ulje në shumat e pagesës për mospërputhje me Masat e Performancës së Menaxhimit (MPM).

Auditori kritikoi si të paarsyeshëm dhe shumë të favorshëm për kontraktorët uljen e bërë në Amendimin 2 të normave ditore të uljeve të pagesave (penalitete) për mosrealizimin e MPM. Qëllimi i zvogëlimit të pagesës është të sigurojë një incentivë (negativ) për kontraktorët që të respektojnë kërkesat e MPM. Këto penalitete duhet të jetë i ashpër për kontraktuesit, por nuk duhet të çojë në falimentimin e tyre, përveçse në raste ekstreme. Kur u përcaktuan normat fillestare të zbritjes së pagesës, nuk u bë studim i duhur dhe shumica e shumave të penaliteteve u vendosën në mënyrë të paarsyeshme të larta. Kjo duhej të korrigjohej, ose përndryshe do të çonte kontraktorët në terminimin e zbatimit të kontratës, ose në falimentimin e kontraktuesit, me kosto të lartë për Shtetin e Shqipërisë. Siç ka vënë në dukje auditi, janë bërë shumë diskutime nga të gjitha palët në këtë proces (dhe kujdesi nga Auditimet e ardhshme) përpara se të miratoheshin normat e rishikuara.

Ndryshimi i Klauzolës së PC-së 57.1 në dokumente dhe raporte që duhet të dorëzohen.

Auditi pretendon se modifikimi i Klauzolës së PC-së 57.1 ka çuar në heqjen e afateve për dorëzimin e Raporteve të Dorëzimit të Punimeve, duke bërë të pamundur aplikimin e nenit 57.2. Sqarojmë se në Amendimin nr. 3, pika B.3.6.5 është rivendosur afati prej 56 ditësh për dorëzimin e Raporteve të Dorëzimit të Punimeve. Sa më sipër, mosrespektimi i këtij afati aktivizon klauzolën 57.2, si rrjedhim ne e quajmë të ezauruar këtë koment.

(i) Teksti origjinal i Specifikimeve deklaron që MC do të përcjellë memorandumin e tij "menjëherë" pasi të ketë përfunduar inspektimi formal. Sidoqoftë, përvoja praktike me inspektime formale ka treguar që koha që është e nevojshme për MC për të përfunduar këtë raport voluminoz është dy ditë, dhe se ajo i transmetohet kontraktorit në ditën e tretë. Teksti i rishikuar e merr parasysh këtë realitet. (ii) Auditi ka arritur në përfundimin se me këtë ndryshim, ulja e pagesës OPM u zhvendos nga e njëjta ditë e inspektimit në katër ditë më pas. Kjo është e pasaktë, sepse zbritja e pagesës së ditës së parë ende aplikohet me efekt të menjëhershëm. Është vetëm Periudha Gri (Grace Period) për korrigjimin e mangësive të evidentuar në terren e cila fillon ditën e tretë pas inspektimit kur kontraktori merr memorandumin nga Konsulenti Monitorues dhe informohet me shkrim për mospërputhjet.

3. Gjetje nga auditimi: Vlera e kontratës së Konsulentit Monitorues nga **5,880,360 Euro me TVSH** nëpërmjet Addendum 6 dhe Addendum 7 është rritur me 28.5 % ose'**1,674,200 Euro** me TVSH me shumë, si rrjedhojë e ndryshimeve të konceptit të kontratave të punime civile dhe vonesave në afate rrjedhura nga Amendamenti Nr. 1 i kontratave. Kjo rritje përbën efekt negativ për projektin të rezultuara si pasoje e Amendamentit. *(Me hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 87-123 të Raportit të Auditimit).*

3.1 Rekomandim:Nga komiteti teknik drejtues dhe drejtori i projektit të analizohet efekti negativ i vlerës prej **1,674,200 Euro** i ardhur nga shtesat e kontratave të Konsulenti Monitorues.

Menjëherë

Rekomandimi nuk është zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Dy nga kontratat e lidhura për këtë projekt nuk kanë lidhje me objektivat e tij, nuk kanë qenë pjesë e planit të prokurimit si dhe nuk janë pasqyruar as në planin e fundit të rishikuar të prokurimit të projektit, në kundërshtim të plotë me Ligjin nr. 71/2015, datë 02.07.2015 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së

Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin "Mirëmbajtje dhe Siguri rrugore bazuar në rezultate", konkretisht me pikën 2 "Huaja", pikën 3 "Projekti" të kushteve të përgjithshme dhe me objektivat e projektit përshkruar hollësisht në pjesën e parë dhe pjesën e dytë të marrëveshjes.
Konkretisht kontrata me nr. 8373 prot., datë 27.09.2018 me vlerë 3,500,00 Euro Individual Consultant (Environmental Expert) for the Western Balkans Trade and Transport Facilitation Projekt dhe kontrata e dytë me nr. 8946, datë 15 tetor 2018 me vlerë 4,250.00 Euro Individual Consultant (social expert) for the Western Balkans Trade and Transport Facilitation Projekt. (5,100.00 EU vat included). Referuar termave të referencës së këtyre kontratave të nënshkruara ndërmjet ekspertëve mjedisor dhe social dhe ish drejtorit të ARRSH në aneksin A të tyre, rezulton se ato nuk gjejnë zbatim në asnjë pikë të projektit përmirësimi i sigurisë rrugore bazuar në performancë. Duke qenë se kontratat janë lidhur dhe ka mbaruar realizimi i tyre, ekspertët e kontraktuar janë paguar në shumën totale 7,750.00 Euro (3,500,00 Euro eksperti mjedisor + 4,250.00 Euro eksperti social) vlerë e cila përbën efekt financiar për buxhetin e projektit si shpenzim i kryer jashtë objektivave të projektit. (*Me hollësisht trajtuar në pikën D, faqe 52-87 të Raportit të Auditimit*).
4.1 ***Rekomandim*****:** Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH-së në cilësinë e drejtorit të projektit si dhe projekt menaxheri i projektit të analizojnë edhe nëpërmjet Bankës Botërore shumën prej **7,750.00 Euro**, e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurat e zhvilluara për vitin 2018 me objekt konsulent individual- ekspert mjedisor dhe konsulent individual - ekspert social "Individual Consultant (Environmental Expert dhe Social Expert)", pasi kjo vlerë ka rënduar shpenzimet e Projektit për arsye se këto dy procedura janë jashtë objektivave të tij. Gjithashtu në të ardhmen për konsulenca në projekte të ngjashme (të cilat janë në fazën para miratimit të marrëveshjes se financimit) të merret paraprakisht miratimi i Ministrisë së Financave si Huamarrës.

Menjëherë

Rekomandimi është në proces.
Nga ARRSH është pranuar rekomandimi dhe konfirmohet se do të dërgohet shkresa MFE, që projekti përfitues (në këtë rast projekti i Western Balkan Trade Facilitation) të kthejë vlerën respektive për buxhetin e projektit MSRrBR.

VI. E. <u>MASA DISIPLINORE</u>

-Për të gjitha shkeljet e konstatuara përgjatë këtij Vendimi (rrjedhojë e Amendimeve të kontratave), përgjegjësia e drejtpërdrejtë është tek Drejtori ARRSH në cilësinë e Drejtorit të Projektit. Për rrjedhojë për ish-drejtorët *z. A. Q* dhe *Znj. S. Q.* masa do të ishte "Largim nga Detyra".
-Për Menaxherin e Projektit dhe ish Menaxheret:
1. *Z. K. S.*
2. *Z. E. N.*
3. *Znj. E. A.*

Nuk do të rekomandojmë masë disiplinore.

Aneksi nr. 2 – Trajtimi i zgjeruar i auditimit të pasqyrave financiare të të tre Drejtorive Rajonale.

Drejtoria Rajonale Veriore, Shkodër

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 385/1prot., datë 04.05.2022, *"Mbi auditimin e Pasqyrave Financiare në Drejtorinë Rajonale Të Veriut, Shkodër"*, u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti, si më poshtë:

Hartimi i Bilancit të Drejtorise Rajonit Verior vitin 2020 mbështetet në:

- Ligjin nr. 9228 , datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin".
- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".
- VKM nr. 248, datë 10.04.1998, të ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.25, datë 20.01.2001 "Për miratimin e Planit Kontabël Publik të Organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qëndrore e Lokale si dhe njësive që varen prej tyre".
- Udhëzimit të Ministrisë Së Financave nr. 26, datë 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e Pasqyrave Financiare Vjetore për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit /zbatimit të Projekteve e Marrëveshjeve me Donatorë të Huaj".
- Udhëzimin Nr.46, datë 24.12.2020 për "Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2021".
- Udhëzimit Nr.8, datë 09.03.2018, Për Proçedurat e Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme"

Pasqyrat financiare të vitit 2020 të qeverisjes së përgjithshme përbëhen nga Pasqyrat Financiare të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër.

Pasqyrat Financiare kanë për qëllim të japin një pamje të strukturuar të pozicionit financiar dhe transaksioneve për çdo njësi të qeverisjes së përgjithsme, të sigurojnë informaion për pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare.

Qëllimi i përgjithshëm është që me informacionin që disponojnë, pasqyrat financiare në radhë të parë të japin informacion të besueshëm për vendimarrje për njësinë po institucionin raportues nëpërmjet:

- Sigurimit të informacionit rreth burimeve financiare dhe alokimin e tyre;
- Informacionit për mënyrën e financimit të aktiviteteve të njësisë dhe realizimit të kërkesave monetare;
- Lidhur me aftësinë e njësisë pët të financiar aktivitetet dhe për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet;

Informacionit për vlerësimin e performancës së njësisë;

Pasqyrat Financiare vjetore të njësisë së qeverisjes së përgjithshme përbehen nga:

Formati nr. 1 – Pasqyra e Pozicionit Financiar;

Formati nr. 2 – Pasqyra e Performancës Financiare ose Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve;

Formati nr. 3 – Pasqyra e Flukseve Monetare;

Formati nr. 4 – Pasqyra e ndryshimeve Aktivet Neto/Fondet Neto;

Formati nr. 5 – Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;

Formati nr. 6 – Pasqyra e Investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre (Pasqyrë statistikore);

Formati nr. 7 – Pasqyra mbi gjëndjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto (Pasqyrë statistikore);

Formati nr. 8 – Pasqyra e numrit te punonjësvedhe fondi i pagave (Pasqyrë statistikore);

Rubrikat dhe postet e bilanceve kontabël të këtij institucioni janë përmbledhur në një të vetëm.

AKTIVI I BILANCIT

- **Rubrika A e pasqyrës së Pozicionit Financiar**

Aktivet paraqiten në rubrikën A të pasqyrës së pozicionit financiar të vitit 2020 dhe janë në vlerën **4,474,769,003 lekë** nga **4,788,451,417 Lekë** që ishte në fund të vitit 2019. Shuma e aktivit në Pasqyrën e Performancës Financiare pasqyron aktivet afatshkurtra, aktivet afatgjata kërkesat për tu arkëtuar dhe mjete monetare në llogarinë e thesarit që i shërbejnë institucionit për zhvillimin e aktivitetit të tij.

Aktivet Afatshkurtra

Nënrubrika e "**Mjeteve monetare dhe ekuivalentet e tyre"** përbëhet nga mjete monetare në ruajtje në llogarinë e thesarit dhe "Disponibilitete në Thesar", të rakorduara me Formatin 3 të pasqyrave financiare Cash Flow.

Llogaria **520 "Disponibilitete në thesar"** vlera prej **2,834,310 lekë** përfaqëson fondet e depozituara të trashëguara gjatë viteve të mëparshme.

Llogaritë inventariale **31 "Materiale"** me vlerë **4,091,671 lekë** dhe 32 "Inventar i imët" me vlerë **279,352 Lekë** pasqyrojnë gjendjen e materialeve të rakorduara me inventarët kontabël të tyre për vitin 2020.

Nënrubrika "Llogari të arkëtueshme" paraqitet në vlerën **43,211,257 lekë** për vitin 2020, nga **1,654,412 Lekë** që ka qenë në vitin 2019, e cila pasqyron operacione me shtetin (të drejta), si dhe gjendjen e debitorëve të viteve të kaluara.

Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" është 107,707,919 **lekë** në fund të vitit 2020.Të cilat janë detyrime të prapambetura të krijuara për kontratat e mirëmbajtjes së rrugëve gjatë vitit 2020.

Aktivet Afatgjata

Rubrika "**Aktive Afatgjata**" përbëhet nga shuma e Aktiveve Afatgjata Materiale, Aktivet Afatgjata Jomateriale dhe ato financiare. Në vitin 2020 është në vlerën **4,316,644,594 lekë** nga **4,546,109,274 lekë** që ishte në vitin 2019.

Llogaria 210 "Toka, Troje, Terrene" me vlerë **1,538,000 Lekë** është mbartur nga ish-Drejtoria Rajonale rrugore Kukës ne vitin 2012.

Llogaria 212 "Ndërtime e Konstruksione" me vlerë neto **13,988,200 Lekë**, përfaqëson vlerën e ndërtesave të Drejtorise Rajonit Verior.

Llogaria 213 "Rrugë, Rrjete, Vepra Ujore,, me vlerë neto **4,280,906,847 lekë**, përfaqëson investimet në segmentet rrugore në vite.

Llogaria 214 "Instalime teknike, makinerie pajisje pune" paraqitet me vlerë neto 10,494,609 lekë.

Llogaria 215 "**Mjete Transporti**" mbyllet me vlerën 9,379,994 lekë për vitin 2020, nga 11,724,993 Lekë që ishte në vitin 2019.

Llogaria 218 "**Inventari ekonomik**" mbyllet me vlerën 336,944 lekë nga 433,287 lekë që ishte në vitin 2019.

Për të gjitha ndryshimet në Aktivet Afatgjata materiale janë paraqitur me hollësi në pasqyrën 7, ku jepen gjendja dhe ndryshimet e tyre, për vlerën bruto dhe neto të aktiveve, në fillim të periudhës dhe lëvizjet brenda tyre, nxjerrjet jashtë përdorimit dhe llogaritja e amortizimit të akumular deri në fund të vitit 2020.

Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" për shumën 107,,707,919 lekë per vitin 2020 nga 234,730,403 Lekë qe ishte ne vitin 2190 detyrime të prapambetura për kontratat e mirëmbajtjes rrugeve.

PASIVI I BILANCIT

- **Rubrika B e pasqyrës së Pozicionit Financiar**

Pasivi i Bilancit është i kuadruar me Aktivin e Bilancit dhe është në vlerën **4,474,769,003** Lekë.

Llogaria "**Pasivet ASH**" paraqiten në vlerën **153,753,386 Lekë** më 31.12.2020, nga 239,219,025 lekë që ishte më 31.12.2019

Më analitikisht kjo llogari paraqitet si më poshtë:

Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit", në fund të vitit 2020 është në vlerën 765,634 lekë, nga 770,777 lekë që ishte në vitin 2019.

Llog. 401 - 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", përfaqëson detyrimet afatshkurtër ndaj të tretëve gjë që është në vlerën 41,600,705 lekë, në fund vitin 2020.

Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa", në fund të vitit 2020 rezulton në vlerën 58,208 lekë nga 57,014 lekë që ishte në vitin 2019.

Llog. 435 & 436 "Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore" në vlerën 258,843 lekë, përfaqëson kontributin e sigurimit shoqëror 227,299 lekë dhe shëndetësor 31,544 lekë të muajit Dhjetor 2020, të cilat likujdohen në muajin Janar 2021 me fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2021.

Llogaria 4341 "Të tjera operacione me shtetin" në vlerën 527,867 lekë përfaqëson detyrimet e institucionit ndaj buxhetit të shtetit. Kjo llogari nuk ka ndryshime nga viti 2019.

Llogaria 466 "Kreditore per mjete ne ruajtje" me vlerë 2,834,210 lekë përfaqëson mjete në ruajtje për garancinë e punimeve që aplikohet tek punimet civile gjatë implementimit të kontratave.

Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" me vlerë 107,707,919 lekë përfaqëson detyrimin e shtetit ndaj furnitorëve per kontratat e mirëmbajtjes së rrugëve.

Llogaria 63, me vlerë **(+) 1,247,905 lekë** është sa ndryshimi i gjëndjeve të magazinës në aktiv të bilancit kontabël dhe diferenca , është transferuar në llogarinë për transferimin e ndryshimit të gjëndjeve.

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	**A**	**A K T I V E T**	**4,474,769,003**	**4,788,451,417**
2		**I.Aktivet Afat shkurtra**	**158,124,409**	**242,342,143**
3		**1.Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre**	**2,834,210**	**2,834,210**
4	531	Mjrete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjrete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	2,834,210	2,834,210
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		**2.Gjendje Inventari qarkullues**	**4,371,023**	**3,123,118**
12	31	Materiale	4,091,671	2,843,766
13	32	Inventar I imet	279,352	279,352
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		

21		**3.Llogari te Arketushme**	**43,211,257**	**1,654,412**
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	341,170	341,170
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetsore		
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitore te ndryshem	186,697	186,697
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	42,683,390	1,126,545
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
36		**4.Te tjera aktive afatshkurtra**	**107,707,919**	**234,730,403**
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	107,707,919	234,730,403
42		**II.Aktivet Afat gjata**	**4,316,644,594**	**4,546,109,274**
43	**20**	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**0**	**0**
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime		
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	**21**	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**4,316,644,594**	**4,546,109,274**
48	210	Toka, T,roje, Terene	1,538,000	1,538,000
49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndertesa e Konstruksione	13,988,200	14,724,421
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	4,280,906,847	4,506,217,733
52	214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	10,494,609	11,470,840
53	215	Mjete Transporti	9,379,994	11,724,993
54	216	Rezerva Shteterore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	336,944	433,287
57	24	Aktive afatgjata te demtuara	0	0
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	**0**
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
Aktivet paraqiten në rubrikën A të pasqyrës së pozicionit financiar. Totali i aktiveve përbëhet nga shuma e totalit të aktiveve afatshkurtra dhe totalit të aktiveve afatgjata.

Rubrika I e aktiveve, që përfaqëson aktivet afatshkurtra, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, në vlerën 7,098,592 lekë, gjendje inventari qarkullues në vlerën **8, 208,733** lekë, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra në vlerën **15,418,217** lekë.

- **Nënrubrika e "Mjeteve monetare dhe ekuivalentet e tyre"** përbëhet nga mjete monetare në ruajtje në llogarinë e thesarit në vlerën **7,098,592** lekë. Kjo llogari në krahasim me vitin e kaluar ka pësuar një rritje në vlerën **310,831** lekë. Kjo nënrubrikë është kuadruar me Formatin 3 të pasqyrës Cash Flow.
- **Nënrubrika "Gjendje inventari qarkullues"** në vlerën **8,208,733** lekë, pasqyron gjendjen materiale në magazinë. (kuadruar me inventarët fizikë).
- **Nënrubrika "Llogari të arkëtueshme"** në vlerën **15,418,217** lekë, pasqyron gjendjen e debitorëve të viteve të kaluara konkretisht **13,421,781** lekë. Llogaria 4342 "Operacione me shtetin - debitorë' në vlerën **1,996,436** lekë pasqyron detyrimin e shtetit ndaj institucionit për marrjen e grantit për shlyerjen e kreditorëve të vitit të kaluar në vlerën **773,528** lekë, dhe në vlerën **1,222,908** lekë, detyrimeve ndaj punonjësve për paga,sigurime shoqërore dhe shëndetësore, TAP, (llogaritë kundërparti (llog421,431,435,436) dhe llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" në postin B / Pasive të Pasqyrës së Pozicionit Financiar).
- **Nënrubrika "Të tjera aktive afatshkurtra"** me vlerën **62,463,731** lekë, përfaqëson shpenzime të periudhave të ardhshme për kontratat e lidhura për mirëmbajtjen e rrugëve.

Rubrika II e aktiveve, që përfaqëson Aktivet Afatgjata, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë: AAGJ jomateriale, Materiale dhe Financiare. Në këtë kjo vlerë përfaqesohet vetëm nga AAGJ material, në vlerën neto prej **5,788,319,899 lekësh.**

- Nuk ka patur ndryshime në vlerën e AAGJ **(Toka - llogaria 210**), vlera neto e së cilës është **41,773 lekë**.
- Në vlerën e AAGJ **(Ndërtesa - llogaria 212**) prej 20,390,493 lekë, rezulton një rritje nga vlera fillestare e vitit prej **7,315,000 lekësh**, si pasojë e rikonstruksionit të ndërtesës dhe

përllogaritjes së amortizimitvjetor. Ky ndryshim është paraqitur me hollësi edhe në pasqyrën statistikore F7 që shoqëron Pasqyrat Financiare.

- Në vlerën e AAGJ **(Rrugë, rrjete, vepra ujore – llogaria 213),** paraqitet një rënie vlere nga fillimi i vitit si pasojë e llogaritjes së amortizimit vjetor. Vlera neto e kësaj llogarie është **5,755,709,471 lekë**.
- Nuk paraqiten ndryshime në AAGJM **"Instalime teknike, makinëri, pajisje vegla punë – llogaria 214".** Vlera neto e kësaj llogarie është **0 lekë**.
- **Mjetet e transportit – llogaria 215** paraqitet në vlerën 11,657,054 lekë, është vlera neto e paraqitur në bilancin e vitit 2020, kemi një ulje vlere nga fillimi i vitit, si pasojë e llogaritjes së amortizimit vjetor.
- AAGJM **"Inventar ekonomik – Llogaria 218"** ,vlera neto është **521,109 lekë**, si pasojë e shtesave nga: blerjet në vlerë 155,500, dhurim në vlerën 14,609 lekë, të korrigjuara me amortizimin e akumuluar deri në fund të periudhës dhe nxjerrjet jashtë përdorimit me vlerën 62,823 lekë.

-Gjithashtu në Pasqyrën 7/b, paraqitet gjendja e amortizimit të akumuluar në total **597,122,888** lekë, dhe për secilin nga AAGJM veçmas, shtesa e tij si pasojë e amortizimit vjetor të llogaritur në total në vlerën **307,856,586** lekë, dhe për secilin AAGJM veçmas. Pakësimët për amortizimin si pasojë e nxjerrjes jashtë përdorimit me vlerë 62,823 lekë. Totali i amortizimit të akumuluar në fund të periudhës kontabel 2020 është në vlerë **6,693,236,551** lekë.

- Në nënrubrikën **"Investime"** pasqyrohen shpenzimet për AAGJ Materiale të trashëguara në vlerën **93,978,051 lekë,** dhe një shtesë prej 6,216,620 lekë shpenzime për investime të kryera në vitin 2020. Investimët e përfunduara paraqiten në vlerën **7,470,500 lekë.** Totali i investimeve të pa përfunduara është **92,724,171 lekë,** te trashëguara nga vitet e mëparshme.

Rubrika B e pasqyrës së pozicionit financiar pasqyron Pasivet (detyrimët). Totali i pasiveve përbëhet nga shuma e totalit të pasiveve afatshkurtra dhe totalit të pasiveve afatgjata. Rubrika e I-rë e pasiveve, që përfaqëson pasivet afatshkurtra, përbëhet nga shuma e nënrubrikave të llogarive të pagueshme dhe të tjera pasive afatshkurtra. Këto të fundit rezultojnë në vlerën **1,120,371** lekë, të prejardhura nga periudha raportuese paraardhëse.

Nënrubrika "Llogari të pagueshme" analizon detyrimët sipas zërave, si psh: detyrime ndaj personëlit në vlerën 864,514 lekë, detyrime për TAP 66,028 lekë, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, 292,366 lekë, totali i të cilave së bashku me një pjesë të llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" në vlerën 773,528 lekë paraqiten në aktivin e bilancit në llogarinë 4342 "Operacione me shtetin debitorë" 1,996,436 lekë. Pjesa tjetër e llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm në vlerën 62,463,731 lekë, ka kunderparti në aktivin e Bilancit, në llogarinë e aktiveve të tjera afatshkurtra.

Llogaria 4341" Operacione me shtetin - detyrime" rezulton në vlerën 13,421,781 lekë, me kunderparti në aktivin e bilancit në llogarinë 468 "Debitorëve të ndryshëm", pasqyron të drejtat e institucionit ndaj të tretëve të cilat duhet të derdhen në buxhet. Por e gjithë shuma është e prejardhur nga vitet e kaluara. Llogaria 466 "Mjete në ruajte" rezulton në vlerën 7,098,592 lekë, dhe përputhet me mjetet monetare në llogarinë e thesarit (llog 520). Shuma e mësipërme përfaqëson mjetet në ruajtje për garancinë e punimeve që aplikohet tek punimët civile gjatë implementimit të kontratave.

Rubrika C e pasqyrës së pozicionit financiar evidenton aktivet neto ose fondet neto.m Fondet neto përbëjnë diferencën midis totalit të aktiveve me totalin e pasiveve:

5,974,233,703 lekë - 86,101,270 lekë = 5,888,132,433 lekë.

Fondet neto kanë pësuar ndryshime nga fillimi i periudhes ushtrimore, në ulje. Më poshtë paraqiten shtesat dhe pakësimët që kanë sjellë këtë ndryshim:

Shtesa në total	**8,230,508 lekë**
Rritja e AAGJ inventar ekonomik	170,109 lekë
Rritja e vlerës së AAGJ material, ndërtesa	7,315,000 lekë
Rritje nga ndryshimi i gjendjes së inventarit të magazinës	745,399 lekë
Pakësimi në total	**-307,096,57 lekë**
Si pasojë e llogaritjes së amortizimit të akumuluar për vitin 2020	**-307,096,57 lekë**

Gjendja në fillim + shtesat- pakësimët

6,095,034,340 lekë + 8,230,508-307,096,57 lekë = 5,795,408,262 lekë +92,724,171 lekë = 5,888,132,433 lekë.

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	**A**	**A K T I V E T**	**5,974,481,888**	**6,212,838,993**
2		**I.Aktivet Afat shkurtra**	**93,437,818**	**30,169,565**
3		**1.Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre**	**7,098,952**	**6,787,761**
4	531	Mjete monetare në Arkë		
5	512,56	Mjrete monetare në Bankë		
6	520	Disponibilitete në Thesar	7,098,952	6,787,761
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provigjonë zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		**2.Gjendje Inventari qarkullues**	**8,208,733**	**7,463,334**
12	31	Materiale	7,673,740	7,047,860
13	32	Inventar I imët	534,993	415,474
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe në rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose pranë te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimët e magazinimit		
20	39	Provigjonë perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		**3.Llogari te Arkëtushme**	**15,418,217**	**15,918,470**
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personëli, paradhenie, deficite, gjoba		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetsore		
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucionë te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitorëe te ndryshem	13,421,781	13,421,781
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	1,996,436	2,496,689
34	45	Mardhenie midis institucionëve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
36		**4.Te tjera aktive afatshkurtra**	**62,711,916**	**0**
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		

40	481	Shpenzime per t'u shperndare në disa ushtrime	248,185	
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	62,463,731	
42		**II.Aktivet Afat gjata**	**5,881,044,070**	**6,182,669,428**
43	**20**	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**0**	**0**
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime		
46	203	Koncesionë,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	**21**	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**5,788,319,899**	**6,088,691,377**
48	210	Toka, T,roje, Terenë	41,773	41,773
49	211	Pyje, Plantacionë	0	
50	212	Ndertesa e Konstruksionë	20,390,493	14,148,677
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	5,755,709,471	6,058,641,548
52	214	Iinstalime teknike, makinëri e paisje	0	0
53	215	Mjete Transporti	11,657,054	15,334,676
54	216	Rezerva Shteterore	0	
55	217	Kafshe punë e prodhimi	0	
56	218	Inventar ekonomik	521,109	524,703
57	24	Aktive afatgjata te demtuara	0	
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata	0	
59	25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	**0**
60	25	Huadhenie e Nënhuadhenie	0	
61	26	Pjesmarrje në kapitalin e vet		
62		**4.Investime**	**92,724,171**	**93,978,051**
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	92,724,171	93,978,051
65	**B**	**PASIVET(DETYRIMËT)**	**86,349,455**	**23,826,602**
66		**I.Pasivet Afat shkurtra**	**86,349,455**	**23,826,602**
67		**1. Llogari te Pagushme**	**85,229,084**	**22,706,231**
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to		3,860
69	42	Detyrime ndaj personëlit	864,514	871,538
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenës		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	66,028	67,233
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	256,738	259,008
76	436	Sigurime Shendetsore	35,628	35,946
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
78	44	Institucionë te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucionëve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete në ruajtje	7,098,952	6,787,761
82	467	Kreditore te ndryshem	63,485,443	1,259,104
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	13,421,781	13,421,781
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		**2.Te tjera pasive afatshkurtra**	**1,120,371**	**1,120,371**
86	419	Kreditore, Parapagime	1,120,371	1,120,371
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arkëtuara para nxjerrjes se ttitullit		
91		**II.Pasivet Afat Gjata**	**0**	**0**
92	Klase 4	Llogari te pagushme		

93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonët afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	**C**	**AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)**	**5,888,132,433**	**6,189,012,391**
97	**D**	**FONDI I KONSOLIDUAR:**	**5,888,132,433**	**6,189,012,391**
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	5,794,662,863	6,094,980,165
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	745,399	54,175
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmnë	92,724,171	93,978,051
104	106	Teprica e Granteve kapitale Të Huaja		
105	107	Vlera e mjeëteve te caktuara në perdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
107		Te Tjera		
108	**E**	**TOTALI I PASIVEVE(B+C)**	**5,974,481,888**	**6,212,838,993**

<u>Për pasqyrat financiare të vitit 2021</u>

Përbërësit dhe formatet e Pasqyrave Financiare bashkëlidhur janë:

- Pasqyra F1 Pozicioni Financiar,
- Pasqyrat F2 Performanca Financiare,
- Pasqyra F 3 Cash Flow,
- Pasqyra F4 Ndryshimet në Aktivet neto/ Fondet neto,
- Pasqyra F5 Shënime Shpjeguese.

Po ashtu dhe Pasqyrat Statistikore, sipas formateve :

- Pasqyra F6 Investimët dhe burimet e financimit,
- Pasqyra F7 Gjendja dhe ndryshimet në AAGJ me kosto historike dhe me vlerë neto,
- Pasqyra F8 Numri i punonjësve dhe Fondi i Pagave.

Pasqyrat Financiare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri gjendjen financiare, performancën, ndryshimet në gjendjen financiare të institucionit. Ato sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe paraqesin, me vërtetësi, të dhënat e nëvojshme për vendimmarrje. Janë përgatitur bazuar në parimin e kontabilitetit me bazë rritëse dhe në vijueshmërinë e veprimtarisë së njësisë ekonomike, për një te ardhme të parashikueshme.

Hartimi i Pasqyrave Financiare është kryer pas:

- Kryerjes së verifikimit fizik (kryerjes së inventarëve) të të gjitha AQT-ve dhe gjendjeve të inventarit në magazinë dhe krahasimit me të dhënat e kërkuara nga evidenca kontabël,

-Rakordimit me të gjithë debitorëët dhe kreditorët,

-Rakordimit me degën e thesarit të rrethit për shpenzimet dhe të ardhurat.

- Llogaritjes së Amortizimi vjetor, sipas normave të përcaktuara në udhëzimin e sipër përmendur, aplikimi është bërë mbi vlerën e mbetur (kosto ose vlera kontabël minus amortizimin e akumuluar të llogaritur) dhe është më pas janë kontabilizuar.

Pas saktësimeve të mësipërme janë mbyllur llogaritë vjetore, në mbështetje të Udhëzimit nr.5, datë 21.02.2022, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" së llogarisë vjetore të buxhetit për vitin 2021".

Rubrika A e Pasqyrës së Pozicionit Financiar

Aktivet paraqiten në rubrikën A të pasqyrës së pozicionit financiar. Totali i aktiveve përbëhet nga shuma e totalit të aktiveve afatshkurtra dhe totalit të aktiveve afatgjata.

Rubrika I e aktiveve, që përfaqëson aktivet afatshkurtra, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, në shumën 7,098,592 lekë, gjendja e inventarit qarkullues, në shumën 7,816,304 lekë, llogari të arkëtueshme në shumën, dhe të tjera aktive afatshkurtra në shumen **14,661,942** lekë.

- **Nënrubrika e "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre",** përbëhet nga mjete monetare në ruajtje në llogarinë e thesarit në shumën **7,098,592** lekë. Kjo llogari në krahasim me vitin e kaluar nuk ka pësuar ndryshime. Kjo nënrubrike është hartuar sipas formatit të Pasqyrave Financiare Cash Floë.
- **Nënrubrika "Gjendje inventari qarkullues",** në shumën **7,816,304** lekë, dhe pasqyron gjendjen materiale në magazinë.
- **Nënrubrika "Llogari të arkëtueshme",** në shumën **14,661,942** lekë, pasqyron gjendje e debitorëve të viteve të kaluara **13,421,781** lekë. Llogaria 4342 "Operacione me shtetin, debitorë", në shumën **1,240,161** lekë pasqyron detyrimin e shtetit ndaj institucionit për marrjen e grantit, lidhur me shlyerjen e kreditorëve të vitit paraardhës, në vlerën **773,528** lekë, dhe në shumën **1,222,908** lekë të detyrimeve ndaj punonjësve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetsore, TAP, (llogaritë kundërparti (llogaritë 421,431,435,436), si dhe llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", në postin B / Pasive të Pasqyrës së Pozicionit Financiar).
- **Nënrubrika "Të tjera Aktive Afatshkurtra",** me vlerën 0 lekë, përfaqëson shpenzime të periudhave të ardhshme për kontratat e lidhura për mirëmbajtjen e rrugëve.

Rubrika II e aktiveve, që përfaqëson Aktivet Afatgjata , përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë: AAGJ jomateriale, Materiale dhe Financiare. Kjo shumë përfaqësohet vetëm nga AAGJ materiale në vlerën neto **5,496,380,471 lekë.**

- Nuk ka patur ndryshime në vlerën e AAGJ **(Toka, llogaria 210**), e cila paraqitet në vlerën neto **41,773 lekë.**
- Në vlerën e AAGJ **(Ndërtesa, llogaria 212**) e cila paraqitet në vlerën **17,038,714** lekë, ku rezulton një zbritje e vlerës të vitit paraardhë, prej **3,351,779 lekësh**, për shkak të përllogaritjes të amortizimit vjetor.
- Në vlerën e AAGJ **(Rrugë ,rrjete, vepra ujore, llogaria 213)**, rezulton një zbritje e vlerës të vitit paraardhës, për shkak të përllogaritjes të amortizimit vjetor. Vlera neto paraqitet **5,467,923,997** lekë.
- Nuk paraqiten ndryshime në AAGJM – Llogaria **214 "Instalime teknike, makinëri, pajisje, vegla punë".** Vlera neto rezulton 0 lekë.
- **Mjetet e transportit (llogaria 215**), paraqiten në vlerën **11,384,845** lekë, 0 vlera neto e paraqitur në bilanc 2021, kemi nje ulje me vlere nga fillimi i vitit vetëm si pasoje e llogaritjes se amortizimit vjetor.
- AAGJM – Llogaria **218 "Inventari ekonomik"**, paraqitet në vlerën neto prej **441,142 lekësh**, si pasojë e amortizimit të akumuluar deri në fund të periudhës, si dhe nxjerrjet jashtë perdorimit.

-Në Pasqyrën 7/b, paraqitet gjendja e amortizimit të akumuluar në total prej **904,916,652 lekësh**, dhe për secilën nga AAGJM veçmas, shtesa si pasojë e amortizimit vjetor të llogaritur në total për **289,224,484 lekë**, si dhe per secilin AAGJM veçmas. Pakësimët për amortizimin, si pasojë e nxjerrjes jashtë përdorimit me vlerën **32,426,648 lekë** (kosto historike), dhe amortizim me vlerën **30,094,424 lekë**. Totali i amortizimit të akumuluar në fund të periudhës kontabel 31.12.2021 paraqitet në vlerën **6,660,876,983** lekë.

- Në nënrubrikën **"Investime",** pasqyrohen shpenzime për AAGJ Materiale të trashëguara, në shumën **92,724,171** lekë të trashëguara nga vitet e mëparshme.

Rubrika B e Pasqyrës së Pozicionit Financiar pasqyron Pasivet (detyrimët). Totali i pasiveve përbëhet nga shuma e totalit të pasiveve Afatshkurtra dhe totalit të pasiveve Afatgjata.

Rubrika e I-rë e pasiveve, që përfaqëson pasivet afatshkurtra, përbëhet nga shuma e nënrubrikave të llogarive të pagueshme dhe të tjera pasive afatshkurtra. Këto te fundit paraqiten **1,120,371** lekë, të prejardhura nga periudha raportuese paraardhëse.

Nënrubrika "Llogari të pagueshme", analizon detyrimët sipas zërave, si psh: detyrime ndaj personëlit 889,000 lekë, detyrime për TAP **65,533 lekë**, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, **285,628 lekë**, totali i të cilave së bashku me një pjesë të llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" në shumën **773,528 lekë**. Në aktivin e bilancit paraqitet llogaria 4342 "Operacione me shtetin - debitorëve", në vlerën **1,240,161 lekë**. Pjesa tjetër e llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm", paraqitet në vlerën **62,463,731 lekë, dhe** ka kundërparti në aktivin e Bilancit, llogarinë e aktiveve të tjera afatshkurtra.

Llogaria 4341 "Operacione me shtetin - detyrime", paraqitet në vlerën 13,421,781 lekë, me kundërparti në aktivin e bilancit, në llogarinë 468 "Debitoreë të ndryshëm", dhe pasqyron të drejtat e institucionit ndaj të tretëve, të cilat duhet të derdhen në buxhet. Kjo shuma është e mbartur nga vitet e kaluara.

Llogaria 466 "Mjete në ruajte", paraqitet në shumën 7,098,592 lekë dhe përputhet me mjetet monetare në llogarinë e thesarit, (llogaria 520). Shuma e mësipërme përfaqëson mjetet në ruajtje për garancinë e punimeve, e cila aplikohet tek punimët civile gjatë implementimit të kontratave.

Rubrika C e Pasqyrës së Pozicionit Financiar, evidenton aktivet neto ose fondet neto. Fondet neto përbëjnë diferencen midis totalit të aktiveve me totalin e pasiveve, dhe paraqiten në vlerën: **5,619,131,481 - 22,880,905 = 5,596,250,576 lekë.**

Fondet neto kanë pësuar ndryshime nga fillimi i periudhes ushtrimore me ulje. Më poshtë paraqiten më hollësisht shtesat dhe pakësimët që kanë sjellë këtë ndryshim:

Shtesa në total	**67,080 lekë**
Rritja e AAGJ inventar ekonomik	67,080 lekë
Pakësimi në total	**-291,948,937 lekë**
Si pasojë e llogaritjes së amortizimit të akumuluar për vitin 2021	**-291,948,937 lekë**

Gjendja në fillim + shtesat – pakësimët:

5,795,408,262 + 67,080 - 291,948,937 = 5,503,526,406 + 92,724,171 = 5,596,250,577 lekë.

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	**A**	**A K T I V E T**	**5,619,131,481**	**5,974,233,343**
2		**I.Aktivet Afat shkurtra**	**29,576,838**	**93,189,273**
3		**1.Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre**	**7,098,592**	**7,098,592**
4	531	Mjete monetare në Arkë		
5	512,56	Mjrete monetare në Bankë		
6	520	Disponibilitete në Thesar	7,098,592	7,098,592
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provigjonë zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		**2.Gjendje Inventari qarkullues**	**7,816,304**	**8,208,733**
12	31	Materiale	7,429,641	7,673,740
13	32	Inventar I imët	386,663	534,993
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe në rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose pranë te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimët e magazinimit		
20	39	Provigjonë perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		**3.Llogari te Arkëtushme**	**14,661,942**	**15,418,217**

22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personëli, paradhenie, deficite, gjoba		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetsore		
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucionë te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitorëe te ndryshem	13,421,781	13,421,781
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	1,240,161	1,996,436
34	45	Mardhenie midis institucionëve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
36		**4.Te tjera aktive afatshkurtra**	**0**	**62,463,731**
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare në disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	0	62,463,731
42		**II.Aktivet Afat gjata**	**5,589,554,642**	**5,881,044,070**
43	**20**	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**0**	**0**
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime		
46	203	Koncesionë,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	**21**	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**5,496,830,471**	**5,788,319,899**
48	210	Toka, T,roje, Terenë	41,773	41,773
49	211	Pyje, Plantacionë	0	0
50	212	Ndertesa e Konstruksionë	17,038,714	20,390,493
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	5,467,923,997	5,755,709,471
52	214	Iinstalime teknike, makinëri e paisje	0	0
53	215	Mjete Transporti	11,384,845	11,657,054
54	216	Rezerva Shteterore	0	0
55	217	Kafshe punë e prodhimi	0	0
56	218	Inventar ekonomik	441,142	521,109
57	24	Aktive afatgjata te demtuara	0	0
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata	0	0
59	25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	**0**
60	25	Huadhenie e Nënhuadhenie	0	
61	26	Pjesmarrje në kapitalin e vet		
62		**4.Investime**	**92,724,171**	**92,724,171**
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	92,724,171	92,724,171
65	**B**	**PASIVET(DETYRIMËT)**	**22,880,905**	**86,100,910**
66		**I.Pasivet Afat shkurtra**	**22,880,905**	**86,100,910**
67		**1. Llogari te Pagushme**	**21,760,534**	**84,980,539**
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to		
69	42	Detyrime ndaj personëlit	889,000	864,514
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenës		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	65,533	66,028
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	249,297	256,738
76	436	Sigurime Shendetsore	36,331	35,628
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
78	44	Institucionë te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucionëve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete në ruajtje	7,098,592	7,098,592

82	467	Kreditore te ndryshem		63,237,258
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	13,421,781	13,421,781
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		**2.Te tjera pasive afatshkurtra**	**1,120,371**	**1,120,371**
86	419	Kreditore, Parapagime	1,120,371	1,120,371
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arkëtuara para nxjerrjes se ttitullit		
91		**II.Pasivet Afat Gjata**	**0**	**0**
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonët afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	**C**	**AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)**	**5,596,250,576**	**5,888,132,433**
97	**D**	**FONDI I KONSOLIDUAR:**	**5,596,250,576**	**5,888,132,433**
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	5,503,918,834	5,794,662,863
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	-392,429	745,399
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmnë	92,724,171	92,724,171
104	106	Teprica e Granteve kapitale Të Huaja		
105	107	Vlera e mjeëteve te caktuara në perdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
107		Te Tjera		
108	**E**	**TOTALI I PASIVEVE(B+C)**	**5,619,131,481**	**5,974,233,343**

Konkluzion:

1. Nënrubrika “Llogari të arkëtueshme”, në shumën **14,661,942** lekë, pasqyron gjendje e debitorëve të viteve të kaluara **13,421,781** lekë. Llogaria 4342 “Operacione me shtetin, debitorë”, në shumën **1,240,161** lekë pasqyron detyrimin e shtetit ndaj institucionit për marrjen e grantit, lidhur me shlyerjen e kreditorëve të vitit paraardhës, në vlerën **773,528** lekë, dhe në shumën **1,222,908** lekë të detyrimeve ndaj punonjësve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetsore, TAP, (llogaritë kundërparti (llogaritë 421,431,435,436), si dhe llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, në postin B / Pasive të Pasqyrës së Pozicionit Financiar).
2. Llogaria 4341 “Operacione me shtetin - detyrime”, paraqitet në vlerën 13,421,781 lekë, me kundërparti në aktivin e bilancit, në llogarinë 468 “Debitorëë të ndryshëm”, dhe pasqyron të drejtat e institucionit ndaj të tretëve, të cilat duhet të derdhen në buxhet. Kjo shuma është e mbartur nga vitet e kaluara.

Aneksi nr. 3 – Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar për Rajonin Verior

*"**2.2.1**.Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjatë tre viteve të fundit 2017, 2018 dhe 2019, duhet të mos jetë më e vogël se 30% e fondit limit të lotit përkatës. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.*

***2.2.2** Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm gjate tre viteve të fundit 2017, 2018, 2019. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të tre viteve të fundit), të paraqitur pranë autoritetit përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet, në të cilat duhet te rezultojë se nuk ka dalë me humbje të paktën në dy vite të njëpasnjëshëm.*

***2.2.3** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vërtetim të lëshuar nga çdo njësi vendore për të dëshmuar se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2019.*

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikoje vërtetësinë e informacionit të paraqitur. Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik".

2.3 Kapaciteti teknik

***2.3.1** Kandidati/ofertuesi duhet të ketë realizuar shërbime të ngjashme me objektin që prokurohet me vlerë jo më të vogël se 30 % e fondit limit të lotit përkatës, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit.*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, si dëshmi të paraqiten:

*Kopje e kontratës së nënshkruar me ent publik, Vërtetim i lëshuar nga enti publik (ose formulari vlerësimi në rastet kur lëshohet një i tillë); **ku të përcaktohet saktësisht cilësia e kryerjes së shërbimit/punëve dhe fakti nëse kontrata është realizuar me sukses** dhe Faturat tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe shërbimi i realizuar;*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi të paraqiten: faturat tatimore përkatëse të shitjes të nënshkruara nga të dyja palët (ku te shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet/punët e realizuara).

***2.3.2** Si dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, kandidati/ofertuesi duhet të vërtetojë se ka mesatarisht të siguruar, jo më pak se 36 punonjës për periudhën Janar 2020–Qershor 2020. Kjo e vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kërkuar, shoqëruar me formularët E-SIG të konfirmuara nga organet përkatëse (me nënshkrim elektronik ose në hard copy).*

***2.3.3** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimeve/punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshire në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen shërbimet/punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme: diplomë, kontratë pune të vlefshme. Të siguruar sipas legjislacionit në fuqi.*

***2.3.4** Operatori Ekonomik për kryerjen e te gjitha punimeve/shërbimeve në objekt, duhet të paraqesë një liste të personelit kryesor, me minimalish: 1 (një) inxhinier Ndërtimi, 1 (një) inxhinier Mekanik, dhe 1 (një) inxhinier Gjeolog / Gjeoteknik, për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë, Kontratë pune e vlefshme, diplome dhe CV përkatëse.*

***2.3.5** Operatori Ekonomik duhet të deklaroje me shkrim se inxhinieret e kërkuar në pikën 2.3.3 dhe 2.3.4 për kualifikim, janë të paangazhuar në kontrata të tjera.*

***2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 8 (tete) punonjës manovratorë, për të cilët duhet të paraqesë kontrate individuale të punës të vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse,*

2.3.7 *Operatori Ekonomik duhet të ketë në përbërje të stafit punonjësit në përputhje të plotë me VKM nr. 632, datë 15.07.2015, i ndryshuar.*
Operatori Ekonomik duhet te ketë në përbërje të stafit Një Mjek në përputhje të plotë me VKM nr.108 date 09.02.2011, i ndryshuar, te vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë CV, leje ushtrimi profesioni të lëshuar nga Urdhri i Mjekut.
2.3.8 <u>Operatoret ekonomike duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës</u>*. Për këtë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Shqyrtimi i licencave do te behet mbi bazën e rregullave te parashikuara sa me sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:*
NP -1/A (Punime gërmimi në tokë)
NP -4/C (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale)
NP -5/A (Punime nëntokësore dhe vepra arti)
NP -12/A (Punime të inxhinierisë së mjedisit.)
NS -6/A (Sinjalistika rrugore jo ndriçuese)
NS-7/A (Barriera dhe mbrojtje rrugore)
Bazuar në Vendimin. Nr. 943, datë 28.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", subjektet fizike / juridikë të huaj duhet të aplikojnë për ekuivalentimin e licencës së huaj në Republikën e Shqipërisë.
2.3.9 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqesë certifikatat te vlefshme si më poshtë:

- *EN-ISO 14001:2004 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit)*
- *EN- ISO 9001-2015 (Sistemi i menaxhimit te cilësisë)*
- *EN-OHSAS 18001:2007 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë), ose certifikatën ekuivalente te njohur nga standardet shqiptare ISO 45001-2018*
- *ISO 39001:2012 (Sistem i menaxhimit te sigurisë rrugore dhe trafikut)*

**Te gjitha certifikata e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
Nëse ofertuesi do të paraqitet si bashkim operatoresh, certifikatat duhet të jenë në përputhje me punimet e marra përsipër.
2.3.10 Operatori ekonomik duhet të disponoje mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. *Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik si më poshtë.*

Nr.	***Lloji i Makinerive***	***Pronësia***	***L 1***	***L 2***	***L 3***	***L 4***	***L 5***	***L 6***	***L 7***	***L 8***	***L 9***	***L 10***	***L 11***	***L 12***	***L 13***	***L 14***
1	*Mjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton*	*pronësi/ qira*	***2***	***2***	***3***	***2***	***2***	***2***	***2***	***2***	***2***	***2***	***2***	***2***	***2***	***3***
2	*Grejder*	*pronësi/ qira*	***1***	***1***	***2***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***
3	*Rrul vibrues*	*pronësi/qira*	***1***	***1***	***2***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***
4	*Prerëse asfalti*	*pronësi/ qira*	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***
5	*Frezë asfalti*	*pronësi/ qira*	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***
6	*Betoniere*	*pronësi/ qira*	***1***	***1***	***2***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***
7	*Autobot uji*	*pronësi/qira*	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***
8	*Autobitumatriçe*	*pronësi/ qira*	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***
9	*Asfaltoshtruese*	*pronësi/ qira*	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***
10	*Motomjet ose Agregatë për prerjen e bimësisë së ulët*	*pronësi/ qira*	***4***	***6***	***8***	***5***	***6***	***3***	***5***	***4***	***5***	***6***	***5***	***4***	***5***	***6***
11	*Kamionçinë deri në 3.5ton*	*pronësi/qira*	***2***	***2***	***3***	***2***	***2***	***1***	***2***	***2***	***2***	***2***	***2***	***1***	***2***	***3***
12	*Minieskavator*	*pronësi/ qira*	***1***	***1***	***2***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***

13	*Minifadromë (Bobcat ose ekuivalent)*	*pronësi/ qira*	***1***	***1***	***2***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***
14	*Fadromë*	*pronësi/ qira*	***1***	***1***	***2***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***
15	*Ekskavator me zinxhirë*	*pronësi/qira*	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***
16	*Ekskavator me goma*	*pronësi/ qira*	***1***	***1***	***2***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***
17	*Makineri për vijëzim rrugor*	*pronësi/ qira*	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***
18	*Mjet (Batipal) për vendosje parmakësh metalik (guardrails)*	*pronësi/ qira*	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***
19	*Fabrikë Asfaltobetoni, e pajisur me QKL, leje mjedisore*	*pronësi /qira/ kontrate furnizim*	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***	***1***
20	*Borëpastruese (APV) ose Agregatë për pastrim bore* me kamion në dispozicion *(kamion+rruspë+shpërndarës kripe)*	*pronësi/ qira*	***3***	***4***	***2***	***0***	***4***	***1***	***3***	***3***	***3***	***4***	***4***	***2***	***2***	***3***
21	*Set semaforesh per menaxhim trafiku*	*pronësi/ qira*	***0***	***0***	***0***	***0***	***1***	***0***	***0***	***0***	***0***	***0***	***0***	***0***	***0***	***0***
	Punonjes		***30***	***37***	***45***	***29***	***35***	***23***	***33***	***30***	***35***	***37***	***33***	***26***	***33***	***40***
	Manovrator		***8***	***9***	***9***	***8***	***6***	***8***	***8***	***8***	***9***	***9***	***8***	***8***	***9***	***9***
	Gjatesia totale ***712.45 km***	*km*	***40.5***	***57.3***	***81.1***	***46.45***	***58.7***	***29.4***	***52.1***	***49.3***	***59.3***	***48.2***	***40.2***	***34.7***	***53***	***62***
	Mesatarja , Nje punotor sa km mbulon	*Km/puntor*	***1.35***	***1.55***	***1.80***	***1.60***	***1.67***	***1.28***	***1.58***	***1.64***	***1.70***	***1.30***	***1.22***	***1.33***	***1.60***	***1.55***

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit:- certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; leja e transportit qe lëshohet nga njësia vendore dhe fotot përkatëse, me ngjyra ku të jetë e dukshme edhe targa e mjetit; ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshije objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës / kontratave.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo ç'doganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit te mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerase e cila duhet të përfshije objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës / kontratave.

- Për fabrikën e asfalto betonit, nëse është ne pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo ç'doganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, leja mjedisore lëshuar nga QKL. Nëse është marre me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jete e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës / kontratave.

- Operatori ekonomik për fabrikën e asfalto betonit mund të paraqesë edhe kontrata të vlefshme furnizimi me operatore ekonomike Në këtë rast duhet të paraqesë kontratën e furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton ekzistencën dhe pronësinë e impiantit.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së realizimit te kontratës / kontratave.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe të bëjë deklarimin e adresës së saktë të vendndodhjes së mjeteve me qellim verifikimin e tyre"

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejtën të verifikoje vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi te rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik".

2.3.11 Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara ne kontrata të tjera. Për këtë te paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera."

Aneksi nr. 4 – Lista e detajuar e dëmit ekonomik të shkaktuar si rrjedhojë e likuidimit të punimeve/shërbimeve të pakryera në fakt.

RAJONI VERIOR		
Loti	**OE fitues**	**Dëm ekonomik (lekë pa TVSH)**
2	M & SH	140,015
3	N 2014 & R G	140,650
4	I & A K	107,694
5	A M & D -1	133,330
7	M & A & O	100,450
8	G	116,700
9	C	112,000

RAJONI QENDROR		
Loti	**OE fitues**	**Dëm ekonomik (lekë pa TVSH)**
1	F	38,450
2	K	39,356
3	XH & "A – SH & M	47,580
4	BOE A – I & A I G	93,600
5	A A	50,300
8	C	45,800
9	R	91,791

RAJONI JUGOR		
Loti	**OE fitues**	**Dëm ekonomik (lekë pa TVSH)**
1	A B	37,000
2	T-D & A K	112,754
3	N + A	33,500
6	A	32,000
8	C	66,000
9	B	36,400
10	2	105,000
11	G F & I & 4	33,198
12	BOE A – I & A I G	72,000